



ANALIZAT E NDIKIMIT TË KOVID-SARS-19 NGA PERSPEKTIVA GJINORE DHE E DIVERSITETIT



ANALIZAT E NDIKIMIT TË KOVID-SARS-19 NGA PERSPEKTIVA GJINORE DHE E DIVERSITETIT

Autore:

Dr. Marija Risteska

Me kontributin e:

Kristijan Aleksovski

Zlatko Simonovski

Kristijan Trajkovski

Nikolina Janeva

Elena Koçoska

Prof. Dr. Kristina Misheva

Hulumtues:

Ana Avramovska Nuskova

Gordana Micova Nestorovska

Sashko Jovanov

Liljana Jonoska

Elena Koçoska

Qendra e Hulumtimeve dhe Krijimit të Politikave shpreh mirënjohje për mbështetjen nga ana e përfaqësuesve të Njësisë së Monitorimit të Misionit të OSBE-së në Shkup, të cilët në mënyrë aktive u inkuadruan në aktivitetet e hulumtimit dhe mbledhjes së të dhënave në nivelin lokal. Në emrin e ekipit të autorëve, shprehim mirënjohje për Sanja Nikolin, Zhaneta Poposka, Darko Pavlovski, Vasiliki Chatzikamari dhe Eben Friedman për komentet e tyre dhe njohuritë kolegjiale (peer-to-peer), që bënë këtë raport edhe më relevant. Në fund, shprehim po ashtu mirënjohjen tonë për Sasha Gavriç, për udhëheqjen e tij në këtë studim dhe parashikimet se ky raport do të jep një kontribut të rëndësishëm për punën tonë më të gjerë mbi barazinë gjinore dhe për përfitimet nga angazhimi i dalluar i organizatave të shoqërisë civile në këtë platformë: Rrjeti kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Radar, Polio Plus, Koalicioni 'Rural' dhe 'Humanost'.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",

Скопје

342.51:[616.98:578.834(497.7)](047.31)

342.72/.73:[616.98:578.834(497.7)](047.31)

305:[616.98:578.834(497.7)](047.31)

RISTESKA, Marija

Analizat e ndikimit të Kovid-SARS-19 nga perspektiva gjinore dhe e diversitetit / autore Marija Risteska. - Shkup : OSBE, 2020. - 85 стр. : граф.

прикази, табели ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojca 1-3

ISBN 978-608-4788-55-3

а) Ковид-19 -- Мерки на Владата -- Човекови права -- Македонија

-- Истражувања б) Ковид-19 -- Мерки на Владата -- Родови аспекти --

Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 52570885



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Përmbajtja

HYRJE	6
Dinamika e Kovid-19.....	7
Teoria e ndryshimit.....	11
Metodologjia dhe kufizimet.....	12
KREU 1: ANALIZA E MASAVE TË MIRATUARA NGA QEVERIA KOMBËTARE NGA PERSPEKTIVA GJINORE	16
1.1. Analiza e masave nga perspektiva e të drejtave të njeriut.....	18
Liria e lëvizjes	19
Liria e tubimit	24
Liritë fetare.....	24
E drejta e arsimit.....	25
Liria e shprehjes	26
E drejta e privatësisë.....	29
1.2. Legaliteti dhe legjitimiteti i masave si përgjigje ndaj Kovid-19 dhe aksesi në drejtësi	31
1.3. Analiza e masave nga perspektiva gjinore dhe e diversitetit:	34
Mbrojtja shëndetësore, të drejtat seksuale dhe riprodhuese dhe kujdesi	36
Rimëkëmbja ekonomike dhe jetesa	37
Mbrojtja sociale dhe tregu i punës.....	43
Masat e synuara për grupet vulnerabël; solidariteti social dhe kohezioni social.....	44
Partneriteti me OSHC, konsultimet me vepruesit dhe komunikimet me qytetarët	45

KREU 2: ANALIZA E NDIKIMIT TË PËRGJIGJES NDAJ KOVID-19 NGA PERSPEKTIVA GJINORE DHE E DIVERSITETIT	48
2.1. Pjesëmarrja e grave dhe burrave në tregun e punës.....	49
2.2. Lidhur me rolet gjinore dhe sistemin gjinor.....	53
2.3. Dhuna ndaj grave.....	56
2.4 Pjesëmarrja e grave dhe burrave në reagimin përfshirë dhe në vendimmarrjen për reagimin ndaj Covid-19.....	61
2.5. Shkalla e likuiditetit të biznesit dhe shkalla e mbijetesës së bizneseve të grave.....	65
2.6. Përfshirja sociale dhe diskriminimi.....	70
KREU 3: BOSHLLËQET GJINORE TË SHKAKTUARA NGA PËRGJIGJA NDAJ KOVID-19	74
3.1. Lidhjet gjinore brenda familjes pas Covid-19.....	75
3.2. Gjinia dhe ardhmëria e punës pas Covid-19.....	77
3.3. Gjinia dhe shoqëria pas Covid-19.....	80
3.4. Gjinia dhe vendimmarrja për rimëkëmbjen pas Covid-19.....	83
KREU 4: KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR MASAT E PERIUdhËS PAS KOVID-19	86
Rekomandimet ekonomike.....	87
Tregu i punës.....	89
Kohezioni social.....	90
Rekomandime për dhunën dhe sigurinë publike.....	92
Vendimmarrja.....	93
SHTOJCA 1 LISTA E DEKRETEVE QEVERITARE QË KUFIZOJNË TË DREJTAT OSE LIRITË	97
SHTOJCA 2 LISTA E EKipeVE TË INTERVISTUARA TË REAGIMIT NË NIVELIN LOKAL	99
SHTOJCA 3: TABELA E MASAVE TË ANALIZUARA NGA PERSPEKTIVA GJINORE	100

Hyrje

Qendra e hulumtimeve dhe krijimit të politikave - QHKP shënon se “përgjigjet ndaj Kovid-19 kanë potencialin të jenë shkatërruese për feminizmin”




Qendra e hulumtimeve dhe krijimit të politikave – QHKP shënon se “përgjigjet ndaj Kovid-19 kanë potencialin të jenë shkatërruese për feminizmin

Qendra e hulumtimeve dhe krijimit të politikave – QHKP shënon se “përgjigjet ndaj Kovid-19 kanë potencialin të jenë shkatërruese për feminizmin”¹, ndërsa deputetja austriake në Parlamentin Evropian, Evelyn Regner, e cila kryeson Komisionin e Parlamentit Evropian për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, kishte deklaruar për *EU-ObsERVER* se “kriza e koronavirusit është femërore”. Me të vërtetë, “në spitalet, në shtëpitë e pleqve, në arkat e supermarketeve, gratë po luftojnë në pararojë kundër sëmundjes, ndërsa, në të njëjtën kohë, mbylljet dhe pezullimet prekin më tepër sektorët e grave, siç janë turizmi dhe tregtia me pakicë”². Botërisht, pavarësia e grave do të jetë viktimë e heshtur e pandemisë, vlerëson *The Atlantic*³. Fuqizimi i përgjithshëm i grave zotohet për pjesëmarrje të barabartë në proceset ekonomike, shoqërore dhe politike, role të barabarta të grave dhe burrave në familje, në amvisëri dhe në shoqëri të cilat ne i përfaqësojmë, dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat ku kemi investuar, të cilat për dekada me radhë po pakësohen dhe mund të zvogëlohen edhe më tepër gjatë krizës.

DINAMIKA E KOVID-19


Në Maqedoninë e Veriut, rasti i parë i Kovid-SARS-19 u regjistrua në shkurt 2020. Që atëherë, vendi ka kryer 92,550 testime dhe ka detektuar 9,797 raste pozitive me Kovid-19 (Statusi më datë 23.7.2020).

Grafiku 1
Gjithsej rastet dhe
gjithsej vdekjet –
Kovid-19 në Maqedoninë
e Veriut
Burimi: Our World In Data




1 QHKP (2020) “Përgjigja ndaj Kovid-19 dhe çështjet gjinore”, e disponueshme në faqen e internetit: <https://cutt.ly/RslhHbx>
2 <https://euobserver.com/coronavirus/148155>
3 <https://www.theatlantic.com/international/archive/2020/03/feminism-womens-rights-coronavirus-Kovid19/608302/>

Grafiku 2
Rastet e reja dhe vdekjet për ditë – Covid-19 në Maqedoninë e Veriut
Burimi: Our World In Data




Për fat të keq, siç është prezantuar në Grafikon 1 dhe Grafikon 2, kriza është përkeqësuar me një rritje të përshpejtuar të numrit të rasteve të infektuara dhe vdekjeve gjatë muajve qershor dhe korrik, që përputhet me shkallën e heqjes së masave restriktive në vend. Ky konkluzion gjithashtu mbështetet me numrat në rajon, ku Maqedonia e Veriut qëndron në vendin e dytë për numrin më të lartë të rasteve të reja për një milion banorë dhe në vendin e parë për numrin më të lartë të vdekjeve për një milion banorë (Grafiku 3 dhe Grafiku 4).

Grafiku 3
Rastet e reja për ditë për një milion banorë – Covid-19 në rajonin e Ballkanit
Burimi: Our World In Data



Grafiku 4
dekjet e reja për ditë
për një milion banorë
– Kovid-19 në rajonin e
Ballkanit
Burimi: Our World In Data



Struktura gjinore e të infektuarve, rastet e vdekjes dhe shpërhapja gjeografike e rasteve me Koronavirusin është si më poshtë. Që nga 21 korriku, vendi ka raportuar 9.513 raste të konfirmuara me Kovid-19 dhe 440 vdekje. Nga gjithsej rastet e konfirmuara, 4.798 janë gra, ndërsa 4.715 janë burra. Edhe pse incidenca e infektimit me virusin është më e lartë tek gratë, vdekjet janë më të dukshme tek burrat. Nga 440 vdekjet e raportuara nga Kovid-19, 278 burra kanë humbur jetët e tyre, krahasuar me 162 gra⁴. Tabela 1 prezanton 10 qytetet më të prekura, të klasifikuara sipas incidencave më të larta kumulative tek gratë, ku Shën Nikolla dhe Shtipi zëzë vendin e parë në listë. Incidencat shumë të larta në mesin e grave në këto qytete lidhen me industrinë e tekstitit, ku shumica e grave janë konstatuar të jenë pozitive për virusin.

4 Instituti i Shëndetit Publik (të dhëna të papublikuara), 21 korrik 2020




Tabela 1
Struktura gjinore e personave
të infektuar, vdekshmëria dhe
shpërndarja gjeografike e rasteve
të infektuar me virusin korona

KOMUNA	GJITHSEJ RASTET			INCIDENCA / PËR 100.000 BANORË		VDEKSHMËRIA		VDEKJEPRURËSIA	
	gra	burra	gjithsej	gra	burra	gra	Burra	gra	burra
Shën Nikollë	159	38	197	1712.255	412.5502	0	0	0,0 %	0,0 %
Shtip	384	248	632	1600.4	1041.929	12.50313	33.61062	0,8 %	3,2 %
Çair	347	414	761	1067.167	1283.442	58.43277	80.60266	5,5 %	6,3 %
Studenica	90	104	194	1039.501	1210.992	46.20005	46.57662	4,4 %	3,8 %
Likovë	135	136	271	993.8163	1009.351	44.16961	74.21701	4,4 %	7,4 %
Karbincë	20	7	27	993.542	350.1751	0	0	0,0 %	0,0 %
Qendër	212	179	391	929.9469	791.5101	21.93271	44.21844	2,4 %	5,6 %
Resnje	76	67	143	899.8342	799.6181	0	59.67299	0,0 %	7,5 %
Butel	158	182	340	870.5234	1010.886	11.01928	55.54321	1,3 %	5,5 %
Saraj	141	153	294	793.2489	867.6421	61.88467	62.37949	7,8 %	7,2 %

Burimi: Instituti i
Shëndetit Publik, me
kërkesë për qasje të
lirë në informacione,
të paraqitur nga QHKP,
korrik 2020

Patjetër duhet shënuar se, edhe pse shteti ka obligimin, konform Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (në tekstin e mëtejshëm KDPAK) për të mbajtur evidencën mbi personat me aftësi të kufizuara, prapëseprapë nuk ka evidencë, e as informacione nga autoritetet shtetërore se sa nga qytetarët e infektuar, dhe/ose të shëruar, janë me aftësi të kufizuara. Janë dymbëdhjetë (12) institucione publike shoqërore, nga të cilat, më e madhja gjendet në Demir Kapi (227 të strehuar) për njerëz me aftësi të kufizuara. Janë dy objekte rehabilitimi - njëri për aftësitë e kufizuara fizike në Banjën Bansko, dhe një për aftësitë e kufizuara intelektuale në Fushë Topanë - Shkup. Janë dhe tre spitale të mëdha psikiatrike: Bardhoc, Demir Hisar dhe një më i vogël në Negorcë. Këto spitale, përveç dhënies së shërbimeve për të strehuarit e përkohshëm, strehojnë dhe një numër të konsiderueshëm të personave me qëndrim të gjatë, ku vlerësimi është se janë rreth 700 të strehuar për një afat të gjatë⁵.

Tabela 2
Numri i personave me
aftësi të kufizuara të
vendosur në institucione

INSTITUCIONI	NR. I TË STREHUARVE DERI NË FUND TË 2018	M	F	MOSHA MESATARE
Demir Kapi - Demir Kapi	227	124	97	45
Banja Bansko - Strumicë	63	29	34	41
Fushë Topanë - Shkup	35	25	10	23

5 Shavreski Z. Koçoska E. Country report on Living independently and being included in the community - Republic of North Macedonia, ANED, i disponueshëm në: <https://www.disability-europe.net/country/republic-of-north-macedonia>


Me procesin e deinstitutionalizimit, për momentin, në Institucionin Publik Demir Kapi, numri i personave me aftësi të kufizuara arrin 187 në moshë mbi 18 vjeç. Numri aktual i njerëzve me aftësi të kufizuara në Institucionin Publik Banja BANSKO arrin në 53 të strehuar.

Informacionet që mungojnë në lidhje me statusin shëndetësor të personave me aftësi të kufizuara që janë institucionalizuar për Kovid-19, ndikojnë në mënyrë plotësuese në qasjen dhe karakterin ndërlidhës të masave të propozuara, e të ndërmarra nga Qeveria në luftimin e Kovid-19.

TEORIA E NDRYSHIMIT

“Izolimet në shtëpi që lidhen me Koronavirusin kanë prekur gjithsecilin, sidomos grupet vulnerabël, e më së shumti gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat e marginalizuar dhe të zhvendosurit”, kumtoi Ambasadori i OSBE-së Clemens Koja në një interviste të zhvilluar me MIA, më 3 maj. Për të përcaktuar efektet e krizës dhe masat e aplikuara për ta zgjidhur atë tek grupet e ndryshme të popullsisë, me qëllim jo për të vlerësuar, por për të mësuar nga kriza dhe për të propozuar hartime të mëtejshme të politikave, Qendra e hulumtimit dhe krijimit të politikave, me mandatin e marrë nga Misioni i OSBE-së në Shkup, hartoi një metodologji hulumtimi, duke shikuar përgjigjet e ndryshme qeveritare ndaj Kovid-19, nga perspektiva gjinore dhe e diversitetit (etnia, gjuha, aftësia e kufizuar, mosha, statusi social, feja apo bindja). Metodologjia u përcaktua për përdorimin e intervistave dhe sondazheve si metoda të mbledhjes së të dhënave dhe triangulimi si metodë e analizës, me përdorimin e informacioneve të mbledhura nga zyra, me informacione primare dhe të dhëna statistikore. Korniza kohor për mbledhjen e të dhënave ishte nga mesi i prillit deri në mesin e korrikut. Monitorimi ndoqi analiza të detajuara, identifikimin e masave të hartuara për boshllëqet gjinore, të cilat do ta trajtonin çështjen me Kovid-19 dhe mësimet e marra; si dhe detektimin e rekomandimeve të mundshme që do të merren për periudhën pas Kovid-19.

Grafiku 5
Teoria e ndryshimit



METODOLOGJIA DHE KUFIZIMET

Analizat e ndikimit të Kovid-19 nga perspektiva gjinore dhe e diversitetit u zhvillua me një partneritet midis QHKP dhe Radar, Polio Plus, Koalicioni Rural dhe Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Gjatë hulumtimeve, ekipi u mbështet edhe nga Njësia e monitorimit e Misionit të OSBE-së në Shkup. Qëllimi është të reflektohet qasja multidimensionale dhe kompleksiteti i çështjeve, si dhe ndërlidhshmëria e moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, zhvillimit urban/rural dhe etnisë me çështjet gjinore, dhe ndikimi i tyre mbi vulnerabilitetin në kohë krize. Metodologjia e monitorimit u nda në faza, duke u shtrirë mbi grupet e ndryshme qëllimore nga 74 gra dhe burra me formime të ndryshme profesionale, si dhe 60 sipërmarrje për të zbatuar analiza të ndërlydhura. U përdorën metodat e mëposhtme të hulumtimit: rishikimi në zyrë (i gjetjeve paraprake të hulumtimeve, për të kuptuar më gjerësisht se çfarë ndikimi ka kriza mbi ekonominë, tregun e punës, dhunën, pjesëmarrjen, etj.: mbledhja e statistikave zyrtare dhe shqyrtimi i ligjeve, dhe dekretet e lëshuara nga Qeveria për gjendje të jashtëzakonshme që nga 18 marsi, buxheti dhe prokurimet e bëra si përgjigje ndaj krizës nga perspektiva gjinore); intervista ballë-për-ballë të semi-strukturuara me gra dhe burra të moshuar, gra dhe burra ruralë, gra dhe burra me aftësi të kufizuara, nëna të vetme, nëna viktime të dhunës dhe shërbimdhënëse, gra në pozita vendimmarrëse, si dhe ekipe lokale të reagimit dhe gra në pararojë; dhe për qëllimin e përshkrimit të ndikimit mbi bizneset e grave, ekipi i QHKP zhvilloi një sondazh onlajn me gra sipërmarrëse dhe pronare të bizneseve.

Metodat e mëposhtme për mbledhjen e të dhënave primare do të përdoren për nëngrupet e çdo grupi qëllimor:

Tabela 3
Grupet qëllimore dhe
metodat

NËNGRUPI	METODA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PRIMARE	SHTRIRJA TEK
Gra dhe burra të moshës 65+ vjeç	Intervista me telefon apo në grupe fokusi	8 gra dhe 4 burra
Gra dhe burra pronarë biznesesh/sipërmarrës	Sondazh	60 biznese (38% gra dhe 62% burra me pronësi)
Gra dhe burra romë që jetojnë në lagje	Intervista me telefon	9 gra dhe 3 burra
Gra dhe burra me aftësi të kufizuara (fizike, ndijore dhe psiko-sociale)	Intervista me telefon apo në grupe fokusi	7 gra dhe 3 burra
Gra dhe burra ruralë (përfshirë dhe të tillë me ekonomi joformale)	Intervista me telefon apo në grupe fokusi	10 gra dhe 6 burra
Nëna të vetme me fëmijë në kopsht fëmijësh/shkollë	Intervista me telefon	7 gra Kërkesa drejtuar kopshteve të fëmijëve (FOIA)
Gra viktime të dhunës dhe shërbimdhënëse për gratë viktime të dhunës	Intervista	2 gra dhe 3 gra që janë shërbimdhënëse të drejtpërdrejta
Gra në pozita vendimmarrëse	Intervista	5 gra
Gra dhe burra në linjën e frontit për të luftuar Kovid-19	Intervista	7 gra dhe 5 burra
Ekipe lokale të reagimit ndaj krizës	Intervista	11 gra dhe 12 burra që punojnë në ekipe të reagimit ndaj krizës në Kumanovë, Dibër, Prilep, Haraçinë, Shuto Orizarë ⁶
GJITHSEJ		134 bashkëbisedues gra dhe burra

Metoda e hulumtimit që u shfrytëzua për Kovid-19, me intervista me telefon dhe onlajn, në vend të intervistave ballë-për-ballë, ka kufizimet e veta, pasi nuk u bë e mundur për hulumtuesit t'i nxjerrnin të gjitha eksperiencat, t'i observonin reagimet dhe të detektonin në mënyrë objektive ndikimin që masat kanë patur mbi jetët e përditshme të grupeve të ndryshme. Vepruesit lokalë kërkuan që të pranojnë pyetësorin me shkrim dhe disa të tjerë përzgjedhën të përgjigjen me shkrim. Përderisa numri i përgjithshëm i intervistave është i konsiderueshëm dhe përfaqësues, numri i intervistave për grup specifik është i ulët për ta përdorur në përgjithësimin e gjendjes së popullsisë të marginalizuara në nëngrupin në fjalë. Kjo posaçërisht u përket grave viktime të dhunës,

⁶ Lista e plotë e zyrtarëve lokalë është prezantuar në Shtojcën 2

pasi ekzemplari i të intervistuarave është shumë i ulët. Ndërkaq, ekipi i hulumtimit nuk kishte probleme të posaçme në detektimin e viktimave, pasi në konzorciumin për zbatimin e hulumtimit morën pjesë organizatat nga Rrjeti kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe kështu, aksesit tek gratë që kanë mbijetuar dhunën ishte i drejtpërdrejtë. Megjithatë, një sfidë serioze ishte që ato të bindeshin për të folur mbi eksperiencat e veta. Dy gra u intervistuan dhe ato ndanë storjet e tyre për dhunën gjatë pandemisë. Që të dyja janë përballur me dhunë të shfrenuar psikologjike. Domethënë, ato kishin vuajtur për vite abuzim emocional dhe psikologjik dhe kishin dështuar denoncimin deri në kohën e arritjes së masave për Kovid-19, kur karantina hyri në fuqi. Viktimat e dhunës gjinore u intervistuan nga psikologë, që punojnë në shërbime që ofrojnë mbështetje psiko-sociale për të mbijetuarat e dhunës.

Janë vendosur të gjitha masat paraprake për të siguruar konsideratat etike dhe praktike në lidhje me grupet e synuara që u intervistuan. Secili grup u kontaktua nga një OSHC e specializuar për përfaqësimin e të drejtave të grupit specifik. Çdo i intervistuar firmosi një formular deklarate të anonimizuar, përveç zyrtarëve të emëruar dhe të zgjedhur, të cilët janë prezantuar me emrat e tyre në këtë raport.



Kreu

1

ANALIZA E MASAVE TË MIRATUARA NGA QEVERIA KOMBËTARE NGA PERSPEKTIVA GJINORE

Objektivi legjitim i Qeverisë gjatë krizës që u shfaq si rezultat i Kovid-SARS-19 ishte të mbroheshin njerëzit a priori, shëndeti dhe jetët e tyre.



**Vendet në
përgjithësi janë
të detyruara të
marrin masa të
përshtatshme
për të
parandaluar
shpërhapjen e
pandemisë**

Objektivi legjitim i Qeverisë gjatë krizës që u shfaq si rezultat i Kovid-SARS-19 ishte të mbroheshin njerëzit *a priori*, shëndeti dhe jetët e tyre. Si pasojë, pothuajse të gjitha vendet, përfshi edhe Maqedonia e Veriut, miratuan masa juridike dhe politike, konform së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare. Megjithatë, ato u vlerësuan për pajtueshmërinë e tyre me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, cilësinë e domosdoshme të ligjeve që i kanë apo nuk i kanë, sa janë precize dhe të qarta, në mënyrë që çdo individ të mund të rregullojë sjelljen e vet sipas tyre dhe sa proporcionale janë me objektivin legjitim të përmendur më lart⁷.

Vendet në përgjithësi janë të detyruara të marrin masa të përshtatshme për të parandaluar shpërhapjen e pandemisë. Të gjitha të drejtat mund të limitohen, përveç të së drejtës së jetës (sipas KEDNJ), të drejtës së parandalimit të torturës dhe skllavërisë, lirisë së shprehjes dhe lirisë së bindjes fetare (sipas Neni 54 të Kushtetutës)⁸. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mënyrë të prerë kualifikon inkorporimin e traktateve të ratifikuara ndërkombëtare në kuadrin e sistemit ligjor kombëtar. Për shembull, Neni 8 i Kushtetutës parashton liritë dhe të drejtat bazë të individit dhe qytetarit, që njihen nga e drejta ndërkombëtare dhe vendos Kushtetutën si vlerën bazike; si dhe respektimi i normave përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare (p.12). Edhe pse duket se Kushtetuta pasqyron Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) në kuptimin e garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, ajo rregullon edhe kufizime të shumta ligjore të saj (26). Këto kufizime lënë hapësirë që të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, më tej të rregullohen më detajisht apo të kufizohen me ligje të tjera të brendshme (akti i Parlamentit)⁹.

Përveç KEDNJ, shteti është i detyruar të marrë veprime dhe masa konform Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KDPAK). Kjo Konventë u miratua më 2006, palë të së cilës janë edhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE)¹⁰. KDPAK përcakton se "Vendet anëtare do t'i ndërmarrin të gjitha hapat e nevojitur për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në gjendje rreziku, duke përfshirë dhe konfliktet e armatosura, emergjencat humanitare dhe shfaqjen e fatkeqësive natyrore" (Neni 11). Veç kësaj, Neni 11 i Konventës thirr

7 Qendra AIRE - Këshilla rreth të Drejtave Individuale të Njeriut (2020): Kovid-19 dhe efektet mbi të drejtat e njeriut

8 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e disponueshme në: <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/mk/mk014en.pdf>

9 Sipas Treneska Deskoska, R. 2008 "Koncepti kushtetues i të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë" në *Standardet evropiane për të drejtat e njeriut dhe implementimi i tyre nga sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë* edicioni Vllado Kambovski, Renata Treneska Deskoska dhe Vladimir Ortakovski. Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve 2008 Shkup, ligjet e brendshme (aktet e Parlamentit), rregullojnë detajisht të drejtat e të huajve (Neni 29 dhe Neni 31); të drejtën e martesës dhe familjes (Neni 40); të drejtat e mbrojtjes së shtetit (Neni 28) dhe të drejtën e marrëdhënieve të punës (Neni 32); ndërsa kufizon të drejtën e lirisë (Neni 12); të drejtën e lëvizjes dhe banimit (Nenet 26 dhe 27); të drejtën e tubimit të lirshëm (Neni 28); të drejtën e pronës (Neni 30); të drejtën e formimit të bashkimit dhe të drejtën e grevës (Nenet 37 dhe 38).

10 KDPAK u miratua në emrin e Komunitetit Evropian me Vendimin e Këshillit 2010/48/EC të datës 26.11.2009, dhe si e tillë, u bë pjesë përbërëse e rendit juridik të BE-së, duke mbizotëruar aktet nënligjore të BE-së.

**Neni 11 i
Konventës thirr
që e drejta
ndërkombëtare
humanitare
të lexohet me
qëndrim që
ka si bazë të
drejtat e njeriut
në kuptimin
e aftësive të
kufizuara**

që e drejta ndërkombëtare humanitare të lexohet me qëndrim që ka si bazë të drejtat e njeriut në kuptimin e aftësive të kufizuara. Në harmoni me KDPAK, qëndrimi që ka si bazë ku personat me aftësi të kufizuara në kriza të jashtëzakonshme duhet t'i mbajë parimet e dinjitetit dhe mosdiskriminimit dhe kapacitetin juridik, që po ashtu janë thelbi i KDPAK¹¹. Gjendja e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë nuk duhet të shfityrojë aplikimin e detyrimeve që dalin nga Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW). Komisioni për eliminimin e diskriminimit ndaj grave (Komisioni) lëshoi Udhëzime për Qeveritë, për të adresuar ndikimin joproporcional të pandemisë mbi shëndetin e grave; përcakton shëndetin seksual dhe riprodhues si shërbime të domosdoshme: mbron gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjininë; siguron pjesëmarrjen e barabartë të grave në vendimmarrje; siguron arsimimin e vazhdueshëm; siguron mbështetje socio-ekonomike për gratë dhe miraton masa të synuara për grupet e grave që janë në disavantazh¹².

1.1. ANALIZA E MASAVE NGA PERSPEKTIVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Masat e menjëhershme të cilat janë subjekt vlerësimi e të cilat u hartuan në periudhën prej fillimit të pandemisë deri në fund të muajit Korrik 2020 për të frenuar shpërhapjen e virusit Kovid-SARS-19 në Maqedoninë e Veriut, ishin këto më poshtë: mbyllja e shkollave dhe kopshteve të fëmijëve që nga 10 marsi; u ndalua grupimi i më tepër se dy njerëzve që nuk kanë lidhje familjare; mbajtja e distancës fizike nga 2 metra në publik dhe mbajtja e mbulesës mbrojtëse të fytyrës (maskës) në ambiente publike të mbyllura dhe nën qiell të hapur (ku nuk ka kushte për distancim fizik); mbyllja e hoteleve, qendrave tregtare, institucioneve kulturore, etj.; gjendja e jashtëzakonshme u shpall më 18 mars, e cila lejonte vendosjen e orës policore gjithëkombëtare dhe kufizoi lëvizjen e individëve në moshë mbi 67 vjeç dhe të adoleshentëve nën moshën 18 vjeç, duke çliruar personat në nevojë për asistencë mjekësore emergjente nga ora policore, dhe punonjësit e domosdoshëm siç janë policia, forcat e armatosura, punonjësit e shëndetësisë dhe prodhuesit që drejtpërsëdrejti janë të angazhuar në punime bujqësore.

Qëllimi ishte të mbrohej shëndeti i grave dhe burrave në moshë mbi 67 vjeç, si më vulnerabël dhe të kufizohet kontakti që ata do të mund të kishin me persona më të rinj se 18 vjeç, të cilët atëkohë konsideroheshin të jenë përhapësit kryesorë asimptomatikë të virusit. Megjithatë, këto masa nuk kishin efektin e njëjtë në zonat rurale dhe ato urbane, e as tek burrat dhe gratë. Lista e plotë me të cilën kufizoheshin të drejtat e njeriut është prezantuar në Shtojcën 1.

Gjendja e jashtëzakonshme u shpall më 18 mars, me vendimin e Presidentit Pendarovski. Ekzistimi i gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Republikës së

11 Të gjitha parimet e përgjithshme në Nenin 3 të KDPAK duhet të respektohen, pasi të gjitha janë relevante për këtë lëmë.

12 OHCHR, Dega e Traktateve të të Drejtave të Njeriut, 28 prill 2020, Përmbledhja e deklaratave të organeve të traktateve për të drejtat e njeriut, në kontekstin e Kovid-19 https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/TB/KOVID19/Compilation_statements.pdf

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme rezultoi me devijimin nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore

Maqedonisë së Veriut u shpall për një periudhë 30-ditë, për të arritur mbrojtjen dhe bërjen ballë pasojave të shpërhapjes së Koronavirusit Kovid-19. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme rezultoi me devijimin nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe të drejtat themelore dhe kushtetuese të njeriut (liritë civile), në pajtim me Nenin 15 paragrafin 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore më 2 prill 2020, kur vendi parashtrori lajmërimin e parë (nga gjithsej 6) përpara Këshillit të Evropës, me Vendimin Nr. 08-526/2, të firmosur nga Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me të cilin u shpall gjendja e jashtëzakonshme.¹³

Në këtë drejtim, duhet shënuar se Këshilli i Evropës (në tekstin e mëtejshëm KE) në raportin e vet gjithëpërfshirës mbi zbatimin e masave kundër-Kovid-19 dhe efektet e tyre, rekomandon vendet anëtare të kufizojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara me KEDNJ, pas rishikimit *ex-ante* të ndikimit të masave dhe të informojnë qytetarët për rezultatet e pritura nga masat. Më tej, KE vendos një kufizim të rëndësishëm të heqjes dorë nga të drejtat dhe liritë: proporcionaliteti i masave. Vlerësimi i proporcionalitetit është më i vështirë për t'u zbatuar, sepse është ky një virus i ri, i cili ofron bazën për justifikimin e përgjithshëm të çdo mase e cila do t'i kishte mbajtur njerëzit larg njëri tjetrit, që të frenohet shpërhapja e virusit. Prapëseprapë, Qendra e politikave evropiane vlerëson se masat e tilla të përgjithshme mund joproporcionalisht të prekin grupet e posaçme, siç janë përfituesit e kujdesit në një spektër bazash. Ndërkaq, Akademia e shkencave dhe arteve shënon se vendimet e marra gjatë pandemisë duhet qenë të domosdoshme dhe proporcionale.¹⁴ Nga 18 marsi, kur u shpall gjendja e parë e jashtëzakonshme, e deri në fund të gjendjes së jashtëzakonshme më 22 qershor, u shpallën 250 Dekrete të Qeverisë me fuqi ligji, nga të cilët, 22 ishin Dekrete që rrëmbejnë liritë (kryesisht të lëvizjes) dhe 44 kufizonin të drejtat.

Shteti nuk devijoi nga asnjë Konvente tjetër në të cilën është palë nënshkruese. Megjithatë, për shkak të mjedisit dhe shërbimeve jo të aksesueshëm me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe kufizimit të lëvizjes, shteti *eo ipso* devijoi nga Neni 14 i KDPAK.¹⁵

Liria e lëvizjes

U zbatuan ndalesa të udhëtimeve për të hyrë në vend dhe për të dalë jashtë vendit. Për një periudhë 105 ditësh, shteti i mbylli të gjitha kufijtë ajrorë dhe tokësorë¹⁶. U bë

13 Lista e plotë e lajmërimeve dërguar Këshillit të Evropës, mund të shikohet këtu: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/webContent/62111354>

14 V. Kambovski dhe të tjerë: Analiza e aspekteve juridike të gjendjes së jashtëzakonshme", Shkup, maj 2020

15 Shihni CRPD/C/UKR/CO/1, paragrafi 14

16 Neni 1, Vendimi për ndryshimin e Vendimit për masat e parandalimit të depërtimit dhe shpërhapjes së Koronavirusit Kovid-19, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 66, 16 mars 2020 "Të gjitha vendkalimet kufitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të mbyllen për kalimin e shtetasve të huaj - pasagjerë dhe automjete, përveç për hyrjen dhe tranzitimin e mjeteve të transportit të mallrave, përfaqësuesve të korit diplomatik, si dhe personave të tjerë për të cilët Ministria e Brendshme do të lëshojë leje, në bazë të opinionit paraprak të dhënë nga Kryeqendra për koordinimin e krizës, me të cilin do të konfirmojë se ekziston një gjendje e veçantë, apo një interes ekonomik. Mjetet e transportit të mallrave dhe personat e tillë do të hyjnë sipas kushteve të veçanta të sigurisë, në përputhje me Protokollin e Ministrisë së Shëndetësisë".

dhe kufizimi i udhëtimit brenda vendit (nga dhe për në Dibër, Kumanovë, Berovë) në qytetet që u vunë në izolim të plotë (karantinë) për dy javë. Më 22 mars, Qeveria miratoi Dekretin mbi kufizimin e lëvizjes sipas rekomandimeve të KB-ve për statusin e të drejtave të njeriut në erën e pandemisë së Kovid-19¹⁷, si dhe sipas udhëzimeve të BE-së mbi krijimin gjithëpërfshirës të politikave publike, që kërkon frenimin e tendencave për abuzim autoritar, që nuk është proporcionale dhe ndërsektoriale, dhe diskriminon grupet konkrete sociale: më të moshuarit se 67 vjeç dhe më të rinjtë se 18 vjeç. Në territorin e tërë shtetit, ora policore (regjimi kohor i përkufizuar në mënyrë të prerë zbatohet nga ora 16.00/19.00 deri në orën 05.00 të mëngjesit) u përcaktua për të gjithë qytetarët deri më 14 maj; lëvizja e kufizuar për individët në moshë mbi 67 vjeç (nga 05.00/10.00 të mëngjesit, deri në ora 12.00 në mesditë) dhe për adoleshentët ndër moshën 18 vjeç (nga ora 13.00 deri në ora 15.00/19.00)¹⁸. Mbyllja në shtëpi e tërë popullit pa përjashtime të lejuara, përveç për emergjencat më të rënda mjekësore, mund të vlerësohet se nuk ishte as proporcionale, e as i shërbente luftimit të pandemisë, aq më tepër, ishte e verbër në kuptimin e aranzhimit ndërsektorial¹⁹, pasi nuk i vuri re statusit të të moshuarve (për të cilët ishte shumë e shkurtër dritarja e mundësive për të qenë jashtë shtëpive të tyre), të njerëzve nën trajtim (me rutina të parashkuara shëndetësore, siç janë ecjet, stërvitjet, etj.), të njerëzve me aftësi të kufizuara, duke përfshirë fëmijët me autizëm, rutinat ditore të të cilëve ishin çrregulluar. Ajo që është më me rëndësi, qasja ishte plotësisht e pandjeshme ndaj gjinive, sepse ajo nuk njohu rolet specifike gjinore të grave që kujdesen për anëtarë të familjes që janë të moshuar dhe me sëmundje kronike dhe për nevojat e tyre për të lëvizur gjatë mbylljes për t'u përkujdesur për anëtarët e familjes, gjë kjo e cila shkaktoi frikë dhe frustrime tek të dyja palët, si ajo përfituese, ashtu dhe tek ajo që bën përkujdesjen. Më tepër detaje mbi ndikimin gjinor të masave janë prezantuar në Kreun 2, ndërsa Kreu 3 determinon boshllëqet gjinore, si rezultat.

Mosrespektimi i kufizimit të lëvizjes (orës policore) iu nënshtrua gjobave nga deri në 2.000 euro. Shuma e gjobës vlerësohet të jetë shumë e lart dhe do të ndikojë në zbatimin e saj. U imponua dhe ndalimi i transportit publik, sportive në grup, koncerteve dhe çdo lloji të tubimit publik në ambiente të mbyllura dhe nën qiell të hapur. Për më tepër, Qeveria, pas konsultimit me qeveritë e tjera, organizoi fluturime dhe transportimin e shtetasve të Maqedonisë së Veriut, të cilët kishin ngecur jashtë vendit për shkak të gjendjes. Ata persona ishin të detyruar të qëndronin në karantinë shtetërore për 14

17 Përmbledhja e Shkurtër e KB për Politikën mbi Kovid-19 dhe mbi të Drejtat e Njeriut: "Të gjithë së bashku jemi në këtë situatë", e disponueshme në: https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un_policy_brief_on_human_rights_and_kovid_23_april_2020.pdf

18 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese U.br. 60/2020, i disponueshëm në: <http://ustavensud.mk/?p=19320> me të cilin, një pjesë e Vendimit të Qeverisë me nr. 44-2416/1 (i ndryshuar nëntë herë) mbi kufizimin e lëvizjes duke iu referuar personave më të moshuar se 67 vjeç dhe më të rinj se 18 vjeç, pezullohet si diskriminues në bazë të moshës.

19 ISSHS (2020), Katerina Kollozova, Gjendja e demokracisë në Maqedoninë e Veriut në kohë të pandemisë Kovid-19, i disponueshëm onlajn: <http://www.isshs.edu.mk/the-state-of-democracy-in-north-macedonia-in-the-times-of-the-kovid-19-pandemic/>

**Izolimi me
karantinë, dhe
distancimi social
u bë adresimi
i ri normal i
pandemisë**

ditë²⁰, i cili detyrim po zbatohet me forca të bashkuara midis policisë dhe armatës. Proporcionaliteti edhe i kësaj mase u vu në pyetje, pasi nuk bazohet mbi vlerësimin individual të rrezikut shëndetësor që shtetasit që po arrinin në Maqedoninë e Veriut po sillnin me vete, pasi protokollin për zbatimin e masës nuk përfshinte testin për praninë e virusit Kovid-Sars-19.

Izolimi me karantinë, dhe distancimi social u bë adresimi i ri normal i pandemisë.²¹ Të gjithë personat që vuajnë nga Koronavirusi, apo personat e dyshuar të kenë patur kontakt me një person të infektuar me Koronavirus do t'i nënshtrohen izolimit të rreptë (karantinës) në kushte shtëpiake (izolimi në shtëpi), në kohëzgjatje nga 14 ditë. Personat e përmendur më lart detyroheshin të nënshkruanin deklaratë me shkrim, për të dhënë pëlqimin se do t'u përmbaheshin masave, me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale. Zbatimi i masës së izolimit të rreptë (karantinës), u siguroi nga Ministria e Brendshme. Zyrtarët e policisë sipas rastit vizitonin shtëpitë e personave të izoluar, për të kontrolluar nëse ata po respektonin masat.²² Në praktikë, kishte raste të shkeljes së masës, dhe kundër personave të tillë u ngritën kallëzime penale. Kështu, u imponua sanksioni i ri financiar, sanksionet për individët që nuk po respektonin rregullat e karantinës, që nuk po mbanin maska fytyre, apo për tubimin e grupeve të mëdha. Këto raste trajtoheshin si raste urgjente përpara gjykatave themelore. Gjykimet po mbaheshin ballë-për-ballë, duke mbajtur distancë dhe duke përdorur pajisje mbrojtëse. Aktgjykimet ishin me efekt, ndërsa gjjobat e shqiptuara ishin të larta. Kjo rezultoi me 977 propozime për gjobitjen e 1243 personave, dhe 922 aktgjykime kundër 1167 qytetarëve²³. Gjykata themelore nuk i mban të dhënat të ndara sipas gjinisë, për të mundësuar analizën gjinore. Megjithatë, vetëm 7 aktgjykime kishin qenë ekzekutive. Sistemi i menaxhimit financiar për momentin nuk ofron informacione se sa nga gjjobat janë paguar.

20 Neni 2 paragrafi 4, Dekreti me fuqi ligji për Zbatimin e Ligjit të Mbrojtjes së Popullsisë nga Sëmundjet Ngjitëse në Gjendje të Jashtëzakonshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 72, 21 mars 2020, i ndryshuar me Dekretin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Dekretit me Fuqi Ligji për Zbatimin e Ligjit të Mbrojtjes së Popullsisë nga Sëmundjet Ngjitëse në Gjendje të Jashtëzakonshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 76, 24 mars 2020 dhe Vendimi mbi Zbatimin e Karantinës së Detyrueshme Shtetërore për Shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga jashtë vendit, me fluturime humanitare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 71/20 "Shtetasit që do të hyjnë në vend në vendkalimet e përcaktuara kufitare, siç parashikon ligji, do të jenë lëndë e masave të izolimit të rreptë (karantinës) në kohëzgjatje 14-ditore në objekte të destinuar për këtë".

21 Dekreti me Fuqi Ligji për Zbatimin e Ligjit të Mbrojtjes së Popullsisë nga Sëmundjet Ngjitëse në Gjendje të Jashtëzakonshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 72, 21 mars 2020, ndryshuar me Dekretin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Dekretit me Fuqi Ligji të Mbrojtjes së Popullsisë nga Sëmundjet Ngjitëse në Gjendje të Jashtëzakonshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 76, 24 mars 2020

22 Shihni Nenin 3 të Dekretit të përmendur më lart.

23 Gjykata Themelore 1, përgjigja në kërkesën që ka si bazë aktin e lirisë së informimit nga QHKP, korrik 2020

**Sistemi i
menaxhimit
financiar për
momentin
nuk ofron
informacione se
sa nga gjobat
janë paguar**

Çlirime nga kufizimi i lëvizjes lejoheshin me të lëshuarit e licencës (lejes) për grupet e kategorizuara, siç janë punonjësit shëndetësorë, bizneset që do të dëmtohen në qoftë se nuk punojnë²⁴. Megjithatë, siç po kalonte koha, edhe masat e kufizimit po kritikoheshin gjithnjë e më tepër. *"Është e mundur që izolimi dhe karantina kanë kontribuar për dominimin e rezistencës dhe kritikës ndaj masave restriktive. Shumica e komenteve kanë të bëjnë me shtrirjen, konsistencën dhe kategoritë që përfshihen me masat, reduktimin e të drejtave dhe lirive individuale dhe preferencën e përgjegjësive individuale, në vend të disiplinimit me dënim."*²⁵ Çuarja drejt një trendi në rritje të refuzimeve, nga ana e qytetarëve të dyshuar për virusin, për të pranuar vendimet për izolim shtëpiak nga autoritetet e shëndetësisë, sipas Ministrit të Shëndetësisë Filipçe, arriti kulmin e vet në mesin e qershorit²⁶. Kjo lidhet me besimin e përgjithshëm të qytetarëve në Qeverinë, ashtu siç kanë dëshmuar studime të shumta. Nivelet e larta të besimit, më sa duket, janë tipar i përbashkët i vendeve me përgjigje më efektive ndaj Koronavirusit, të matura me shpërhapjen e ngadalshme dhe vdekshmërinë e ulët²⁷. Përgjigja e rreptë ndaj shpërthimit të virusit në Maqedoninë e Veriut mund t'i përshkruhet besimit shumë të ulët ndaj Qeverisë²⁸.

24 Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës, përmes e-portalit: uslugi.gov.mk lëshoi leje për punonjësit e institucioneve që janë përfshirë në task forcat e krizës, mediet dhe furrat, shërbimet e varrimit, si dhe për bizneset që kanë regjistruar ndërrimin e tretë dhe të katërt.


25 ISSHS (2020) Ana Blazheva, Katerina Kollozova "Matja e autoritarizmit nga poshtë" në shoqërinë maqedonase në kontekstin e krizës së Kovid-19, e disponueshme onlajn: <http://www.isshs.edu.mk/measuring-authoritarianism-from-below-in-macedonian-society-in-the-context-of-the-Kovid-19-crisis/>

26 Nova Makedonija "U shpall lista e 138 emrave të personave, që kanë refuzuar vendimin për vetëizolim", e disponueshme onlajn: <https://cutt.ly/Ui4Ddds>

27 <https://foreignpolicy.com/2020/04/15/secret-success-coronavirus-trust-public-policy/>

28 Instituti Republikan Ndërkombëtar (IRI) Qendra e Gjetjeve nga hulumtimi me sondazh në Kosovë, Bosnje e Hercegovinë (BeH), Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, publikuar më date 28 maj 2020.

Grafiku 6
Besimi në institucionet²⁹
Burimi: IRI (2020), Qendra e Gjetjeve në Hulumtime me Sondazh



Pas²⁹një fushate të organizuar kundër masave të ndërmarra parimisht nga ana e pronarëve të qenve, e pastaj prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, masat u zbutën, duke lejuar çlirim nga rregulla e lëvizjes së kufizuar për këto kategori të njerëzve. Duhet theksuar se çlirimi nga masa nuk kishte ndonjë efekt mbi njerëzit që jetojnë në pavarur (që jetojnë vet), apo mbi ata që jetojnë me prindërit e tyre të moshuar, për shkak të godinave të paaksesueshme. Kjo, në esencë, tregon se si procesi i zhvillimit të masave nuk ndoqi vlerësimin e ndikimit mbi grupet vulnerabël dhe se masat nuk iu nënshtruan vlerësimit të proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë së tyre, ashtu siç kërkojnë KEDNJ dhe Kushtetuta. Megjithatë, çlirimi nga masa i viktimave të dhunës, që të mund të largohen nga shtëpia e dhunshme gjatë orës policore, përfaqësuar nga Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, u njoh si i dobishëm me hulumtimin e zbatuar për qëllimet e këtij studimi (shikoni pjesën mbi dhunën ndaj grave).

Megjithatë, kufizimi i lirisë së lëvizjes, së bashku me disa masa të tjera që u vendosën, si çlirimi nga puna për shkak të kujdesit ndaj fëmijës, që seriozisht preku kapacitetin e institucioneve ku punojnë kryesisht gra (gjegjësisht, qendrat e kujdesit social, shërbimet lokale, etj.), limituan aksesin në shërbime. Disa nga këto kufizime kishin ndikim serioz

²⁹ Sondazhi u zbatua në emër të Qendrës së Gjetjeve të Hulumtimeve me Sondazh të Institutit Ndërkombëtar Republikan, nga Ipsos Strategic Marketing në periudhën nga 16 nëntori e deri më 30 nëntor 2018

**Qytetarëve iu
garantohet liria
e bashkimit
për t'i ushtruar
dhe mbrojtur
të drejtat e
tyre politike,
ekonomike,
shoqërore dhe
të drejtat dhe
bindjet e tjer**

në të drejtat e grave për shëndetn dhe të drejtat riprodhuese, meqë përveç dhënies së shërbimeve të tjera (nga dentisti e deri tek abortimi), nuk u konsideruan si urgjente, andaj dhe nuk u vendosën³⁰.

Liria e tubimit

Liria e tubimit apo liria e bashkimit, si e drejtë individuale, u jep mundësinë njerëzve të tubohen në vende private dhe/ose publike dhe në vende nën qiell të hapur ose/ dhe të mbyllura. Andaj, ndërveprimi fizik shoqëror është i paevitueshëm. Konform Nenit 20 dhe 21 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut *"Qytetarëve iu garantohet liria e bashkimit për t'i ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e tyre politike, ekonomike, shoqërore dhe të drejtat dhe bindjet e tjera...."* *"Qytetarët kanë të drejtë në mënyrë të qetë të tubohen dhe të shprehin protestë publike, pa paraqitje paraprake dhe pa leje të posaçme. Shfrytëzimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm në kushte të gjendjes së luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme."*

U miratua një Dekret me fuqi ligji të aplikimit të Ligjit për tubime publike gjatë gjendjes së jashtëzakonshme³¹, i cili ndaloi "tubimet në grupe më të mëdha se pesë persona". Kjo rezultoi me anulimin e të gjitha ngjarjeve sportive, si dhe me caktimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare për muajin prill 2020.

Liritë fetare

Edhe pse Neni 54 i Kushtetutës përcakton lirinë e shprehjes së bindjeve fetare si e drejtë e cila nuk mund të kufizohet, sipas KEDNJ, kjo e drejtë mund të kufizohet. Është kjo për faktin se kjo e drejtë ka dy aspekte të ndryshëm: (i) *forum internum*, çka qëndron brenda personalitetit dhe mendjes sonë dhe si e tillë nuk mund të kufizohet, dhe ajo që është përcaktuar me dispozitë kushtetuese dhe e cila nuk mund të rrëmbehet; dhe (ii) *forum externum*, që do të thotë, manifestimi i bindjes fetare, që, në pajtim me praktikën gjyqësore të KEDNJ, mund t'i nënshtrohet kufizimit. Duke marrë parasysh epërsinë e së drejtës ndërkombëtare mbi sistemin e brendshëm juridik, autoritetet kombëtare mund të shtrëngojnë të drejtat fetare. Në vend të kësaj, ato përzgjedhën të lëshojnë rekomandime që të mos bëhen tubime, të mos bëhen lutje dhe të mos zbatohen rituale masive fetare. Kishat³² mbeten të hapura. Megjithatë, u shfaqen ritualet fetare gjatë Pashkëve dhe Bajramit, që çoi drejt një numri të lart të të infektuarve.

30 Prezantimi i dr. Daniella Markovska, nga Poliklinika Jane Sandanski mbi të drejtat shëndetësore dhe riprodhuese në kohë të Kovid-19, organizuar nga Komisioni i Mundësive të Barabarta i Komunës së Gazi Babës.

31 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 71/20, Neni 1, Vendimi për ndryshimin e Vendimit për Masat e Parandalimit të Depërtimit dhe Shpërhapjes së Koronavirusit Kovid-19, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 70, 20 mars 2020, Vendimi për Masat e Parandalimit të Depërtimit dhe Përhapjes së Koronavirusit Kovid-19 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 62/20, 63/20, 64/20, dhe 66/20).

32 Me kisha nënkuptojmë të gjitha objektet e adhurimit.

Arsimtari dhe stafi akademik ishin mesatarisht të përgatitur për mësimnxënie "onlajn", duke marrë në konsideratë faktin se arsimi fillor dhe i mesëm është përballur me mësimnxënie onlajn për herë të parë

E drejta e arsimit

Ky nuk ishte rasti me të drejtën e arsimit, që u kufizua që nga 11 marsi, kur Ministria e arsimit dhe shkencës informoi se proceset arsimore në të gjitha segmentet dhe llojet do të ndërpriten, në bazë të Dekretit me fuqi ligji, i cili ndalonte procesin mësimor ballë-për-ballë dhe zbatimin e orëve në të gjitha kopshtet e fëmijëve, ambientet e zhvillimit të hershëm të fëmijëve, ambientet ditore të fëmijëve, si dhe në shkollat fillore dhe të mesme. Zbatimi i orëve në institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet publike të shkencës u ndalua po ashtu, si dhe banimi kolektiv në konviktet dhe objektet e tjera arsimore ndërsa pushuan së punuari, si bibliotekat, laboratorët, sallat e sportit, etj. U kufizua dhe ndjekja e të gjitha aktiviteteve jashtëshkollore³³. Të gjitha këto aktivitete u transferuan onlajn, duke krijuar barrë plotësuese për prindërit në shkollimin e fëmijëve të tyre, meqenëse u kërkua nga ata të ndanin përgjegjësitë e mësimdhënies së bashku me arsimtarët. Transmetuesi kombëtar i televizionit gjithashtu përgatiti një program edukativ për nxënësit e shkollave fillore. Arsimtari dhe stafi akademik ishin mesatarisht të përgatitur për mësimnxënie "onlajn", duke marrë në konsideratë faktin se arsimi fillor dhe i mesëm është përballur me mësimnxënie onlajn për herë të parë. Ajo që morri kritikë të posaçme ishte mungesa e mjeteve mbështetëse për nxënësit që vijnë nga familjet me gjendje të pafavorshme sociale, të cilat nuk kanë internet e as pajisje (kompjuter personal, apo telefon të mençur), për të ndjekur aktivitetet arsimore. Për këta nxënës, e drejta e arsimit ishte *de facto* e rrëmbyer. Gjithashtu, jo të gjithë prindërit mund t'i mbështesnin fëmijët e tyre në shkollimin në shtëpi, pasi ata kishin përgjegjësi pune, të cilat nuk linin kohë për të zëvendësuar arsimtarët në shkollë. As autoritetet nuk ofruan zgjidhjen e kësaj çështjeje. Duke marrë në konsideratë modelin patriarkal të familjes, ku prej grave pritet të marrin barrën e punës së papaguar në shtëpi, me fëmijët në shtëpi, dhe aksesin e limituar në arsim, në kombinim me lëvizjen e kufizuar, në disa nëngrupe, rezultati ishte se vajzat përjetuan krizë nervore, siç do të provohet nga analiza në Kreun 2.

Më të adaptuarit dhe më të gatshmit për sfidën e shkollimit onlajn ishin Universitetet, të cilët më veç ishin përfshirë në mësimnxënie onlajn edhe më herët, si rezultat i bashkëpunimeve ndërkombëtare. Ata transferonin ligjëratat në platforma jo të specializuara onlajn për mësimnxënie onlajn (siç është ZOOM, MS Teams, Google Meet, etj.), si përgjigje ndaj mungesës së mjeteve të disponueshme onlajn të mësimnxënies përpara pandemisë së virusit. Shumica e aktiviteteve studentore ishte e mundur të kompletoheshin përmes platformave dhe mësimnxënies onlajn, mirëpo gjithashtu duhet të marrim parasysh se disa programe studimore nuk mund të përfundohen si mësim në distancë (p.sh., mjekësia, stomatologjia, etj.). Aq më tepër, problemi po bëhet gjithnjë e më i madh, sepse disa studentë mbrojtën punimin e diplomës apo punimin master në internet, gjë kjo e cila ka hapur një debat për atë nëse kurset onlajn duhet të akreditohen dhe nëse diploma mund të dorëzohet onlajn, pa akreditimin e programit studimor onlajn. Cilësia e arsimit në kohë pandemie duhet të vlerësohet në periudhën

33 Për më tepër detaje, shihni Vendimin për masat e parandalimit të depërtimit dhe shpërhapjes së Koronavirusit Kovid-19; Dekreti me fuqi ligji mbi zbatimin e Ligjit të arsimit fillor në Gjendje të jashtëzakonshme "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 76/20

**Transferimi i
aktiviteteve
arsimore onlajn
ka krijuar barrë
plotësuese për
djemtë dhe
vajzat me aftësi
të kufizuara**

verore, si dhe duhet testuar disa qasje strategjike për vazhdimin e procesit arsimor në periudhën nga shtatori, e sidomos nëse do të zhvillohet vala e dytë e virusit.

Transferimi i aktiviteteve arsimore onlajn ka krijuar barrë plotësuese për djemtë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, me të cilën, në praktike, Neni 24³⁴ në lidhje me Nenin 5 dhe Nenin 3³⁵ të KDKPAK u janë rrëmbyer të drejtat, si për shembull, orët arsimore onlajn në TV nuk ishin përshtatur dhe nuk janë vënë në dispozicion në formate të përshtatshme për djemtë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, pra, me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara. Veç kësaj, fëmijët me aftësi të kufizuar që janë arsimuar në shkolla të posaçme, nuk janë synuar me asnjë masë edukative në periudhën shkollore gjatë pandemisë, pra, nga 10 marsi deri më 10 qershor.

Liria e shprehjes

Neni 54 i Kushtetutës rregullon se liria e bindjes personale, ndërgjegjja, mendimi dhe konfesionit fetar nuk mund të kufizohen, madje as në gjendje të jashtëzakonshme. KEDNJ ka një interpretim më fleksibël dhe parashikon kufizimin e lirisë së shprehjes për arritjen e objektivave legjitime edhe atëherë kur është e domosdoshme (proporcionaliteti). Në këtë kohë dixhitale, kur informacionet që shpërndahen përmes mediave sociale dhe internetit janë vendimtare për t'u informuar, liria e shprehjes dhe e drejta për t'u informuar përmes shpërndarjes së lajmeve dhe informacioneve, mund të kufizohet.

Neni 9 i KDKPAK qartë mban aksesueshmërinë fizike si parakusht që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë pa kufizime të gjitha të drejtat e tyre dhe liritë themelore, që do të thotë, aksesueshmëri në mjedisin fizik, në transport, si dhe në informacione dhe komunikime, duke përfshirë këtu dhe teknologjitë dhe sistemet e informimit dhe komunikimit, dhe në ambiente dhe shërbime të tjera që janë të hapura, apo që i jepen publikut, si në zonat urbane, ashtu dhe në ato rurale. Siç shënon Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Nenet 9 dhe 21 ndërlidhen në çështjen e informimit dhe komunikimit, dhe që të dyja nenet kanë qasje horizontale dhe bëjnë pjesë në të ashtuquajturat, të drejta hibride. Neni 21 përcakton se vendet "duhet t'i marrin të gjitha masat për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara mund t'i ushtrojnë të drejtat e veta për lirinë e shprehjes dhe opinionit, duke përfshirë dhe lirinë e kërkimit, pranimit dhe dhënies së informacioneve dhe ideve në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpër të gjitha format e komunikimit sipas përzgjedhjes së tyre". Pasi aksesueshmëria paraqet parakusht për personat me aftësi të kufizuara, refuzimi i aksesit në mjedisin fizik, transportin, informimin dhe komunikimin dhe në shërbimet e hapura për publikun e gjerë, përfshirë dhe akomodimin e arsyeshëm, do të konsiderohet si akt diskriminimi³⁶. Në situata rreziku, fatkeqësish natyrore dhe konfliktesh të armatosura,

34 Rregullon detyrimin se e drejta e arsimit do të realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësisë së barabartë

35 Neni 5 i KDKPAK ka të bëjë me barazinë dhe mosdiskriminimin, ndërsa mosdiskriminimi më tej përcaktohet si një nga parimet e përgjithshme të rregulluara me Nenin 3 të KDKPAK.

36 Shihni KDKPAK: CRPD/C/11/3 paragrafi 20

Komisioni nënvizon se vendet detyrohen³⁷ t'i vënë në dispozicion të gjitha shërbimet e jashtëzakonshme (Neni 9 dhe Neni 21) për personat me aftësi të kufizuara, ose ndryshe, jetët e tyre nuk mund të shpëtohen apo nuk mund të mbrohet mirëqenia e tyre (Neni 11). Komisioni nënvizon detyrimin se në cilat raste shteti duhet të sigurojë së të gjitha informacionet në lidhje me emergjencën janë të disponueshme në një format që është i aksesueshëm për llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara³⁸, ku përfshihen personat e shurdhër, me anë të gjuhës së shenjave, dhe në gjuhët e ndryshme që fliten në territorin e personit, përfshirë dhe alfabetin braj, komunikimi augmentativ dhe alternativ, si dhe të gjitha mjetet e aksesueshme, modelet dhe formatet e komunikimit sipas përzgjedhjes së personave me aftësi të kufizuara në ndërveprimet zyrtare" (Neni 21(b)).³⁹ Duhet të kërkohet trajnim për ndërgjegjësim në lidhje me aftësitë e kufizuara për të gjithë stafin civil dhe qeveritar, për personelin e shpëtimit dhe emergjencave, dhe për aktorët potencialë të përfshirë në emergjencë⁴⁰. Në këtë kuptim, Kryesuesi i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara deklaroi se *"me kryerjen e detyrimeve të tyre konform KDPAK dhe me përmbushjen e zotimeve të tyre, Agjenda e Zhvillimit të qëndrueshëm do të mund t'i mbrojë të drejtat dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara. Me veprimin e tillë, vendet duhet të marrin në konsideratë diversitetin në mesin e personave me aftësi të kufizuara, me fokus të posaçëm në gjininë dhe moshën, dhe në gjendjen e personave me aftësi të kufizuara që po përballen me privim dhe mundim."*⁴¹ .

Ndonëse ushtrimi i këtyre të drejtave lidhet drejtpërsëdrejti me vlerat demokratike të një shoqërie, është e hollë vija midis regjimit autokratik dhe kufizimit të këtyre të drejtave, për të arritur shpërndarje korrekte dhe të vërtetë të informacioneve gjatë pandemisë dhe kontroll të narrativeve si dhe të lajmeve të rrejshme dhe shpërhapjes së keqinformimeve në lidhje me virusin, me qëllim mbrojtja e shëndetit të përgjithshëm të popullsisë. Përderisa disa vende kanë marrë në konsideratë përkufizimin e krimeve të reja në lidhje me lajmet e rrejshme dhe keqinformimet gjatë pandemisë, në Maqedoninë e Veriut, Kodi aktual Penal, më saktësisht, Nenet 205 dhe 206 u përdorën si më të përshtatshëm për të luftuar keqinformimin në lidhje me virusin⁴².

37 Shihni KDPAK: CRPD/C/11/3 paragrafi 33

38 Shihni: CRPD/C/SLV/CO/1, paragrafi 26; CRPD/C/DEN/CO/1, paragrafi 31; CRPD/C/MEX/CO/1, paragrafi 22(b); CRPD/C/GAB/CO/1, paragrafi 27.

39 Shihni: CRPD/C/TKM/CO/1, paragrafi 24; CRPD/C/MNG/CO/1, paragrafi 20; CRPD/C/DEU/CO/1, paragrafi 24; CRPD/C/DOM/CO/1, paragrafi 19; CRPD/C/COK/CO/1, paragrafi 22; CRPD/C/MEX/CO/1, paragrafi 22 (a); dhe CRPD/C/KEN/CO/1, paragrafi 22 (b).

40 Shihni: CRPD/C/AZE/CO/1, paragrafi 25; CRPD/C/MEX/CO/1, paragrafi 22(c); dhe CRPD/C/DEN/CO/1, paragrafi 31.

41 KDPAK – Deklarata e Përbashkët: Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Kovid-19, e Kryesuesit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në emër të Komisionit të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe e të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Aftësitë e Kufizuara dhe Aksesin (1 prill 2020), e disponueshme onlajn: https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/TB/KOVID19/Compilation_statements.pdf

42 Sipas BIRN, Ministria e Punëve të Brendshme ka paraqitur dhjetë raste të lajmeve të rrejshme në lidhje me pandeminë përpara Prokurorisë, duke u mbështetur në Nenet 205 dhe 206 të Kodit Penal si bazë ligjore; shihni onlajn: <https://prizma.mk/prijavite-za-lazhni-vesti-megu-pravdata-i-tsenzurata/>

Kështu, në periudhën nga fillimi i pandemisë e deri më 1 korrik, Ministria e punëve të brendshme ka paraqitur 24.567 raste të kundërvajtjes konform Vendimit për mbajtjen e pajisjes mbrojtëse⁴³, mirëpo nuk ka furnizuar QHKP me të dhëna të klasifikuara sipas gjinive, në bazë të kërkesës. Për fat të keq, Ministria nuk ndau numrin e rasteve që ata kanë paraqitur përpara Prokurorisë Publike për keqinformime dhe lajme të rrejshme në lidhje me virusin. Interpretimi i Neni 205, i paragrafit 5⁴⁴ mund të jetë problematik për luftimin efektiv të lajmeve të rrejshme, sepse ai përkufizon përgjegjësinë për shpërhapjen e sëmundjes ngjithëse duke shpërndarë informacione dhe deklarata jo të vërteta për shfaqjen e sëmundjes së pashërueshme. Sëmundja e pashërueshme është pjesë e këtij neni, e cila është tepër konkrete dhe mund të prekë efektshmërinë e rasteve të paraqitura përpara Prokurorisë.

Gjobat duhet qenë proporcionale, pasi ato nuk duhet të dekurajojnë gazetarët të vazhdojnë funksionin e tyre në shëndetin publik për t'u ofruar qytetarëve informacione në lidhje me virusin dhe me zhvillimin e demokracisë. Shoqëria civile gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në kontrollimin e narrativeve dhe kontrollimin dhe diskreditimin e lajmeve të rrejshme dhe keqinformimeve. Në këtë drejtim, Instituti i shkencave sociale dhe studimeve humanitare ka monitoruar mediat sociale gjatë periudhës së jashtëzakonshme dhe ka raportuar se *"prania e komenteve që kanë të bëjnë me teoritë konplotiste po vihen në dukje gjatë kësaj periudhe dhe gjithashtu po rritet numri i komenteve që mohojnë virusin"*⁴⁵. F2N2 po ashtu ka diskredituar disa narrative dhe azhurnime keqinformuese, mirëpo dukshmëria e tyre ka qenë shumë e ulët.

Duke marrë parasysh detyrimin konform KDPAK, konferencat e para për shtyp janë bërë pa interpretim në gjuhën e shenjave. Me kërkesën e Polio Plus – lëvizja kundër aftësive të kufizuara – një Organizatë e personave me aftësi të kufizuara (në tekstin e mëtejshëm OPAK), përmes mediave, Qeveria filloi t'i mbante të gjitha konferencat për shtyp edhe në gjuhën e shenjave. Kështu, përveç informacioneve të shpërndara në konferencat për shtyp, të gjitha informacionet e shpërndara nga mediat e tjera lidhur me virusin dhe masat e ndërmarra nuk u publikuan në formate të aksesueshme. Kjo sfidoi informimin e personave me aftësi të kufizuara, pasi as ueb faqja posaçërisht e zhvilluar për Kovid-19 nga Qeveria, nuk ishte e aksesueshme për qytetarët me aftësi të kufizuara, si dhe shërbimet e emergjencës nuk kishin adaptuar numrat e tyre dhe përgjigjen për thirrjet e personave me aftësi të kufizuara.

Kështu, përveç informacioneve të shpërndara në konferencat për shtyp, të gjitha informacionet e shpërndara nga mediat e tjera lidhur me virusin dhe masat e ndërmarra nuk u publikuan në formate të aksesueshme

43 MPB, përgjigja në kërkesën e QHKP në bazë të Ligjit të Aksesit të Lirë në Informacione, numër 16-1-2 810, korrik 2020

44 Neni 205, paragrafi 5 rregullon: Ai që do të rrezikojë sigurinë e tjetrit me trajtimin e gabuar të transmetimit apo me shpërndarjen e deklaratës së gabuar për ekzistimin e sëmundjes së pashërueshme do të gjobitet, apo do të dënohet me burg për 6 vjet.

45 ISSHS (2020) Ana Bllazheva, Katerina Kollozova Matja e "Autoritarizmit nga poshtë" në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut në kontekstin e krizës me Kovid-19, e disponueshme onlajn: <http://www.isshs.edu.mk/measuring-authoritarianism-from-below-in-macedonian-society-in-the-context-of-the-Kovid-19-crisis/>

E drejta e privatësisë

Më 13 prill 2020,⁴⁶ Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës (në tekstin e mëtejshëm MSHIA) dhe Ministria e shëndetësisë (në tekstin e mëtejshëm MSH), promovuan aplikacionin STOP KORONA⁴⁷ për qytetarët, duke i inkurajuar ata të bëhen shfrytëzues me shkarkimin e saj. Në këtë mënyrë, shfrytëzuesit (kryesisht qytetarët) do të alarmoheshin nëse kanë qenë shumë afër një personi që është infektuar me Kovid-19 në 14 ditët e fundit, apo jo; dhe autoritetet do të kishin akses të drejtpërdrejtë në informacionet mbi personat me të cilët personi i infektuar ka qenë në kontakt, duke e bërë më të lehtë përkufizimin e klasterëve dhe izolimin e tyre, gjë kjo e cila në fund do të çojë drejt frenimit të shpërhapjes së virusit. Të dhënat lidhur me shëndetin sipas Ligjit të ri të mbrojtjes së të dhënave⁴⁸ që është në pajtim me Direktivën e BE-së për mbrojtjen e të dhënave 2016/679 janë të dhënat personale lidhur me shëndetin fizik dhe mendor të individit, përfshirë dhe të dhënat mbi mbrojtjen shëndetësore dhe shërbimet e pranuar. Ligji në Nenin e vet 13 (paragrafi 9) rregullon procesimin e të dhënave shëndetësore, sidomos kur “procesimi është me interes publik dhe për mbrojtje nga kërcënimet ndërkufitare që janë serioze për shëndetin, si dhe për sigurimin e standardeve të larta dhe sigurisë së mbrojtjes shëndetësore.” Në këtë kuptim, Ligji po ashtu rregullon situatat kur rregullat e mbrojtjes së të dhënave dhe e drejta e privatësisë mund të kufizohen, kur është në pajtim me “interesin e publikut të gjerë të vendit, duke përfshirë këtu çështjet monetare, buxhetore, tatimore, **shëndetin publik** dhe mbrojtjen sociale (Neni 27. p. 5)”. Aspekti problematik i Aplikacionit STOP KORONA qëndron në profilimin e tij.⁴⁹ Me **“profilim”** nënkuptojmë të gjitha format e procesimit automatik të të dhënave personale që përfshin përdorimin e të dhënave personale për vlerësimin e aspekteve personale të individit, e konkretisht për analizimin dhe parashikimin e gjendjes ekonomike, shëndetit, preferencave, interesave, sjelljes, vendndodhjes dhe lëvizjes. Atë që bëjnë epidemiologët me hulumtimet e tyre, dhe në çka iu ndihmon Aplikacioni STOP KORONA, është bërja e profilimit.

Për më tepër, autoritetet kanë dështuar të japin vlerësimin rigoroz për përputhjen e Aplikacionit me politikën dhe rekomandimet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me atë se si ta limitojnë ndikimin negativ të aplikacioneve të gjurmimit dhe të teknologjive të tjera që monitorojnë përhapjen e Kovid-19, mbi të drejtat themelore, posaçërisht mbi mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë. Komisioni Evropian dëshiron të sigurohet se të gjitha aplikacionet respektojnë standardet e njëjta: mbrojtja e të dhënave, privatësia, siguria dhe efektshmëria⁵⁰. Kjo posaçërisht i referohet debatit

46 RMV ishte ndër vendet e para në BE që filloi përdorimin e këtij mjeti për detektimin e bartësve të ri të infektuar

47 <https://stop.koronavirus.gov.mk/en> Ky aplikacion ishte donacion i Kompanisë TI Nextsence nga Maqedonia e Veriut

48 Ligji i Mbrojtjes së të Dhënave (Gazeta Zyrtare Nr. 42/2020), i disponueshëm onlajn: https://dzlp.mk/sites/default/files/u4/zakon_zastita_na_licnite_podatoci.pdf

49 Liljana Pecova, https://respublica.edu.mk/mk/blog/Kovid-19-1-1?fbclid=IwAR3E1xA0ZRgc8Hskha_Rc9LBZfioQjt_YfgpbGfI_U8sRUfI6MUZKSmAM

50 <https://audiovisual.ec.europa.eu/en/video/I-189464?lg=OR&fbclid=IwAR0dUXqudt4qmdqT65hvoZ7RmOLHJ9DzXN0s7yqQ4X3ZcelfK63JOHbobFs>

Ministria tha se aplikacioni nuk mbledh të dhënat mbi vendndodhjen, ndërsa askund nuk është sqaruar përse aplikacioni kërkon aksesin për vendndodhjen e telefonit gjatë instalimit

aktual nëse aplikacioni STOP KORONA kërkon zbulimin e vendndodhjes suaj. Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës informon për ueb faqen STOP KORONA, se aplikacioni punon me *bluetooth* dhe anonimizim të dhënave të shfrytëzuesve⁵¹; që është në kundërshtim me dëshmitë e shfrytëzuesve që janë shpërndarë publikisht, se kanë dhënë pëlqimin për akses në të dhënat e trafikut dhe vendndodhjes, nëse donin ta përdornin aplikacionin. "Ministria tha se aplikacioni nuk mbledh të dhënat mbi vendndodhjen, ndërsa askund nuk është sqaruar përse aplikacioni kërkon aksesin për vendndodhjen e telefonit gjatë instalimit. Nuk është zbuluar nëse do të ndryshohet apo jo numri i identifikimit, të cilin telefoni yt e dërgon përmes *bluetooth*".⁵²

Aksesi në të dhënat e trafikut dhe të vendndodhjes nga ana e autoriteteve, sipas legjislacionit maqedonas, është çdoherë lëndë e autorizimit gjyqësor, sidomos në rastet individuale dhe atëherë kur janë lëndë e hetimit penal. Duke marrë në konsideratë se përdorimi i aplikacionit është konsideruar të jetë jo vetëm vullnetar, por edhe i detyrueshëm për personat në izolim, kjo çoi drejt debateve, ku aktivistët dhe ekspertët e TI-së kanë ngritur shqetësime në lidhje me legalitetin e masave të këtyre, qëllimet e tyre dhe transparencën e operacionit. "Institucionet mund të përdorin dhe të promovojnë një softuer falas me kod të hapur, nëse dëshirojnë qytetarët t'u besojnë masave teknologjike që aplikohen për të adresuar virusin. Për akses publik në kodin burimor të aplikacionit, për t'u rishikuar nga ekspertët të sigurisë, nevojiten zgjidhje teknike të fuqishme dhe mirë të zhvilluara."⁵³ Në këtë kuptim, shfrytëzuesit akoma nuk kanë informacione se ku do të mbahen të dhënat e tyre dhe për çka do të përdoren, çfarë protokolle do të aplikohen, pa rrezikuar sigurinë dhe privatësinë e shfrytëzuesve. Paevitueshëm, zhvillimi i këtyre ngjarjeve preku një numër të shkarkimeve dhe përdorimit aktual të aplikacionit për qëllimin e bërë. Edhe pse dita e parë ishte shumë e suksesshme me 5.000 shkarkime, periudha më pas nuk mund të vlerësohet si pozitive deri më 7 maj, me 55.000 shfrytëzues që kishin instaluar aplikacionin STOP KORONA. Të dhënat mbi gjinitë e shfrytëzuesve nuk mund të gjenerohen për të analizuar gjininë, sepse aplikacioni nuk i mbledh ato dhe andaj, nuk ishim në gjendje të merrnim të dhënat se sa shfrytëzues kanë përdorur këtë aplikacion në mënyrë aktive.

Në qershor, Qeveria, në bazë të një Dekreti me fuqi ligji, promovoi kartelën e re të brendshme të pagimit për 324.479 kategori vulnerabel të qytetarëve, duke ofruar mbështetje financiare nga 28 milionë euro⁵⁴ dhe duke subvencionuar ekonominë dhe sektorin e prodhimit të brendshme. Për aktivimin e kësaj "kartele të brendshme të pagimit" shfrytëzuesi duhet të shënonte numrin amë në ueb faqen e caktuar për këtë⁵⁵. Emrat dhe mbiemrat e shfrytëzuesve dhe të dhënat e tyre bankare janë informacione publike⁵⁶ dhe janë të disponueshme në ueb faqen pa u mbrojtur si duhet,

51 Shihni detajet në: <https://stop.koronavirus.gov.mk/>

52 Kuzevski Mite, Vidi Vaka, Intervistë për PINA <https://pina.mk/3236-mobilni-aplikatsii-za-kovid-19-i-linijata-megu-zashtitata-i-zgolemeniot-nadzor/>

53 Sloboden Softuer, Intervistë për PINA <https://pina.mk/3236-mobilni-aplikatsii-za-kovid-19-i-linijata-megu-zashtitata-i-zgolemeniot-nadzor/>

54 <https://vlada.mk/node/21691>

55 <https://kupuvalidomasno.gov.mk/mk/>, e vizituar për herë të fundit më 13.06.2020

56 <https://kupuvalidomasno.gov.mk/mk/listusers>, e vizituar për herë të fundit më 13.06.2020

pasi nuk është i pranishëm “**pëlqimi** i individit në fjalë”, që hap pyetjet e legalitetit të këtij veprimi.

Në fund, Inspektorati shtetëror shëndetësor dhe sanitar, më 26 qershor publikoi listën e emrave të të infektuarve me Kovid-19 dhe të adresave të tyre, pra personat që kishin refuzuar të merrnin vendimin për karantinë. Vetë publikimi mund që potencijalisht të bën shkelje të Nenit 84 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, edhe pse web faqja e Agjensionit nuk posedon me informata për një shkelje të tillë.

1.2. LEGALITETI DHE LEGJITIMITETI I MASAVE SI PËRGJIGJE NDAJ KOVID-19 DHE AKSESI NË DREJTËSI

Pas disa javësh të debateve të zhvilluara mes përfaqësuesve dhe ekspertëve shëndetësor, Presidenti shpalli gjendje të jashtëzakonshme. Kushtetuta me Nenin 125 përcakton se “Gjendja e jashtëzakonshme paraqitet kur ndodhin fatkeqësi të mëdha natyrore ose epidemi.” “Vendimi për ekzistimin e një gjendjeje të epidemisë është parakusht, edhe pse jo parakushti i vetëm, për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme”⁵⁷. Kështu, Presidenti bazon shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme mbi propozimin dhe analizën e gjendjes nga Qeveria dhe shpalljen e pandemisë botërore Kovid-19 nga OBSH⁵⁸. Megjithatë, duke mos bërë dallimin midis “shpalljes së epidemisë” dhe “shpalljes së ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme”, Presidenti shpalli gjendjen e jashtëzakonshme automatikisht, pa konsultim plotësues paraprak të ndonjë institucioni tjetër të brendshëm relevant (Ministria e shëndetësisë apo Instituti i shëndetit publik).⁵⁹ “Vendimi për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme duhej të shoqërohej me vlerësimin e kushteve, e jo vetëm të natyrës shëndetësore, por kushteve të mekanizmave mbrojtës të shtetit dhe pas vlerësimit paraprak dhe planit të qartë se cilat masa duhet t’i marrin të gjitha institucionet, konform parimeve të proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë, me qëllimin e përgjithshëm të reduktimit të ndikimit negativ mbi krizën shëndetësore”⁶⁰.

Kështu, nuk u zbatua një vlerësim i tillë dhe një strategji për t’u përgjigjur ndaj Kovid-SARS-19, siç ishte rasti me shtetet tjera, apo të paktën nuk u bënë publike që monitoruesit e pavarur t’iu referoheshin atyre. Duke shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, Qeveria teknike mori përsipër fuqitë ligjvënëse. Fakti se Qeveria gjatë procesit miratoi 150 dekrete me fuqi ligji⁶¹ dhe 73 Vendime të detyrueshme⁶² dhe ndryshoi apo pezulloi një numër të lartë vendimesh, të frymëzuar me sigurinë juridike të qytetarëve dhe bizneseve në kohëra krize, sidomos duke prezantuar një model të masës gjatë një konference për shtyp dhe tjetrin në një dekret, apo me publikimin e formave të real-

57 V. Kambovski dhe të tjerët.: Analiza e aspekteve juridike të gjendjes së jashtëzakonshme”, Shkup, maj 2020

58 Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në Maqedoninë e Veriut u bë më 18 mars, ndërsa OBSH shpalli pandeminë më 13 mars <https://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-Kovid-19/news/news/2020/3/who-announces-Kovid-19-outbreak-a-pandemic>

59 Ibid, fq. 6

60 Ibid

61 <https://myla.org.mk/%d0%b2%d0%be%d0%bd%d1%80%d0%b5%d0%b4%d0%bd%d0%b0-%d1%81%d0%be%d1%81%d1%82%d0%be%d1%98%d0%b1%d0%b0/>

62 <https://vlada.mk/uredbi-Kovid19>

izimit të masave një ditë përpara afatit për aplikim, etj. Duke marrë parasysh se periudha *vacatio legis* për këto akte ishte shumë e shkurtër, shumica e vendimeve hynë në fuqi ditën e njëjtë, apo ditën vijuese pas publikimit në Gazetën Zyrtare, dhe pasi aksesi në Gazetën Zyrtare nuk është falas për të gjithë, por vetëm me abonim, në fillimin e gjendjes së jashtëzakonshme, aksesi në këto akte ligjore ishte i limituar⁶³. Kështu, në mënyrë të përpiktë, Qeveria filloi të publikonte vendimet në ueb faqen e tyre, në pjesën e ueb faqes së tyre të destinuar për Kovid-19; ndërsa organizatat e shoqërisë civile, siç është dhe Shoqata maqedonase e juristëve të rinj ripublikonte vendimet e shpallura në Gazetën Zyrtare, gjë kjo e cila rriti aksesin për të gjithë ata që nuk gëzonin të drejtat e abonimit. Gjithashtu i lartë ishte dhe niveli i hartimit të akteve ligjore në kohë krize.

Sistemi i "kontrollit dhe ekuilibrave të ndërsjellë" u çrregullua, dhe në vend të ndarjes së pushtetit, ne pranuan shkrirjen e dy pushteteve bashkë. Për herë të parë në histori, pushteti ligjvënës dhe ai ekzekutiv u shkrinë në një trup, në Qeveri, e cila ishte e titulluar për të sjellë vendime me fuqi ligji. Qeveria mori pushtetin parlamentar, në vend se të jetë "nën kontrollin parlamentar"⁶⁴.

Sipas Kushtetutës, Gjykata kushtetuese ka autoritetin që të kontrollojë kushtetutshmërinë e ligjeve. Është ky institucioni i vetëm që ka kontrollin gjyqësor për të ekzaminuar kushtetutshmërinë dhe legalitetin e vendimeve mbi masat që miratohen nga Qeveria në gjendje të jashtëzakonshme. Deri më sot, pothuajse çdo vendim i Qeverisë për parandalimin e depërtimit dhe shpërhapjes së Koronavirusit Kovid-19 dhe vënia e masave dhe rekomandimeve mbrojtëse u sfidua, me iniciativat e partive të ndryshme, për të përcaktuar arsyeshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre. Në maj, Gjykata kushtetuese u bë shumë aktive dhe shfuqizoi 6 dekrete me fuqi ligji, dhe i dha fund zbatimit të një vendimi qeveritar dhe dy dekreteve me fuqi ligji të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme⁶⁵.

**Vlefshmëria
juridike e këtyre
akteve ligjore
që u miratuan
në gjendje të
jashtëzakonshme
duhet qenë në
fuqi gjatë kësaj
kohe dhe fuqia
e tyre ligjore
duhet të pushojë
automatiksht**

Vlefshmëria juridike e këtyre akteve ligjore që u miratuan në gjendje të jashtëzakonshme duhet qenë në fuqi gjatë kësaj kohe dhe fuqia e tyre ligjore duhet të pushojë automatiksht. Më sa duket, shumica e këtyre akteve ligjore kanë fuqi të zgjatur ligjore dhe vlefshmëria e tyre do të vazhdojë deri në formimin e Qeverisë së re. Mendimi i përgjithshëm është se aktet ligjore janë *in favorem* të popullit dhe bizneseve dhe Qeveria nuk duhet t'i ndërpresë ato. Ato do të vazhdojnë së qeni në fuqi deri sa të shfaqen shkaqet e arsyetuara për ekzistimin e tyre dhe deri sa të miratohen apo ndalohen nga Parlamenti i ri.

Aksesi në drejtësi për popullsinë e përgjithshme, e sidomos për grupet vulnerabël u ndërpre, pasi Këshilli gjyqësor, më datë 17.03.2020 miratoi vendimin për mënyrën e procesimit të lëndëve gjyqësore në kushte të rrezikut të shtuar nga shpërhapja e infektimit me Kovid-19, me të cilët të gjitha gjykatat u angazhuan për t'i ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë dhe shëndetësisë për reduktimin e shpërhapjes së infektimit. Në kuptimin e procedurave gjyqësore, vendimi përcakton që vetëm rastet

63 Kjo u ndryshua më 30 mars, kur Qeveria miratoi një Vendim, me të cilin aksesi në Gazetën Zyrtare u bë falas: Vendimi Nr. 44-2638/1


64 V. Kambovski dhe të tjerët: Analiza e aspekteve juridike të gjendjes së jashtëzakonshme", Shkup, maj 2020, fq. 24

65 Vendimet kishin të bënin me kufizimin e shtesave dhe pagave, me gjyqësorin dhe dy vendime kishin të bënin me tatimet. Natyra e vendimeve ishte të parandalohej diskriminimi.

e domosdoshme të hyjnë në proces gjyqësor, siç janë rastet me masë të përkohshme (personat në paraburgim, etj.), rastet që janë në fazën e vendimmarrjes dhe rastet që mund ta shkelin parimin e gjykimit në afat të arsyeshëm, apo rastet që janë urgjente në bazë të ligjit, apo që lidhen me afate të përcaktuara me ligj⁶⁶. Veç kësaj, me Dekretin me fuqi ligji të datës 30.03.2020, Qeveria përcaktoi se afatet ligjore dhe përfundimtare për ngritjen e padive në proces gjyqësor, propozimet për nisjen e procedurës jokontestimore, parashtrimi i kërkesës për zbatim, procedurës për mbledhjen e provave, apo për nisjen e procedurës tjetër gjyqësore, do të pushojnë së zhvilluari deri në fund të gjendjes së jashtëzakonshme. Kjo rriti pasigurinë ligjore, sepse proceset gjyqësore ose po anuloheshin, ose nuk po caktoheshin fare. Video konferencat, shkëmbimi onlajn i të dhënave, apo format e tjera të zgjidhjes së kontesteve, siç është ndërmjetësimi, as që u promovuan. Së fundi, edhe gjendja me aksesin në drejtësi që u krijua me masat e punës së gjykatave, siç është demonstruar në pjesën mbi dhunën ndaj grave në Kreun 2, kishte efektin e vet mbi lëshimin e masave të përkohshme në rastet e dhunës që ka si bazë gjininë.

Zyrat rajonale të Ministrisë së drejtësisë që ofrojnë asistencë juridike falas dhe OSHC-të që ofrojnë asistencë juridike falas ndryshuan regjimin e punës. Më parë punonin me ndërrime, mirëpo qytetarët nuk ishin të informuar nëse stafi i Ministrisë i autorizuar për dhënie të asistencës juridike falas është në punë në ditën e caktuar; ndërsa OSHC-të filluan të pranonin kërkesat për asistencë juridike falas onlajn. Kështu, Qeveria reduktoi financimin e OSHC-ve në përgjithësi, ndërsa buxheti i Ministrisë së drejtësisë për OSHC-të u shkurtua konsiderueshëm, sidomos me rebalancimin e 9 prillit, i cili mund të prekë dhënien e asistencës juridike falas në periudhën gjatë dhe pas Covid-19. Megjithatë, nuk mund t'i determinonim efektet më atë datë.

Grafiku 7
Rebalancimi i
Buxhetit, 9 prill,
transferimet
për OJQ-të
Burimi: Prezantimi i
të dhënave nga vetë Ministria
e financave, prill 2020



66 <https://cutt.ly/ti4A6D2>

1.3. ANALIZA E MASAVE NGA PERSPEKTIVA GJINORE DHE E DIVERSITETIT:

Vlerësimi juridik i dekreteve me fuqi ligji nga Akademia e shkencave dhe arteve përcakton se në përgjithësi, ato janë të nevojshme dhe proporcionale për trajtimin e epidemisë, mirëpo jo domosdo janë në pajtim me parimin e sundimit të ligjit, si rezultat i mungesës së kuadrit të qëndrueshëm kushtetues dhe ligjor për menaxhimin e një gjendjeje të jashtëzakonshme. Ndërkaq, transparencja e zhvillimit të politikave, procesi i hartimit të akteve normative, si dhe numri i tyre kanë marrë kritika, së bashku me ndryshimin e shpeshtë të akteve dhe zbatimin e tyre⁶⁷. Veç kësaj, procesi i zhvillimit të politikave gjatë krizës kishte mungesë të qasjes ndërsektoriale për planifikimin, zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe përfundimin e masave, që krijojnë "mundësi për një efekt joproporcionalisht negativ mbi ata që janë në gjendjen më të pafavorshme në shoqëri"⁶⁸. Një shembull i dalluar është masa e lëvizjes së kufizuar, e cila ishte diskriminuese për dy grupmosha dhe kishte efekte negative tek njerëzit me aftësi të kufizuara dhe sëmundje kronike. Gjykata kushtetuese, në vendimin e vet për të anuluar dispozitën diskriminuese, sqaroi se me këtë vendim, Qeveria kishte pasur qasje selektive dhe të ndryshme në kufizimin e së drejtës së lëvizjes me bazë moshën, dhe pikërisht për të njëjtat arsye – ekzistimin e sëmundjes ngjithëse.⁶⁹ Ajo që është interesant është se Gjykata bazoi vendimin e vet në Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, ligj ky të cilin Gjykata e anuloi (në baza procedurale) më vonë të njëjtën ditë⁷⁰, duke i lënë qytetarët pa një kuadër ligjor për mbrojtje nga diskriminimi.

Të gjitha llojet e masave që u hartuan prej fillimit të pandemisë deri në fund të muajit Korrik 2020 për të adresuar Kovid-SARS-19 (në lidhje me shëndetësinë, çështjet sociale dhe ekonomike, shënjestrimin e grupeve vulnerabël, etj.) ishin lëndë e analizës. Fillimisht, të gjitha masat u rishikuan dhe analizuan kundrejt boshllëqeve gjinore dhe prioriteteve të agjendës gjinore. Në bazë të analizës, pjesa në vijim i vlerëson ato si negative për çështjet gjinore, neutrale për çështjet gjinore, të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore, pozitive për çështjet gjinore, apo transformuese për çështjet gjinore. Prezantimi i analizës së masave nga aspekti gjinor është një semafor (shihni më poshtë). Semafori paraqet një shembull të dobishëm për vlerësimin e politikave të menaxhimit të krizës nga perspektiva gjinore. Ai vlerëson politikat në pesë nivele.

67 ASHAMV (2020) Aspektet juridike të gjendjes së jashtëzakonshme/Правни аспекти на вонредната состојба nga akad. Vlado Kambovski, prof. dr. Ana Pavlovska-Daneva, prof. dr. Gordana Llazhetiç, dr. Elena Mujoska-Tërpevska, mr. Konstantin Bitrakov

68 EPI (2020) On shaky grounds: human rights and Kovid-19 after the derogation from the European Convention for Human Rights, e disponueshme në: <https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/ENG-ECHR-MK-KOVID19.pdf>

69 Vendimi i Gjykatës kushtetuese U.br. 60/2020 i disponueshëm në: <http://ustavensud.mk/?p=19320> me të cilin, një pjesë e vendimit të Qeverisë Nr.44-2416/1 (i ndryshuar nëntë herë) mbi kufizimin e lëvizjes që lidhet me personat më të moshuar se 67 vjeç dhe më të rinj se 18 vjeç, u pezullua, sepse është diskriminues në bazë të moshës

70 Vendimi i Gjykatës kushtetuese U.br. 115/2019-1, i disponueshëm në: <http://ustavensud.mk/?p=19246>

Grafiku 8
Semafori - Shkalla e kontributit për barazinë gjinore

Miratuar nga Shkalla e OBSH për Vlerësim të përgjegjshëm gjinor: kriteret për vlerësimin e programeve dhe politikave nga Sanja Nikolin dhe Aleksandra Vlladisavleviç, 201

	SHKALLA ↓	SQARIMET ↓
Ndërhyrjet që janë negative për çështjet gjinore 	Në pabarazitë që kanë si bazë gjinitë investohet, ato forcohen apo mirëmbahen përmes arritjes së objektivave të programit/projektit/masës (Shembuj: Ndërprerja e transportit publik ka efekt negativ për gratë që kanë nevojë të punojnë jashtë vendbanimit gjatë pandemisë)	
Ndërhyrjet që janë neutrale për çështjet gjinore 	Në planifikimin e ndërhyrjes, çështjet gjinore nuk merren parasysh, dhe konsiderohen si jorelevante për arritjen e objektivave. (Për shembull: raportimi për numrin e personave që janë prekur me Kovid-19, që është vërtetuar me test, numrin e personave në ventilatorë, vdekjeprurësinë, fatalitetet, numrin e shkeljeve të ndalimit të lëvizjes dhe për informacionet e tjera, pa klasifikim sipas gjinive (gjegjësisht, pa klasifikuar informacionet sipas gjinisë, moshës, komunës, dhe variabëlve të tjera relevante).	
Ndërhyrjet që janë ndjeshme ndaj çështjeve gjinore 	Gjinia konsiderohet të jetë një variabël e rëndësishme në arritjen e objektivit dhe të dhënave të ndërhyrjes, të paktën pjesërisht, që duhet të vihen në dispozicion të klasifikuara sipas gjinisë. (Për shembull: mbështetja e rezistueshmërisë ekonomike të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla)	
Ndërhyrjet që janë pozitive për çështjet gjinore 	Gjinia konsiderohet të jetë kyçe në arritjen e objektivave të ndërhyrjeve, ndërsa analiza e gjinive formon njërën nga parametrat kryesor në planifikimin dhe vendimmarrjen. (Për shembull: masat për të adresuar dhunën në bazë të gjinisë në kushte të Kovid-19, të hartuara në konsultim me grupet e grave.)	
Ndërhyrjet transformuese për çështjet gjinore 	Ndërhyrjet trajtojnë rrënjët e arsyeve për boshllëkun në çështjet gjinore. Transformimi është sistematik dhe i qëndrueshëm. (Për shembull: shpërndarja e resurseve përgjegjëse ndaj gjinive gjatë dhe pas përgjigjes ndaj Kovid-19, politika fiskale përgjegjëse ndaj gjinive, nismat dhe politikat për rritjen e shpërndarjes së drejtë të punës së papaguar.	

Duke ndjekur shembullin e shumë vendeve të botës, në kohë kur aktivitetet ekonomike u ngadalësuan për të frenuar shpërhapjen e virusit, Qeveria miratoi një sërë masash për të zbutur efektin e krizës ekonomike dhe shëndetësore që buron nga Kovid-19. Megjithatë, siç treguan shumë studime, kriza nuk prek njëjtë burrat dhe gratë. Andaj, kur hartohen masa dhe politika publike, politikëbërësit duhet të miratojnë perspektivën gjinore për t'i futur në llogari nevojat dhe prioritetet e ndryshme si të burrave, ashtu dhe të grave. Veç kësaj, qasja gjinore në krijimin e politikës duhet të shoqërohet me

Analiza e masave të miratuara nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut në lidhje me efektet zbutëse për Kovid-19 dëshmon se perspektiva gjinore është marrë parasysh vetëm në mënyrë sporadike, nëse jo në raste të jashtëzakonshme.

shumë metoda pjesëmarrëse, të cilat do të sigurojnë më tepër gra dhe përfaqësues të grupeve vulnerabël në procesin e krijimit të politikave.

Analiza e masave të miratuara nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut lidhur me efektet zbutëse për Kovid-19 dëshmon se perspektiva gjinore është marrë parasysh vetëm në mënyrë sporadike, nëse jo në raste të jashtëzakonshme. Përderisa të gjitha masat kanë një dimension gjinor dhe paevitueshëm implikim të ndryshëm ndaj grave dhe burrave, vlerësimi më poshtë tregon se perspektiva gjinore është më e dukshme se tek të tjerat. Kështu, nga 46 masa të analizuar për krizën Kovid-19 (ju lutemi shihni Shtojcën 3), që mund të kenë dimensionin gjinor, vetëm katërmbëdhjetë nga ato mund të konsiderohen si pozitive për çështjet gjinore, dhe dy transformuese për çështjet gjinore, që paraqesin vetëm 35% të masave. Kjo do të thotë se shumica e masave janë neutrale për çështjet gjinore. Sipas EIGE, legjislacioni neutral për çështjet gjinore është *"legjislacioni që është hartuar në kuptimin universal, duke injoruar gjendjet specifike për nga gjinia dhe raportet e fuqive midis grave dhe burrave që inkurajojnë diskriminimin me bazë seksin dhe diskriminimin me bazë gjininë, duke përfshirë dhe dhunën me bazë gjininë ndaj grave"*⁷¹. Kështu, është e domosdoshme të shqyrtohen me kujdes ligjet neutrale për çështjet gjinore, të cilat trajtojnë gratë dhe burrat për ta vlerësuar nëse ata do të frenojnë apo do të përshpejtojnë barazinë gjinore dhe do të eliminojnë diskriminimin me bazë seksin dhe gjininë.

Mbrojtja shëndetësore, të drejtat seksuale dhe riprodhuese dhe kujdesi



Me këtë kategori, Qeveria ka miratuar dy masa. E para, nga dy masat, i referohet prokurimit emergjent të 200 makinave respiratore, e cila synon fuqizimin e kapacitetit dhe gatishmërisë së shëndetësisë publike për t'u ofruar shërbime më shumë pacientëve, në rast të nevojës për ventilim mekanik në rastet e rënda. Nuk ekziston një provë se ventilatorët aktualë u shërbejnë grave dhe burrave nga grupet e ndryshme në përmasa të barabarta, dhe, edhe përkundër asaj se është ky synimi i politikës, gjatë vlerësimit duket të përcaktohet nëse të gjithë qytetarët, gra dhe burra, dhe gra dhe burra nga grupet pakicë, me aftësi të kufizuara, të moshuarit, etj., kanë pasur akses të barabartë në ventilatorët e prokuruar me këtë masë.

Masa e dytë në këtë kategori i referohet rritjes nga 20% të pagave të stafit mjekësor, përfshirë dhe në luftën ndaj Kovid-19 për dy muaj. Nga perspektiva gjinore, kjo masë paraqet një ndërhyrje pozitive për çështjet gjinore, nëse marrim parasysh të dhënat se në vitin 2019, në shëndetësinë publike, madje 72.33% të punonjësve janë gra, duke llogaritur si gratë mjekë, infermiere, farmacistë dhe hulumtuuese laboratorit. Përqindja e infermiereve gra të punësuar në sektorin e shëndetit publik ka madje përqindjen më të lartë në numrin e përgjithshëm të stafit infermier. Kështu, masa targeton vetëm mjekët, e jo dhe stafin infermier dhe kjo në përgjithësi u përgjigjet të gjithëve, ndërsa stafi mjekësor më i prekur me Kovid-19 ishte në Qendrat e Kovid-19: Klinika e sëmundjeve ngjitëse, Spitali i qytetit 8 shtatori, Klinika e fëmijëve në Shkup dhe departamentet e sëmundjeve ngjitëse në çdo spital të përgjithshëm në vend. Masa vlerësohet të jetë

⁷¹ Për më tepër terme të politikës gjinore, vizitoni: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1192>

një ndërhyrje pozitive për çështjet gjinore, sepse i referohet një grupi qëllimor të profesionistëve shëndetësorë, mirëpo limitimi tek mjekët është problematik, sepse infermieret marrin barrën më të madhe të përkujdesjes ndaj pacientëve me Kovid-19, dhe është kjo pjesa e sektorit shëndetësor ku shumica e punonjësve janë gra. Masa është me kohëzgjatje të limituar prej dy muajsh. Ndërkaq, masa është pozitive për çështjet gjinore, ndërsa nuk është transformuese. Një masë përgjegjëse dhe transformuese ndaj Kovid-19 do të përfshinte një mbështetje të ekuilibrit punë-shtëpi të profesionistëve mjekësorë gjatë Kovid-19, dhe do të kishte adresuar stresin dhe frikën e infermiereve dhe mjekëve se i vejnë familjet e veta në rrezik nga nënshtrimi ndaj virusit me punën që bëjnë. Për shembull, të sigurohet një masë me të cilën do të organizohet stafi mjekësor të punojë me ndërrime dy javëshe, ku, gjatë ndërrimit të punës, shteti do të ofronte akomodim, në mënyrë që stafi të mos vejë familjen e vet në rrezik; testimi në fillim dhe në fund të ndërrimit; dhe dy javë pushim nga puna pasi do të përfundojë ndërrimi, për t'u dhënë atyre kohë për familjen, të çliruar nga frika se po i vejnë familjet e tyre në rrezik.

Duke marrë parasysh të dy masat në këtë kategori, analiza tregoi se njëra është pozitive për çështjet gjinore, dhe tjetra neutrale për çështjet gjinore.

	Mbrojtja shëndetësore, të drejtat seksuale dhe riprodhuese dhe kujdesi
	1) prokurim emergjent i 200 makinave respiratorë
	2) 20% rritje të pagave të stafit mjekësor të përfshirë në luftën ndaj Kovid-19 për dy muaj

Rimëkëmbja ekonomike dhe jetesa

Shumica e masave të miratuara nga Qeveria për të zbutur ndikimin nga kriza e koronavirusit bien në këtë kategori, e cila përfshin masat në lidhje me rimëkëmbjen ekonomike dhe jetesën e qytetarëve. Kjo gjë është e kuptueshme, pasi vlerësohet se pasojat ekonomike të Koronavirusit mbi ekonominë botërore në përgjithësi, përfshirë dhe ekonominë maqedonase, do të kenë ndikim të gjerë dhe do të jenë të thella.

Masat e miratuara brenda kësaj kategorie do të ndahen më tej në disa nënkategorie.





► Shtyrjet dhe reduktimet e tatimeve

Si pjesë e kësaj nënkategorie, u miratuan katër masa për të zbutur ndikimin e Koronavirusit mbi ekonominë dhe jetën e qytetarëve. Ato janë: 1) pezullimi i pagimit paraprak të tatimit mbi fitimin për muajt mars, prill dhe maj; 2) pezullimi i pagimit paraprak të tatimit mbi të ardhurat personale për muajt mars, prill dhe maj, për tatimpaguesit që fitojnë nga puna e pavarur në aktivitete të caktuara; 3) heqja e taksave doganore për pajisje mjekësore; 4) sigurimi i borxheve doganore për të mbështetur eksportin me garanci shtetërore në vlerë të përgjithshme nga 3 milionë euro.

Të gjitha masat janë vlerësuar si neutrale për çështjet gjinore, sepse ato vlejnë për të gjithë qytetarët njëloj dhe nuk marrin parasysh nevojat e ndryshme që burojnë nga

Të gjitha masat janë vlerësuar si neutrale për çështjet gjinore, sepse ato vlejné për të gjithë qytetarët njëlló dhe nuk marrin parasysh nevojat e ndryshme që burojnë nga rolet gjinore, stereotipat apo nga modeli patriarkal i familjes, që përcakton raportet gjinore midis grave dhe burrave.

rolet gjinore, stereotipat apo nga modeli patriarkal i familjes, që përcakton raportet gjinore midis grave dhe burrave. Megjithatë, ndikimi i këtyre masave nuk do të jetë neutral për çështjet gjinore, në varësi nga përqindja e grave dhe burrave që punojné në kompani taksapaguese (tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin). Masa për pezullimin e pagimit paraprak të tatimit mbi të ardhurat personale për ata që punojné në mënyrë të pavarur prekin gratë përkthyes, mirëpo dhe burrat nga sektori TI që punojné në platforma interneti, sepse numri i këtyre personave është goxha i lartë, pra 3.41 në 1000 qytetarë⁷². Andaj, kjo masë vlerësohet të jetë pozitive për çështjet gjinore. Megjithatë, pa ndryshimin e kuadrit ligjor të marrëdhënieve të punës, për të ofruar pagë neto të sigurt për këto forma të reja të punës, masa nuk mund të bëhet transformuese për çështjet gjinore. Sigurimi i mbrojtjes sociale dhe shëndetësore i shoqëruara me këtë lloj të punës (në kompjuter dhe me zona të ndryshme kohore, në internet dhe në mënyrë virtuale), baraspesha mes punës dhe jetës private si dhe e drejta që "të çkyqesh" është baza e për të bërë këtë masë transformuese gjinore.

	Shtyrjet dhe reduktimet e tatimeve
	1) pezullimi i pagimeve paraprake të tatimit mbi fitimin për muajt mars, prill dhe maj;
	2) pezullimi i pagimit paraprak të tatimit mbi të ardhurat personale për mars, prill dhe maj, për tatimpaguesit që fitojné nga puna e pavarur në aktivitete të caktuara;
	3) heqja e taksave doganore për pajisjet mjekësore;
	4) sigurimi i borxhit doganor për të mbështetur eksportin me garanci shtetërore në vlerë të përgjithshme nga 3 milionë euro.

► Mbështetja financiare për kompanitë dhe mbrojtja e likuiditetit








Gjithsej 11 masa u miratuan nga Qeveria për nënkategorinë e mëposhtme: 1) subvencionimi i 50% të kostove të kontributit për muajt prill, maj dhe qershor (maksimum deri në 50% të pagës mesatare për janarin e vitit 2020); 2) subvencionimi me 14.500 denarë për punonjës për muajt prill dhe maj për të gjitha kompanitë; 3) dhënia e huave në shumë prej 13,7 milionë pa interes përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga sektorët më të prekur, dhe 4) dhënia e huave nga 50 milionë euro me shkallë të ulët interesi nga diku 1.5% përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut dhe Bankës evropiane të investimeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përmes bankave komerciale; 5) agjencitë e udhëtimeve detyrohen të lëshojné vauçerë për aranzhimet e anuluar me kohëzgjatje deri më 31.12.2021; 6) hua pa interes për ndërmarrjet mikro dhe të vogla përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut, me vlerë nga 31 milionë euro, përfshirë dhe 30% të mjeteve financiare të pakthyeshme për ato kompani që drejtohen apo që janë themeluar nga gra, apo që punësojnë njerëz të ri, që janë të orientuara

⁷² https://analyticshelp.io/blog/global-internet-freelance-market-overview-2018/?fbclid=IwAR20CdFA0ZaFUS2RGLSNrHRaMrCNLe7xWsh_QglNIngZREphhhE4CINaCg




Nëntë nga njëmbëdhjetë masat e përmendura më lartë janë vlerësuar si neutrale për çështjet gjinore.

drejt eksportit, apo inkuadrojnë inovacion dhe dixhitalizim në punën e tyre; 7) marrja përsipër e rrezikut kreditor për kompanitë fillestare (start-up) dhe ndërmarrjet e vogla dhe mikro, përmes bankave komerciale, në shumë nga 10 milionë euro të kapitalit fillestar për akses më të lehtë në burimet financiare; 8) mbështetja financiare në shumë nga 25 milionë euro, për të fuqizuar konkurrueshmërinë e kompanive për të pushtuar tregje të reja dhe për të modernizuar proceset; 9) platforma dixhitale për tregjet e reja për kompanitë e tekstit, me mbështetje financiare nga 1 milionë euro; 10) mbështetja e zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të brendshme *start-up* përmes FIZHT në lartësi nga 1,6 milionë euro; 11) bashkë-financimi i evenimenteve dhe konferencave me 50% mbështetje financiare nga shteti deri në maksimumin nga 30.000 denarë.

Nëntë nga njëmbëdhjetë masat e përmendura më lartë janë vlerësuar si neutrale për çështjet gjinore. Vetëm njëra masë mund të konsiderohet si masë pozitive për çështjet gjinore (masa me numër 9), sepse ajo drejtpërsëdrejti synon asistimin e kompanive të tekstit për të eksportuar produktet e tyre dhe kështu, të vazhdojnë së punuari. Kompanitë e tekstit punësojnë kryesisht gra, andaj kjo masë konsiderueshëm iu përgjigjet nevojave të tyre. Andaj, masa me numër 6 për huatë për kompanitë e themeluara nga gra apo që punësojnë njerëz të rinj dhe fusin inovacion dhe dixhitalizim në punën e tyre, konsiderohet të jetë transformuese për çështjet gjinore, pasi konsideron normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore për gratë dhe burrat dhe se këto prekin aksesin dhe kontrollin e burimeve.

	Mbështetja financiare për kompanitë dhe mbrojtja e likuiditetit
	1) subvencionimi i 50% të kostove të kontributeve për prill, maj dhe qershor (maksimum deri 50% të pagës mesatare për janar 2020);
	2) subvencionimi me 14.500 denarë për punonjës për muajt prill dhe maj për të gjitha kompanitë;
	3) dhënia e huave në shumë nga 13,7 milionë pa interes përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga sektorët më të prekur;
	4) dhënia e 50 milionë eurove me shkallë të ulët interesi nga rreth 1.5% përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut dhe Bankës evropiane të investimeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përmes bankave komerciale;
	5) agjencitë e udhëtimeve detyrohen të lëshojnë vauçerë për aranzhimet me kohëzgjatje deri më 31.12.2021;
	6) hua pa interes për ndërmarrjet mikro dhe të vogla përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut, me vlerë nga 31 milionë euro, përfshirë dhe 30% të mjeteve financiare të pakthyeshme për ato kompani që drejtohen nga gra apo që punësojnë të rinj, janë të orientuara drejt eksportit, apo që fusin në përdorim inovacion dhe dixhitalizim në punën e tyre;
	7) marrja përsipër e një pjese të rrezikut të kredisë për ndërmarrjet start-up dhe kompanitë e vogla dhe mikro përmes bankave komerciale në shumë nga 10 milionë euro të kapitalit fillestar për akses të lehtësuar në burimet financiare;
	8) mbështetja financiare në shumë nga 25 milionë euro për të fuqizuar konkurrueshmërinë e kompanive për të pushtuar tregje të reja dhe për të modernizuar proceset;








	9) platforma dixhitale për tregjet e reja për kompanitë e tekstit, me mbështetje financiare nga 1 milionë euro;
	10) mbështetja e zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të brendshme start-up përmes FIZHT në shumë nga 1,6 milionë euro;
	11) bashkëfinancimi i evenimenteve dhe konferencave me 50% të mbështetjes financiare nga shteti deri në maksimumin e 30.000 denarëve.

► Mbështetja e standardeve të jetës

Për të mbrojtur standardet e jetës së qytetarëve, Qeveria ka miratuar një spektër me 5 masa: 1) ngrirja e çmimeve të produkteve elementare; 2) bërja e mundur për bankat, kompanitë financiare dhe kompanitë huadhënëse të ristrukturojnë kreditë; 3) reduktimi i shkallës së interesit, ndalesa e detyrimit dhe falimentimit; 4) mbështetja financiare për atletët në shumë nga 14.500 denarë në prill dhe maj; 5) Përfitimet me para në dorë për personat që kanë humbur punën e vet nga 11 marsi deri më 30 prill 2020.

Vetëm njëra nga këto masa, pra ajo që ka të bëjë me ngrirjen e çmimeve të produkteve elementare, mund të konsiderohet si e ndjeshme për çështjet gjinore, pasi drejtpërsëdrejti prek reduktimin e rrezikut social tek gratë vulnerabël dhe kategoritë e tjera të qytetarëve që janë në rrezikun e mbijetesës në mënyra të ndryshme. Masat e tjera u takojnë në përgjithësi të gjithë qytetarëve dhe më sa duket, nuk kanë dimension gjinor në planifikimin, por implementimi i masës me numër 6 ka prekur më tepër gra se burra, pasi rezultatet e monitorimit të QHKP tregojnë se më tepër gra kanë humbur punën e tyre gjatë gjendjes së jashtëzakonshme (shihni Kreun 2.3); ndërsa masa me numër 4 vlerësohet të prekë më tepër burra se gra, pasi numri i burrave atletë që kanë përfituar nga masa është shumë më i lart se numri i grave atlete (82.69% burra dhe 17.31% gra)⁷³.

Mbrojtja e standardeve të jetës	
	1) ngrirja e çmimeve të produkteve elementare;
	2) bërja e mundur për bankat, kompanitë dhe kompanitë huadhënëse të ristrukturojnë kreditë;
	3) reduktimi i shkallës së interesit, ndalesa e detyrimit dhe falimentimit;
	4) mbështetja financiare për atletët në shumë nga 14.500 denarë në prill dhe maj;
	5) përfitimet me para në dorë për të gjithë personat që kanë humbur punën e vet nga 11 marsi deri më 30 prill 2020.




⁷³ <https://cutt.ly/xsDmNYr>

► Likuiditeti i buxhetit shtetëror

Dy nga tre masat mund të kenë implikime gjinore: 1) kryetarët dhe anëtarët e bordeve të drejtorëve dhe të bordeve mbikëqyrëse nuk do të marrin kompensime; 2) huamarrja e 580 milionë eurove nga kreditorë të huaj. Masa e parë do të kishte prekur marrësit burra të pozitive të caktuara, pasi burrat dominojnë në pozitat udhëheqëse në bordet; ndërsa masa e tretë mund po ashtu të përcaktojë implikimet fiskale gjinore nëse ofrohen të dhëna për atë se për çka do të përdoret huaja. Në këtë kuptim, nevojitet një vlerësim më i detajuar i implikimit fiskal gjinor. Ndërkaq, Gjykata kushtetuese ka anuluar vendimin për masën e parë, e cila ka minimizuar përgjigjen ndaj Kovid-19 dhe ka pasur efekt negativ për burrat. Duke marrë në konsideratë masën 2) hapja e fondit të solidaritetit Kovid-19 për pranimin e donacioneve, që është vlerësuar si masë e cila është e verbër për gjinitë, mirëpo përgjigja e saj gjinore mund të përmirësohet nëse burimet e fondit të solidaritetit Kovid-19 drejtohen në mënyrë transparente drejt grave dhe burrave në nevojë.

Ndërhyrjet efektive në masë të madhe varen nga disponueshmëria e mjeteve financiare. Burimet adekuate, të mëkohshme dhe të parashikueshme duhet të vihen në dispozicion, në mënyrë që angazhimi për gatishmëri dhe përgjigje pjesëmarrëse të ketë efekt. Vendet duhet të përmbahen nga shkaktimi i dëmit duke promovuar praktika që janë në kundërshtim me KDPAK. Në vend të kësaj, ato duhet të mendojnë rreth përdorimit të qasjes që ka si bazë të drejtat e njeriut dhe ciklin e menaxhimit në gjendje të jashtëzakonshme, që në rastin tonë nuk u bë.







**Ndërhyrjet efektive
në masë të
madhe varen nga
disponueshmëria e
mjeteve financiare**

Likuiditeti i buxhetit shtetëror	
	1) kryetarët dhe anëtarët e bordeve të drejtorëve dhe bordeve mbikëqyrëse nuk do të marrin kompensim;
	2) hapja e fondit të solidaritetit të Kovid-19 për pranimin e donacioneve;
	3) huamarrja nga kreditorë të huaj, me 580 milionë euro të planifikuar, ka dimensionin gjinor.

► Inkurajimi i konsumit dhe ringjalljes së ekonomisë

Në këtë nënkategori, Qeveria ka miratuar gjashtë masa: 1) kartelë pagimi në shumë nga 9.000 denarë për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase për të papunësuarit, qytetarët me të ardhura të ulëta dhe për pranuesit e ndihmës minimale të garantuar; 2) vauçerë për turizëm të brendshëm në shumë nga 6.000 denarë dhe kartelë të brendshme pagimi në shumë nga 3.000 denarë për qytetarët me neto pagë më të ulët se 15.000 denarë; 3) kartelë pagimi për të rinj, në shumë nga 3.000 denarë për produktet dhe shërbimet e brendshme; 4) vauçer nga 30.000 denarë për bashkëfinancimin e trajnimeve dhe kurseve për TI dhe shkathtësitë dixhitale për të rinjtë; 5) mbështetje financiare për të rinjtë në shumë deri 6.000 denarë për të mbuluar shpenzimet e shkollimit në Universitet apo në sistemim në konvikte; 6) fundjava pa TVSH për të gjithë qytetarët në sektorë të caktuar të shitjeve. Të gjitha masat synojnë gratë dhe burrat që janë të papunësuar, që kanë të ardhura të ulëta apo që janë të rinj, me qëllim asistimi i grupeve më vulnerabël. Duke marrë parasysh se nëngrupet

e grave të papunësuarra dhe me të ardhura më të ulëta marrin pjesë më të madhe se burrat, masat 1 dhe 2 iu përgjigjen nevojave të grave. Megjithatë, në këtë kategori, dimensionin gjinor dhe i aftësive të kufizuara nuk është marrë parasysh gjatë hartimit të masave, edhe pse, më sa duket, pothuajse të gjitha masat janë zhvilluar për t'i ndihmuar njerëzve nga kategoritë vulnerabël. Duke ditur se boshllëku i pagimeve gjinore lëviz rreth 18-19%, përfituesit potencial të tre masave të para mund të jenë gra. Prapëseprapë, politikëbërësit, me siguri për të zgjatur shtrirjen e masës për të gjithë qytetarët, nuk përkufizojnë masën si specifike për kategoritë vulnerabël të qytetarëve, për gratë dhe për çdo kategori tjetër specifike të qytetarëve, gjë kjo e cila do ta kishte bërë masën më gjithëpërfshirëse dhe më të drejtë.








	Inkurajimi i konsumit dhe ringjalljes së ekonomisë
	1) kartelë pagimi në shumë nga 9.000 denarë për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase për të papunësuarit, qytetarët me të ardhura të ulëta dhe pranuesit e ndihmës minimale të garantuar;
	2) vauçerë për turizmin e brendshëm në shumë nga 6.000 denarësh dhe kartelë e brendshme pagimi në shumë nga 3.000 denarësh për qytetarët me pagë neto më të ulët se 15.000 denarë;
	3) kartelë pagimi për të rinjtë, në shumë nga 3.000 denarësh për produkte dhe shërbime të brendshme;
	4) vauçerë nga 30.000 denarësh për bashkëfinancimin e trajnimeve dhe kurseve për TI dhe shkathtësitë dixhitale për të rinj;
	5) mbështetje financiare për të rinj deri 6.000 denarë për të mbuluar shpenzimet e shkollimit në Universitet apo për sistemim në konvikte;
	6) Fundjava pa TVSH për të gjithë qytetarët në sektorë të caktuar të shitjeve.

► Mbështetja e bujqësisë

Përgjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria miratoi 7 masa për të mbështetur bujqësinë, duke synuar zbutjen e efekteve të krizës Covid-19. Këto masa janë: 1) mbështetja financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kryejnë prodhimtari primare, përpunimet dhe eksporti i produkteve bujqësore primare dhe të përpunuara; 2) kartela e pagimit për subvencionimin e 50% të naftës së gjelbër për 50.000 bujq, në vlerë nga 4.6 milionë euro; 3) stimulimi i përpunuesve të rrushit për prodhimin e produkteve të reja, siç janë distilatet alkoolike për prodhimin e dezinfektuesve me vlerë nga 3,5 milionë euro për tre vjet; 4) partneritetet publiko-private në sektorët e vitikulturës dhe duhanit; 5) aplikimi i qiradhënies afatgjate të kullotave dhe rritja e tokave bujqësore për konkurrencë më të madhe të bujqësisë maqedonase; 6) futja e një Programi për financimin e kompanive mikro-bujqësore në shumë nga 3 milionë euro; masat për modernizimin e bujqësisë përmes një kredie të Bankës botërore nga 50 milionë eurosh.

Nga të gjitha masat e përmendura më lart, vetëm njëra masë ka dimension gjinor – masa 4, për faktin se gratë prodhuese marrin pjesë me një përqindje të konsiderueshme në krahun e punës në rritjen e duhanit dhe në vitikulturë, për proceset e prodhimit dhe

përpunimit (30% janë gra). Megjithatë, nevojitet mbledhja e më shumë të dhënave nga partneritetet e firmosura për të bërë një analizë më të hollësishme të aspektit gjinor në implementimin e kësaj mase. Në të gjitha masat e tjera, duhet vëzhguar neutralitetin gjinor, që jo domosdo nënkupton se ndikimi mbi gratë dhe burrat nga implementimi i kësaj mase nuk do jetë ndryshe dhe nuk do të shkaktojë pabarazi gjinore. Andaj, duhet kryer vlerësimin e ndikimit fiskal nga perspektiva gjinore të këtyre masave, për të përcaktuar se kush ka aksesuar burimet dhe nëse gratë dhe burrat përfitojnë barazisht nga masat e parashikuara.

	Mbështetja e bujqësisë
	1) mbështetja financiare e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kryejnë prodhimtarinë primare, përpunimet dhe eksporti i produkteve bujqësore primare dhe të përpunuara;
	2) kartela e pagimit për subvencionimin e 50% të naftës së gjelbër për 50.000 bujq, me vlerë nga 4,6 milionë eurosh;
	3) Stimulimi i përpunuesve të rrushit për prodhimin e produkteve të reja, siç janë distilatet alkoolike për prodhimin e dezinfektuesve, me vlerë nga 3,5 milionë euro për tre vjet;
	4) Partneritetet publiko-private në sektorët e vitikulturës dhe duhanit;
	5) Aplikimi i qiradhënies afatgjate të kullotave dhe rritja e tokave bujqësore për konkurrueshmëri më të lartë të bujqësisë maqedonase;
	6) Futja e një Programi për financimin e kompanive mikro-bujqësore, në shumë nga 3 milionë eurosh;
	7) Masat për modernizimin e bujqësisë përmes një kredie të Bankës botërore nga 50 milionë eurosh.





Mbrojtja sociale dhe tregu i punës

Në kuadrin e kësaj kategorie, Qeveria miratoi katër masa: 1) lehtësimi i hyrjes së shpejtë në sistemin e punonjësve joformalë dhe të tjerëve për marrjen e ndihmës minimale të garantuar, me bazë shumën e përgjithshme të të gjitha të ardhurave të të gjithë anëtarëve të amvisërisë, llogaritur nga muaji i fundit, në vend se të tre muajve paraprakë; 2) asistenca për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit në 27 komuna, që më lehtë t'i bëjnë ballë krizës, duke inkuadruar 200 të papunë si dhënës të shërbimeve; 3) kompensime monetare me shumë nga 50% të pagës mesatare mujore neto të punonjësit për 24 muajt e fundit. Një person i papunë, i cili ka qenë i punësuar për të paktën 9 muaj vazhdimisht, apo 12 muaj pa ndërprerje në 18 muajt e fundit, përpara përfundimit të punësimit, gëzon të drejtën e kompensimit monetar; 4) pushimi i lindjes shtyhet deri në përfundimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga shpërhapja dhe parandalim të Kovid-19.

Analiza e perspektivave gjinore në këtë kategori tregon se të gjitha katër masat janë të ndjeshme për gjinitë, sepse marrin parasysh nevojat e ndryshme të burrave dhe grave, si dhe përfshirjen e grave në zbatim. Kështu, me masën numër dy u demonstrua më së miri aty ku pritej, për shkak të rolit gjinor që gratë po luajnë në shoqërinë tonë,

Analiza e perspektivave gjinore në këtë kategori tregon se të gjitha katër masat janë të ndjeshme për gjinitë, sepse marrin parasysh nevojat e ndryshme të burrave dhe grave, si dhe përfshirjen e grave në zbatim

gratë të rekrutohen si dhënëse të shërbimeve. Nga ana tjetër, kjo që u tha më herët është reflektuar në masat 3 dhe 4, përmes dispozitave të posaçme, ku synohen gratë shtatzëna, dhe ku rregullohet pushimi i lindjes gjatë pandemisë së Kovid-19. Ajo që mund të përmirësohet në kuptimin e dimensionit gjinor është masat e tilla të mos limitohen vetëm për gjendje të jashtëzakonshme dhe rrethana të posaçme, por të merret parasysh perspektiva gjinore në rregullimin e këtyre fushave edhe në rrethana normale. Duhet shënuar se këto masa nuk kanë përfshirë dimensionin e aftësive të kufizuara, që përjashtoi nga grupi i përfituesve gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Së fundi, duke marrë në konsideratë se shumë gra në sektorin joformal që punojnë si pastruese dhe punonjëse shtëpie kanë mbetur pa punë në tregun e punës masa e parë po ashtu ka për qëllim të adresojë nevojat dhe interesat e tyre të mbijetesës, megjithatë, intervistat e zhvilluara gjatë studimit shënuan probleme me përmbushjen e kushteve dhe ushtrimin e të drejtave nën këtë masë, sidomos kur bie fjala për gratë rome.

	Mbrojtja sociale dhe tregu i punës
	1) lehtësimi i hyrjes së shpejtë në sistemin e punonjësve joformalë dhe të tjerëve për të marrë ndihmën minimale të garantuar, me bazë shumën e përgjithshme të të gjitha të të ardhurave të të gjithë anëtarëve të amvisërisë, llogaritur nga muaji i fundit, në vend se nga tre muajt paraprakë;
	2) ndihma për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit në 27 komuna, që më lehtë t'i bëjnë ballë krizës, duke inkuadruar 200 persona të papunë si dhënës të shërbimeve;
	3) kompensime monetare me shumë nga 50% të pagës mesatare mujore neto të punonjësit për 24 muajt e fundit. Një person i papunë, i cili ka qenë i punësuar për të paktën 9 muaj pa ndërprerje, apo 12 muaj pa ndërprerje në 18 muajt e fundit, përpara përfundimit të punësimit, gëzon të drejtën e kompensimit monetar;
	4) pushimi i lindjes shtyhet deri në përfundimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga shpërhapja dhe parandalim të Kovid-19.



Masat e synuara për grupet vulnerabël; solidariteti social dhe kohezioni social

Kjo kategori konsiston në dy masa: 1) shtyrja e pagimit të qirasë për përfituesit e banimit social; Futja e një pagese të parave të gatshme prej 1000 denarëve për shpenzimet e energjisë elektrike në amvisëri për muajt prill dhe maj 2020, dhe 2) Aksesit i lehtësuar në të drejtën e shtesave për fëmijë dhe afatet e zgjatura për paraqitjen e kërkesave për ndihmë financiare të njëhershme për një të porsalindur, për realizimin dhe zgjatjen e së drejtës së shtesave prindërore për fëmijën e tretë, për të zgjatur të drejtën e shtesave prindërore për fëmijën e katërt.

Analiza e masës së parë tregon se synimi i politikës është neutral për gjinitë, mirëpo ndikimi mund të ketë një dimension gjinor, në varësi nga ajo se kush janë përfituesit. Pa dispozita specifike të mbështetjes së nënave të vetme, viktimave të dhunës e të ngjashme, masa si e tillë nuk ofron sqarimin e dimensionit gjinor, edhe pse posedon një potencial të madh për sensibilizimin gjinor, për të synuar nënat e vetme, familjet e

mëdha dhe kategoritë vulnerabël të qytetarëve, e sidomos gratë nga zonat rurale dhe gratë me aftësi të kufizuara. Viktimat e dhunës që u intervistuan për qëllimet e këtij studimi, po ashtu detektuan nevojën për sqarimin e masave ekonomike të Qeverisë dhe masave për njerëzit që janë në rrezik social, që të mund të kenë akses në të.

Masa e dytë, e cila i referohet aksesit në të drejtën e shtesës për fëmijë dhe afatet e zgjatura për paraqitjen e kërkesave për ushtrimin e kësaj të drejte, mund të thuhet lirshëm se është e ndjeshme ndaj gjinive, gjegjësisht, përmban elemente të masës transformuese, sepse përmirëson gjendjen materiale të familjeve vulnerabël, e sidomos të nënave të vetme.

Masat e synuara për grupet vulnerabël; solidariteti social dhe kohezioni social	
	1) shtyrja e pagimit të qirasë për përfituesit e banimit social; Futja e një pagese të parave të gatshme prej 1000 denarëve për shpenzimet e energjisë elektrike në amvisëri për muajt prill dhe maj 2020;
	2) Aksesit i lehtësuar në të drejtën e shtesave për fëmijë dhe afatet e zgjatura për paraqitjen e kërkesave për ndihmë financiare të njëhershme për një të porsalindur, për realizimin dhe zgjatjen e së drejtës së shtesave prindërore për fëmijën e tretë, për të zgjatur të drejtën e shtesave prindërore për fëmijën e katërt.

Partneriteti me OSHC, konsultimet me vepruesit dhe komunikimet me qytetarët

Vendimet e marra në gjendje të jashtëzakonshme janë publike, shpallen rregullisht në ueb faqen e Qeverisë. Informacionet për gjendjen me Kovid-SARS-19 po ashtu po bëheshin publike gjatë konferencave ditore për shtyp (kryesisht nga Ministri i shëndetësisë, Venko Filipçe) dhe me komunikatat për shtyp të lëshuara nga Instituti i shëndetit publik që prezantonin statistikat lidhur me virusin. Megjithatë, në kuptimin e vendimmarrjes, Qeverisë i mungonin konsultime të gjera, përveç me sektorin e biznesit, me të cilin u takuan disa herë dhe ndoqën procedurë, ku po zhvilloheshin vendimet që po prezantoheshin gjatë konferencave për shtyp, pastaj po miratoheshin e pas zemërimit dhe pakënaqësisë së publikut, po ndryshonin për të adresuar kritikën e menjëhershme. Është me rëndësi supreme Qeveria të gjejë mënyrën se si të konsultojë publikun, e sidomos palët e interesuara në hartimin e masave, por edhe për të dhënë sa është e mundur më tepër dokumente të fuqishme shoqërore për masat që ata propozojnë dhe buxhetet që implementojnë manifestimet e marrëdhënieve të ndryshme kombëtare midis shtetit dhe shoqërisë civile. Në kompensim, këta reflektuan nivele të ndryshme të besimit social dhe andaj pranuan nivele të ndryshme të përgjegjësisë individuale dhe sociale. Nëse masat rigorozë që nga fillimi do të kombinoheshin me bashkëpunim social, që respektimi t'i delegohej individit, kohezioni social nuk do të ishte rrezikuar aq keq kohëve të fundit dhe nuk do të binte, sidomos që nga rritja e infektiveve me Kovid-19, duke polarizuar kështu shoqërinë në tre mënyra kryesore: politike, fetare/etnike dhe pro-liberalizimi kundrejt pro-ndalimit⁷⁴. Aq më tepër, hulumtimi jonë gjithashtu tregoi se konsultimi i OSHC-ve të grave mbi zhvillimin e masave pothuajse as nuk ekzistonte.

74 <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16286.pdf>

Sa iu përket burrave dhe grave me aftësi të kufizuara në këtë gjendje të jashtëzakonshme, shteti nuk bëri fare konsultime dhe akoma nuk ka bërë involvimin aktiv të organizatave të personave me aftësi të kufizuara në zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe politikave që kanë të bëjnë me gjendjen e jashtëzakonshme, madje shteti ka obligim konform KDPAK (Neni 4.3), përfshirë dhe domosdoshmërinë e financimit publik të pakusht për pjesëmarrjen e pavarur, të plotë dhe efektive të shoqërisë civile⁷⁵.

Me Parlamentin e shpërbërë dhe me një Qeveri me pushtet ligjvënës dhe ekzekutiv, mbikëqyrja e atyre vendimeve dhe këqyrja me kujdes nga organet e pavarura (përfshirë dhe sektorin e OSHC) është me shumë rëndësi. Kështu, "skena e OJQ ka qenë relativisht e qetë që nga vetë fillimi i krizës, dhe duket më e përqendruar në aktivitetet solidare, më tepër sesa në kryerjen e funksionit tradicional të vëzhgimit, sidomos kur debati i plotë mbi kalimin e mundshëm në autoritarizëm dhe abuzimet e mundshme të pandemisë për shkurtimin e lirive civile është me intensitet shumë të ulët në shoqërinë maqedonase për momentin"⁷⁶. Në këtë drejtim, me zhgënjim të madh u pranua shkurtimi i buxhetit në financimin e shoqërisë civile më 9 prill, që rezultoi me një thirrje të unifikuar të shoqërisë civile për rishikimin e vendimeve që çuan drejt thirrjes së shpejtë për aplikime për projekte të OSHC për Kovid-19⁷⁷, në të cilën u pranuan 549 aplikime dhe 40 OSHC morën grante⁷⁸. Procedura e përzgjedhjes u kritikua ashpër dhe procesi i përzgjedhjes zgjati 48 orë, duke e vënë atë nën hijen e të qenit të njëanshëm⁷⁹.

75 Shihni: CRPD/C/HRV/CO/1, paragrafi 53.

76 FES (2020) Demokracia dhe gjendja e jashtëzakonshme; betejat politike që burojnë nga kriza e koronës në Ballkanin Perëndimor, Kroacia dhe Sllovenia: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16213.pdf>

77 <https://vlada.mk/node/21648>

78 <https://www.radiomof.mk/vladata-ja-objavi-rang-listata-so-site-549-nevladini-shto-aplicirale-za-proekti-za-kovid-19/>

79 <https://www.radiomof.mk/organizacii-baraat-da-se-ponishti-vladinata-odluka-za-dodeluvanje-sredstva-na-organizacii/>




Kreu

2

ANALIZA E NDIKIMIT TË PËRGGJIGJES NDAJ KOVID-19 NGA PERSPEKTIVA GJINORE DHE E DIVERSITETIT


Pandemia Kovid-19, e shkaktuar nga Koronavirusi i ri radikalisht ndryshoi mënyrën e jetës dhe punës së njerëzve, duke prekur mirëqenien e tyre fizike dhe mendore në mënyrë të thelluar



2.1. PJESËMARRJA E GRAVE DHE BURRAVE NË TREGUN E PUNËS

Pandemia Kovid-19, e shkaktuar nga Koronavirusi i ri radikalisht ndryshoi mënyrën e jetës dhe punës së njerëzve, duke prekur mirëqenien e tyre fizike dhe mendore në mënyrë të thelluar. Një sondazh onlajn me përmasa të mëdha i Eurofound tregon se më se një e katërta e të anketuarve në BE, kanë raportuar se në këtë fazë kanë humbur punën e vet ose përkohësisht (23%), ose përgjithmonë (5%), ku më të prekur kanë qenë burra të rinj, dhe ata që jetojnë në Rumuni, Itali, Francë, Qipro dhe Greqi, të cilët punojnë me orar të shkurtuar. Vendet nordike kanë raportuar më pak reduktime të orarit të punës⁸⁰. Në Maqedoninë e Veriut, të dhënat mbi të papunët e regjistruar, të shpallur në bazë mujore nga Agjencia e Punësimit, kriza ka efekte të konsiderueshme negative mbi papunësinë. Grafiku 9 më poshtë tregon numrin e të papunëve të regjistruar, të cilët kanë marrë një trend të ashpër përpjetë, me fillimin e krizës. Më 31 maj 2020, kanë qenë për 21.11% më tepër persona të papunë të regjistruar, në krahasim me të njëjtin muaj në vitin 2019 (21.127 në numra absolutë), dhe 14.53% më tepër se bilanci më 29 shkurt, pak përpara se kriza të fillonte të shtjellohej.

Grafiku 9
Të papunët e regjistruar,
maj 2019 - maj 2020
Burimi: Agjencia e Punësimit e
Maqedonisë së Veriut



Për më tepër, nivelet e punësimit tek gratë janë rritur, në raport me burrat, që është pritur, duke ditur se tradicionalisht, më tepër gra punojnë në sektorët më të prekur nga kriza, siç janë sektori i shitjeve me pakicë të produkteve joushqimore dhe në hotelieri. Siç prezanton Grafiku 10 më poshtë, më 31 maj 2020, Agjencia e punësimit ka raportuar rritje nga 15.12% tek papunësia e grave, krahasuar me të dhënat para krizës të 29 shkurtit 2020, ku papunësia tek burrat është rritur për 13.97% në po të njëjtën periudhë.

80 Eurofound, (2020) Jeta, puna dhe Kovid-19, https://www.eurofound.europa.eu/sites/default/files/ef_publication/field_ef_document/ef20058en.pdf

Grafiku 10
Numri i të papunëve të regjistruar, krahasimi midis 31 maj 2020 dhe 29 shkurt 2020
Burimi: Agjencia e punësimit e Maqedonisë së Veriut





Figura e ardhshme zbulon se cilat 10 qytete të Maqedonisë së Veriut kanë përjetuar rritjen më të madhe të numrit të grave të regjistruara si të papunë, krahasuar midis 31 majit dhe 29 shkurtit të vitit 2020. Është e evidente se gratë në Gjevgjeli janë goditur posaçërisht nga kriza, qytet ky që gjendet në kufirin jugor të Maqedonisë së Veriut, i cili është i njohur për sektorin e hotelerisë, lidhur me kazinotë dhe shpesh i vizituar nga mysafirë nga Greqia.

Grafiku 11
Ndryshimet tek gratë e papunë të regjistruara midis 31 majit 2020 dhe 29 shkurtit 2020, të klasifikuara sipas % së ndryshimit, 10 qytetet më të prekura
Burimi: Agjencia e punësimit e Maqedonisë së Veriut



Gratë që nuk janë regjistruar si të punësuar, mirëpo janë aktive në tregun e punës me punë joformale, befas humbën punën dhe të ardhurat e tyre. Me vështirësitë më të mëdha u përballën sidomos gratë rome. Ato kryesisht kanë punuar si gra shërbimi, pastruese apo shitëse në treg, dhe për shkak të faktit se tregjet e gjelbra u mbyllën dhe njerëzit gjatë izolimit qëndruan në shtëpi dhe vet po kujdeseshin për pastërtinë në shtëpitë e veta, gratë rome si punonjëse joformale mbeten të papuna⁸¹.


Kriza negativisht preku dhe trendin e mesatares së pagës neto. Krahasuar me pikën më të lartë në shkurt nga 27.206 denarë, ajo ra në 25.830 denarë në prill, apo një rënie relative nga 5.06% (Grafiku 12).

⁸¹ Intervistë me Fatima Osmanovska, LSDM, Kryetare e Këshillit Komunal të Shuto Orizares, qershor 2020

Humbjet e punës, në kombinim me orarin e reduktuar të punës dhe pagat e zvogëluara po shkaktojnë probleme financiare gjithandej. Eurofound detektoi një boshllëk nga 48 pikë në përqindje midis vendeve anëtare me proporcionin më të ulët (Danimarka me 12%) dhe më të lartë (Bullgaria me 60%), ku raportohet se gjendja e tyre financiare është tani më e vështirë se para tre muajve. Kjo është konstatuar dhe në Maqedoninë e Veriut dhe si rezultat i zvogëlimit të pagës, humbjet e punës dhe kombinimin e barës plotësuese financiare që është vënë mbi popullsinë vulnerabël (romët, të papunët, nënat e vetme), duke iu përmbytur rekomandimeve për mbrojtjen e shëndetit si dhe distancimit social. Për sa iu përket rrogave, Grafiku 12 më poshtë tregon se kriza ka pasur efekt negativ mbi trendin e mesatares së pagës neto. Krahasuar me pikën më të lartë në shkurt nga 27.206 denarë, ato kanë rënë në 25.830 denarë në prill, apo rënia relative nga 5.06%.

Grafiku 12
Mesatarja e pagës neto,
shtator 2019 – prill 2020,
5 sektorët e përzgjedhur
me % më të lart të rënies,
krahasuar me shkurtin
2020

Burimi: Enti Shtetëror i
Statistikave



Sido që të jetë, ashtu siç po pritej, disa sektorë kanë marrë goditje më të mëdha nga kriza. Industria e argëtimit dhe madje shoqëria civile kanë përjetuar ulje të ritmit me paga të zvogëluara. "Punoj në një bastore dhe në një OSHC, puna e parë ma zvogëloi pagën, ndërsa krizat bënë që të shtyhet implementimi i projekteve të OSHC-së për 2 muaj, gjë kjo e cila preku edhe pagesat"⁸². Tabela më poshtë tregon se 5 sektorët më të prekur me përqindjen më të lart të rënies, krahasuar me shkurtin e vitit 2020, kur kriza filloi të dalë në shesh, janë aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit të ushqimeve, artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, prodhimtaria dhe transportimi dhe magazinimi.

82 Intervistë me një aktivist rom në maj 2020

Tabela 4
Ndryshimi i përqindjes
së mesatares së pagës
neto, krahasuar midis
prillit 2020 dhe shkurtit
2020
Burimi: Enti Shtetëror për
statistikë

SEKTORI	NDRYSHIMI I % KRAHASUAR MIDIS PRILLIT 2020 DHE SHKURTIT 2020
Aktivitetet e sistemimit dhe të shërbimit të ushqimit	-23,18 %
Artet, argëtimi dhe rekreacioni	-19,53 %
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	-16,11 %
Prodhimtaria	-10,52 %
Transportimi dhe magazinimi	-10,32 %
Të gjithë sektorët	-5,06 %
Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	-4,88 %
Informimi dhe komunikimi	-3,63 %
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe të punës sociale	-3,45 %
Ndërtimtaria	-3,37 %
Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve	-2,07 %
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social	-1,60 %
Aktivitetet e patundshmërive	-1,58 %
Ujësjiellësi; kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e riparimeve	-1,50 %
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	-0,89 %
Arsimi	-0,59 %
Aktivitetet e shërbimeve të tjera	-0,13 %
Aktivitetet administrative dhe ato të shërbimeve të asistencës	0,88 %
Furnizimi i energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ajrit të kondicionuar	2,36 %
Xehetaria dhe nxjerrja e gurit	9,48 %

Duke ditur se punonjësit në vijën e parë të cilët po luftonin me virusin janë më të tendosurit, si punonjës themelorë, të cilët domosdo të raportojnë fizikisht në punën e tyre dhe janë më vulnerabël ndaj rreziqeve për shëndetësinë dhe punojnë me orar më të gjatë për të dhënë shërbimet me nevojën gjithnjë në rritje nga ata, këta punonjës të vijës së parë kërkojnë vëmendje më të madhe dhe valorizim më të mirë të mundit të tyre. Megjithatë, vendimi i Qeverisë për të shpërblyer me shtesa për punën e kryer jashtë orarit dhe shtesa për punën e natës tek forcat e sigurisë (si në armatë, ashtu dhe në polici), ku punojnë më së shumti burra, ndërsa e njëjta nuk është bërë në tërë sektorin

shëndetësor (vetëm rritja e pagave të mjekëve, por jo edhe të infermiereve dhe stafit tjetër në sektorin shëndetësor), ku punojnë më së shumti gra, po krijon një boshllëk gjinor. Përderisa vendimi paraprak verifikon njohjen e punës dhe kontributit të grave në armatë dhe në polici⁸³, *“pakoja e tretë e masave që u paralajmërua nga Qeveria, deri diku iu referohet profesionistëve mjekësorë, mirëpo akoma po zhvillohen analiza se kush duhet të inkuadrohet nga më të prekurit, siç janë klinikat e sëmundjeve ngjitëse, institucionet e shëndetit publik, si dhe qendrat e tjera Covid-19; në kuptimin e rritjes së pagës, edhe pse Qeveria tanimë ka rritur pagat e profesionistëve shëndetësorë”*⁸⁴. Edhe përkundër këtyre përpjekjeve, intervistat me gra në vijën e parë, të cilat punojnë në sektorin shëndetësor, e posaçërisht në laboratorët ku po administrohet testimi për Covid-19, dëshmojnë se ato jo vetëm që nuk janë stimuluar plotësisht me ndonjë shpërblim, por ato nuk kanë pranuar as pagat bazë për tre muaj⁸⁵.

Sistemi i pagave duhet të korrigojë dhe t'i reflektojë aktivitetet dhe përgjegjësitë që njerëzit i marrin në vendet e punëve të veta, si dhe rrezikun që marrin për t'u infektuar gjatë kryerjes së detyrës së punës. Sistemi i pagave nuk duhet të marrë në konsideratë vetëm epërsinë, vitet e shërbimit dhe arsimimin. Kjo sepse njerëzit fillojnë të ndjehen të diskriminuar. *“Unë ndiej veten të jem absolutisht i diskriminuar, vetëm punonjësit e 2 sektorëve u përfshinë në mënyrë aktive në përgjigjen ndaj Covid-19 nga 200 punonjës në Institutin e shëndetit publik, kjo bëri që vetëm 30 persona të paraqiten në punë çdo ditë, ndërsa ne, që punojmë në laborator, jemi më së shumti të nënshtruar ndaj rrezikut, kurse jemi me orarin më të gjatë të punës. Pjesa tjetër e kolegëve të mi u dërguan në shtëpi, dhe janë duke pushuar dhe duke postuar foto në mediat sociale, përderisa po paguhen njëjtë si unë”*⁸⁶.

2.2. LIDHUR ME ROLET GJINORE DHE SISTEMIN GJINOR

Gratë tradicionalisht janë në pararojë të përgjegjësive shtëpiake dhe të punës brenda familjeve të veta. Ato në përgjithësi shihen si boshti i familjes dhe luajnë role të shumëfishta, siç janë kujdestare në shtëpitë dhe bashkësitë e veta. Në Maqedoninë e Veriut, gratë kalojnë më tepër kohë në aktivitetet shtëpiake, krahasuar me burrat, dhe kanë më pak kohë të lirë. Të dhënat nga studimi i shfrytëzimit të kohës tregojnë se shfrytëzimi i kohës nuk është përmirësuar konsiderueshëm nga viti 2009 deri në vitin 2014 (kur për herë të fundit u zbatua studimi). Indeksi i barazisë gjinore po ashtu tregon një disavantazh gjigant të grave në dimensionin e kohës; vendi “ka vonesën e dytë më të madhe (pas dimensionit të parave) në dimensionin e kohës, krahasuar me vendet anëtare të BE-së dhe me mesataren evropiane (BE-28)”⁸⁷. Gratë bartin ngarkesën e aktiviteteve shtëpiake, duke shpenzuar tre herë më tepër kohë (katër

83 Intervistë me Slavjanka Petrovska, Ministre plotësuese e Punëve të Brendshme, maj 2020

84 Intervistë me Jovana Trençevska, Sekretare Shtetërore në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, maj 2020


85 Intervistë me një zyrtar të lart në Institutin e Shëndetit Publik, maj 2020

86 Ibid

87 Indeksi i Barazisë Gjinore, i disponueshëm onlajn: https://eurogender.eige.europa.eu/system/files/events-files/gender_equality_index_macedonia_eng.pdf

herë më tepër në zonat rurale), krahasuar me burrat. Përderisa gratë shpenzojnë një orë më pak në punën e paguar, krahasuar me burrat, prapëseprapë burrat kanë një orë më tepër të kohës së lirë, sidomos gjatë fundjavave⁸⁸, duke konfirmuar kështu argumentin feminist se gratë e punësuar duhet të punojnë “ndërrimin e dytë” në shtëpi. Masat e miratuara si përgjigje ndaj virusit kanë institucionalizuar rolin gjinor të grave të kujdestares në shtëpi dhe familje, dhe kanë ngulitur stereotipin gjinor se burrat janë shtylla e familjes. Domethënë, mbyllja e kopshteve të fëmijëve u pasua me masën që njëri prind i fëmijëve më të vegjël se dhjetë vjeç të lirohet nga puna, që rezultoi me atë që çdo i pesti prind që u lirua ishte babai, duke bërë që nënat të marrin mbi tre të katërtat e barrës së përgjithshme të përkujdesjes⁸⁹. Veç kësaj, gratë në pushim të lindjes u lejuan të vazhdojnë pushimin e tyre nga puna përgjatë pandemisë, por vendimi nuk përfshiu pushimin e zgjatur për baballarët i cili gjithashtu është i rregulluar sipas ligjit maqedonas mbi marrëdhëniet e punës.

Burimi: QHKP,
Infografiku i ndikimit
gjinor të masës mbi
lirimin nga puna
për t'u kujdesur për
fëmijët gjatë Kovid-19



Krizat përplasin me pabarazitë para-ekzistuese, në mënyrë që grupe të ndryshme grash do të ndikohen në mënyrë joproporcionale dhe ndryshe. Fakti se kohën që kanë kaluar gratë për aktivitetet shtëpiake rritet ashpër për grupmoshat e grave 25-44 vjeç, përderisa ato zvogëlohen për burrat e të njëjtës grupmoshë; krijon pikturën e një familjeje patriarkale, ku gruaja pothuajse tërësisht merr përsipër kujdesin për fëmijët, por edhe për anëtarët e tjerë të familjes. Kjo tregon se rolet tradicionale gjinore mjaft mbizotërojnë në shoqëri, dhe po përforcohen me lidhjen në partneritet/martesë, e në veçanti me pasjen e fëmijëve. Ka mungesë të ndërgjegjësimit për mosbalancimin e grave në familje në nivelin e amvisërisë dhe punës, që rezultojnë me sfida që gratë të shprehin lirshëm nevojat dhe të kërkojnë mbështetje. Akoma pritet që gratë të kujdesen për fëmijët, të gatujnë dhe të pastrojnë shtëpinë, ndërsa burrat të kujdesen për financat.

88 Sondazhi mbi shpenzimin e kohës 2009, Enti Shtetëror i Statistikave; Sondazhi mbi shpenzimin e kohës 2014/15, Enti Shtetëror i Statistikave

89 CRPM has sent a free access to information request to 102 kindergartens and received response from 63 of the kindergartens.

Rolet tradicionale gjinore mbahen fort nga pothuajse gjysma e grave, sidomos ato që u përkasin bashkësive jo shumicë⁹⁰. Gjetjet e intervistave me gratë rreth dëshmojnë se gjatë izolimit, ato më së shumti kanë bërë për fëmijët e vet, duke i bërë ballë rritjes së detyrave të shtëpisë dhe kohës së kaluar në gatim, pastrim dhe kujdes ndaj fëmijës/të moshuarit. Siç nënvizuan disa nga ato, ishte ky rasti për t'i përmirësuar "shkathtësitë e tyre të gatimit". Edhe gratë rurale, gjatë izolimit, u ngarkuan me punë dhe përgjegjësi shtëpiake, siç janë pastrimi, gatimi, kujdesi ndaj fëmijëve, bërja e pazarit, krahas punës në fushat e tyre dhe në prodhimin e frutave, perimeve, mishit dhe produkteve të bulmetit. Në të shumtën e rasteve, burrat e tyre shkronin në punë. *"Im shoq nuk ndjehej i ngarkuar, sepse tërë kohën po shkonte në punë"* – tha një grua rurale nga Novosella e Kumanovës. Për shkak të kufizimit të lëvizjes për të moshuarit, prindërit e tyre nuk mund t'i ndihmonin as në aktivitetet e caktuara ditore. *"Im shoq u çlirua nga obligimet e tilla për një kohë të gjatë, ndërsa motra ime më ndihmonte"*.⁹¹

Nënat e vetme në kohërat e krizës ishin më të tendosurat. E tërë barra ra mbi supet e tyre, në kuptimin e kujdesit ndaj nevojave të fëmijëve të tyre, dezinfektimi dhe barra më e madhe ishte mbështetja e mësimnxënies së fëmijëve të tyre. *"Jam krejtësisht e vetme, nuk kam ndihmë, nuk komunikoj me asnjëri, nuk kam mundësi të ndihmës së askujt, as nga prindërit, as nga familjarët dhe miqtë, jemi plotësisht të izoluar. Në kuptimin e plotë të fjalës, kujdesem për gjithçka, përgatitjen e ushqimit, higjienën në shtëpi, higjienën e fëmijëve, blerjen e ushqimit dhe artikujve, shëtitjen e fëmijëve, asistimin e mësimnxënies së tyre, lozjen bashkë me të voglin, pra, po, i bëj absolutisht të gjitha. Përpiqem t'i shpërndaj përgjegjësitë gjatë ditës, por është shumë e vështirë"*.⁹² Mësimnxënia onlajn krijoi një barrë plotësuese emocionale dhe mendore për ato. *"Mundohem ta ndihmoj atë, por nuk kam kohë t'i sqaroj në hollësi çdo lëndë. Disa javët e para ishin sfiduese, sepse ai u hutua, mendonte se nëse do të qëndronte në shtëpi, nuk do të duhej të mësonte"* – tha njëra nga nënat e vetme të intervistuar. Të qenit kujdestare, edukatore, pastruese dhe punonjëse e paguar e vetme ishte një sfidë e tmerrshme dhe dërrmuese për nënat e vetme. *"Arsimtarët po dërgonin gjithçka që do gjenin për momentin në internet, shumica nga burime të pasigurta, duke shfrytëzuar gjuhën jostandarde, dhe dukshëm pa kontrollin e cilësisë së BDE dhe SEI"*.⁹³ Mësimnxënia ishte problematike për gratë rurale, pasi disa nga ato nuk mund ta mbanin barrën e kostos së shkollimit onlajn, pasi ato nuk ishin në gjendje të siguronin kompjuterin, apo internetin, e as nuk kishin njohurinë dhe shkathtësitë për t'ia ofruar cilësinë e njëjtë të shkollimit si arsimtarët e shkolluar. *"Kisha aq shumë përgjegjësi dhe shumë punë me orët onlajn, punoja me vajzën më të vogël, sepse mësuesi nuk ishte shumë i interesuar për punë dhe dërgim të detyrave, andaj e ndihmova vajzën aq sa pata mundësi"*.⁹⁴

90 http://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/fyr%20macedonia/nat_research_female_labour_market_research.pdf?la=en&vs=936

91 Intervistë me një grua rurale, maj 2020

92 Intervistë me një nënë të vetme nga Shkupi, maj 2020

93 Intervistë me një nënë të vetme, maj 2020

94 Intervistë me një grua rurale nga Rosomani, maj 2020

Për fat të keq, ndërgjegjësimi i vendimmarrësve se gratë kanë vepruar si jastëk i padukshëm gjatë izolimit dhe kanë bërë familjet dhe shoqërinë më të qëndrueshme, është shumë i ulët, që rezulton të mos ketë masa specifike të cilat do ta adresonin këtë barrë plotësuese të rënë mbi supet e tyre. Për më tepër, bëhen sigurime plotësuese nga vendimmarrësit e intervistuar se ky rol i grave është diçka e pritur. *“Nuk di për gratë e tjera. Nëse janë mirë të koordinuara, të përkushtuara, profesionale, atëherë nuk duhet patur vështirësi. Mungesa e kohës është problem, gjitha të tjerat janë të vazhdueshme, të përkohshme dhe mund të mbështeten”*.⁹⁵ Interesi dhe profesioni primar i grave duhet qenë shtëpia e tyre, fëmijët dhe familja. E nëse punojnë në vend se të kujdesen për këto të përmendura më lart, sipas vendimmarrësit të Dibrës, gratë duhet të shpërblehen në mënyrë plotësuese. *“Burri dhe gruaja nuk mund të kenë të njëjtën rrogë për punën e njëjtë. Gratë duhet të marrin më tepër sepse kjo do ta kompensonte mungesën e tyre në familjet e tyre”*.⁹⁶

Për fat të keq, as politikëbërësit e nivelit lokal, as vendimmarrësit e nivelit qendror, e as politikët dhe masat e miratuara dhe të hyra në fuqi nga marsi deri në korrik 2020 nuk promovuan përgjegjësinë e përbashkët brenda shtëpisë. Prezenca e shtuar e burrave në shtëpi mund të çonte drejt marrjes së racionit të rritur të punës së papaguar nga ana e tyre. Megjithatë, askush nuk përdori këtë situatë unike për të inkuadruar burrat dhe gratë në rishpërndarjen dhe ndarjen e barabartë të barrës së punës së papaguar të shtëpisë dhe kujdesit. Përkundrazi, gratë po rrasapiten dhe po bëhen shkumb. *“Unë ndoshta vuaj më së shumti, sepse përpiqem të amortizojë pakënaqësitë dhe frustrimet. Kam frikë për shëndetin tim, nuk kam kohë të kujdesem për veten dhe nuk e di për sa kohë do të jem në gjendje ta duroj këtë. Nevojat e mia personale janë të parëndësishme”*.⁹⁷

2.3. DHUNA NDAJ GRAVE

Dhuna ndaj grave dhe vajzave (DHNGV) është shkelje e të drejtave të njeriut, një çështje universale, me ndikim të madh mbi viktimat/të mbijetuarit, mbi familjet dhe bashkësitë e tyre. Me fillimin e krizave, raportimet në tërë botën alarmuan për hijen⁹⁸ apo pandeminë e dyfishtë⁹⁹ që po ndodhin paralelisht: rritja e dhunës në familje si rezultat i masave të lëvizjes së kufizuar dhe qëndrimit në shtëpi dhe disa gra, fëmijë dhe individë LGBTQ+ – shtëpia është një vend i rrezikshëm¹⁰⁰. Perceptimi për dhunën në familje gjatë pandemisë ndryshon në komunitetet e ndryshme dhe ndërmjet bashkëbiseduesit gra dhe burra të përfshirë me studimin. Për shembull, në komunitetin

95 Intervistë me një vendimmarrës të lart nga Prilepi, qershor 2020

96 Intervistë me një politikëbërës të lart nga Dibra, qershor 2020

97 Intervistë me një nënë të vetme, maj 2020

98 Kovid and VAW: The shadow pandemic, e disponueshme onlajn: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/issue-brief-Kovid-19-and-ending-violence-against-women-and-girls>

99 The double pandemic: domestic violence in time of Kovid-19, e disponueshme onlajn: <https://www.cfr.org/in-brief/double-pandemic-domestic-violence-age-Kovid-19>

100 <https://mhc.org.mk/news/za-mnogu-zheni-domot-e-nebezbedno-mesto-dva-sluchai-na-femicid-vo-vreme-na-pandemija/>

Provat kualitative të ndikimit të Kovid-SARS-19 mbi dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut tek viktimat dhe shërbimdhënësit tregojnë se ka një trend në rritje të rasteve të dhunës ndaj grave

rom, gratë e anketuara deklaruan se karantina kishte nxitur rritjen e dhunës në familje, duke treguar se gratë nga komunitetet e tyre kanë qenë të abuzuara dhe kanë raportuar dhunë. Nga ana tjetër, për këtë nuk referuan burrat e anketuar në përgjigjet e veta.

Provat kualitative të ndikimit të Kovid-SARS-19 mbi dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut tek viktimat dhe shërbimdhënësit tregojnë se ka një trend në rritje të rasteve të dhunës ndaj grave. Të intervistuarit nga shërbimet e dhënies së këshillave juridike dhe mbështetjes dhe konsultimeve psikosociale raportuan një numër të shtuar të ankesave në lidhje me dhunën në familje. Shumica e këtyre rasteve tregojnë efektin negativ të izolimit në shtëpi, sidomos kur kundërvajtësit e mëhershëm përsëri u bënë të dhunshëm gjatë izolimit të gjatë në shtëpi, duke ilustruar kështu se masat për bërjen ballë të shpërhapjes së Kovid-19 "bllokuan" viktimat në shtëpi me dhunuesit. Për ta ilustruar seriozitetin e kësaj situatë, kishte raste ku bashkëshorti kishte dëbuar gruan nga shtëpia e tyre pikërisht përpara fillimit të orës policore, që rezultoi në stres të stërmadh, si nga vepra e dhunës, ashtu dhe nga frika nga gjobitja policore për shkeljen e orës policore, mirëpo kryesisht në lidhje me situatën e të qenit të pastrehë¹⁰¹.

*"Më duhej ta denoncoja atë, sepse nuk e dija se çfarë do të ndodhte më 6 maj. Sfidat më të mëdha të cilën përballova në denoncimin e dhunës ishte se ai më kërcënoi të më dëbonte. Nuk është e lehtë kur ke fëmijë. Ai njëherë erdhi, goditi rëndë dhe theu bravën e derës, dhe unë nuk e denoncova. Pastaj ai më vodhi veturën, e unë prapë nuk e denoncova. Ai erdhi disa herë dhe bëri dramë. Mendoj se shumë gjëra kanë ndodhur gjatë këtij viti e gjysmë dhe tanimë vendosa ta denoncoja"*¹⁰².


Të dhënat kuantitative gjithashtu treguan një situatë ku rritet si trendi i rasteve të dhunës në familjes për tre muajt përpara Kovid-SARS-19, ashtu dhe gjendja e jashtëzakonshme. "Informacionet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga janari deri në mars 2019, në kuptimin e numrit të krimeve lidhur me dhunën në familje, treguan 207 raste, ndërsa sivjet ky numër është ngjitur në 241. Nga këto raste, 47 viktima kanë qenë burra dhe 207 gra. Është rritur edhe numri i ankesave për dhunë në familje; vitin e kaluar në periudhën nga janari deri në mars janë paraqitur 780 ankesa, ndërsa sivjet numri është ngjitur në 920."¹⁰³

101 Intervistë me një viktimë dhune, maj 2020

102 Intervistë me një viktimë dhune nga Pehçeva që denoncoi rastin e vet në maj, pasi kishte jetuar në një ambient të dhunshëm për 5-6 vjet.

103 Intervistë me një shërbimdhënës për viktimat e dhunës kundër grave, maj 2020

Grafiku 13:
Krahasimi i rasteve
të DHNG janar - mars
2019-2020
II Burimi: Ministria e punëve
të brendshme, qershor 2020



Për më tepër, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, kur lëvizja u kufizua dhe popullsia ishte kryesisht e izoluar në shtëpitë e veta, në pjesën më të madhe të kohës, numri i veprave penale lidhur me dhunën në familje u rrit në përmasa të mëdha. Për vetëm një muaj, nga 12 prilli e deri më 12 maj, u kryen 85 vepra penale, kryesisht në Ohër, Shkup dhe Strumicë¹⁰⁴. Ministria e punëve të brendshme ka paraqitur 49 raste të shkeljes së ligjit, kundër 54 kundërvajtësve, ndërsa janë pranuar 373 ankesa nga qytetarët për dhunë, që ngjiti këtë trend për 44.6%.¹⁰⁵ Për fat të keq, në këtë periudhë, vendi përjetoi dy raste të femicideve, të kryera nga partneri intim i gruas, njëri në Haraçinë¹⁰⁶ dhe tjetri në Shkup¹⁰⁷.

Trendi i rasteve të shtuara veçanërisht vazhdon në periudhën e izolimit në shtëpi, kur të dhënat e Ministrisë së punëve të brendshme tregojnë rritje nga 20% të rasteve nga periudha e njëjtë në vitin e kaluar.


104 https://www.pravdiko.mk/chulev-prijavite-za-semejno-nasilstvo-za-april-maj-zgolemeni-44-6-otsto-za-razlika-od-lani/?fbclid=IwAR3dTUIo7plvZg44TH3kupR1BKSBm_TdtvrNqVGpsZHniDU68ZAMPZ-iLwY

105 Ibid

106 <https://360stepeni.mk/ubistvo-vo-arachinovo-edno-litse-privedeno/>

107 <https://360stepeni.mk/ojo-27-godishnik-osomnichen-za-ubistvo-do-smrt-pretepal-zhena/?fbclid=IwAR1g3kG2Iz3HaTf7ZkNTIOam3xXXMC1ZgAnR-XBIYtm6GCrCpZPqXE77rxQ>

Grafiku 14:
Krahasimi i rasteve
të dhunës ndaj grave
gjatë muajit prill –
qershor 2019-2020
Burimi: Ministria e punëve të
brendshme, korrik 2020



Përderisa viktimat nuk janë të sigurta nëse dhuna në shtëpitë e tyre është shkallëzuar për shkak të virusit, apo të karantinës, apo thjeshtë sepse “ai është i etur që vazhdimisht të më mendojë”¹⁰⁸.

Në bazë të dëshmive të shërbimdhënësve, të gjitha llojet e dhunës janë raportuar gjatë pandemisë – ekonomike, psikologjike dhe fizike. “Unë vetëm thirra policinë. Kishte të bënte me abuzim psikologjik, fyerje të shpeshta drejtuar mua dhe fëmijëve të mi. Jetoj në tendosje, stres dhe frikë të vazhdueshme. Nuk munda të duroja më dhe zgjidhja e vetme ishte ta denoncoja”.¹⁰⁹



“Së pari ato u paraqitën në linjat e telefonit të Rrjetit (Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje), që janë publikuar në ueb faqen tonë. Bisedova me ato dhe ato kishin frikë të denonconin drejtpërsëdrejti në polici ose në Qendrën për punë sociale. Donin të këshilloheshin, mirëpo pak nga to kërkuan që punonjësi social të raportonte rastin tek ata”.

Viktimat kanë denoncuar dhunën në familje përmes linjës së telefonit 192 të policisë, si dhe përmes numrave për asistencë juridike dhe mbështetje psikosociale, të menaxhuara nga OSHC-të. Megjithatë, viktimat e dhunës kundër grave, sidomos në

¹⁰⁸ Intervistë me një viktimë dhune që raportoi rastin në mars, 2020.

¹⁰⁹ Viktimë nga Shkupi, 42 vjeç, raportoi dhunën gjatë muajit mars, pasi kishte jetuar në ambient të dhunshëm që nga viti 2015

Viktimat kanë denoncuar dhunën në familje përmes linjës së telefonit 192 të policisë, si dhe përmes numrave për asistencë juridike dhe mbështetje psikosociale, të menaxhuara nga OSHC-të.

periudhën e Kovid-SARS-19 vazhduan të mbështeten në shërbimet e mbështetjes psikosociale më pak se në ndërhyrjen policore. Kështu, intervistat treguan se viktimat ngurrojnë të pranojnë mbështetje psikologjike për shkak të mosbesimit tek institucionet dhe përgjigjet e tyre të mëkohshme, paaftësisë për ta mbështetur veten apo fëmijët e tyre, për shkak të varësisë së tyre financiare nga abuzuesi, si dhe për shkak të mungesës së sigurisë dhe strehimit të garantuar, që ofrohen nga institucionet. Si OSHC, ashtu dhe viktimat dhe shërbimet sociale dëshmuuan reagimin e menjëhershëm të policisë në periudhën e izolimit në shtëpi. *"Jam shumë e kënaqur se si policia reagoi ndaj kësaj situatë, sepse kërcënimet pushuan menjëherë pas kësaj, dhe mora këshilla dhe asistencë dhe mbështetje plotësuese nga OJQ të caktuara, të cilat japin shërbime në lidhje me dhunën në familje"*¹¹⁰. Ndjeshmëria e policisë në rastet e dhunës në familje u lavdërua në veçanti, në kuptimin e trajtimit, pajisjes mbrojtëse që mbanin dhe si po sillleshin përpara fëmijëve.

*"Thirra policinë gjatë orës policore dhe i pyeta nëse do të mund të vinin, sepse ndjehesha e kërcënuar, keq. Ata nuk erdhën në banesën time, unë dhashë deklaratën time poshtë, që më pëlqeu, se kjo nuk do të shkaktonte stres plotësues për fëmijët e mi. Zyrtarët e policisë mbanin maska dhe doreza"*¹¹¹.

Megjithatë, në eksperiencat e disa të intervistuarve, përgjigja e policisë dhe shërbimeve sociale u vlerësua si jo adekuate nga OSHC-të dhe viktimat, parimisht për kapacitetet e tyre të dobëta dhe ngarkesa me punë në çështje të tjera gjatë kësaj periudhe.

"Policia regjistroi dhunën në familje si ankesë dhe ndërhyri, mirëpo në fund, ata kërcënuan si viktimën, ashtu dhe abuzuesin se do t'i ndiqnin penalisht të dy. Ne si organizatë reaguam menjëherë për veprimet e tilla dhe sjellja u korrigjua menjëherë pas kësaj ndodhie" – tha një i intervistuar nga shërbimet e asistencës juridike. Për hir të faktit, kjo nuk është një gjetje e re, por ajo tregon se akoma ekziston një boshllëk i madh në mënyrën se si policia trajton këto raste dhe hapësira për të përmirësuar dhe fuqizuar njohuritë dhe kapacitetet e tyre për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave akoma është me rëndësi. Në këtë kuptim, një shërbimdhënës në Strumicë shënon se në këtë periudhë "vetëm kundër 5 kryerësve ishin ngritur kallëzime, ndërsa të gjitha rastet e tjera ishin shënuar si ankesab".

Mbetet problemi më i madh, dhe është kjo frika e përsëritjes së dhunës, si dhe frika se do t'u merren fëmijët.

"Edhe pse kjo mund të tingëllojë si një klishe, denoncimi i dhunës në familje akoma konsiderohet si tabu. Në përgjithësi, janë 49 denoncime në 30 ditë, krahasuar me vitet paraprake, ku në vit kishin rreth 100-150 denoncime në territorin e Strumicës. Në të shumtën e rasteve, viktimat i rikthehet abuzuesit. Klisheja është se viktimat akoma nuk janë të vetëdijshme për ashpërsinë e dhunës, kanë frikë dhe nuk kanë besim të mjaftueshëm tek institucionet dhe disa i tërë procesi është frenuar".

¹¹⁰ Ibid

¹¹¹ Intervistë me një viktimë dhune që denoncoi rastin në maj 2020.

Gjatë krizës, viktimat e dhunës në familje kishin akses në mbështetjen psikologjike onlajn dhe me telefon, që funksiononte ditë e natë dhe përbëhej nga dy punonjës social, një pedagog dhe një psikolog. Ata po ashtu kishin akses në mbështetje juridike falas, mirëpo për shkak të mungesës së personelit në Ministrinë e drejtësisë, ky shërbim nuk ishte plotësisht në dispozicion dhe nuk funksiononte tërësisht. Ishte ky pak a shumë rasti me Qendrat për punë sociale, ndërsa kapacitetet e mjaftueshme për emergjencat të sigurta dhe sistemime të sigurta për gratë viktimat të dhunës ishin të limituara.

"Shumica e viktimave nuk dëshironin të përdornin strehimin, ato dëshironin të vendosnin siguri në shtëpitë e tyre, ku ndodhte dhuna. Me fjalë të tjera, viktimat dëshironin që kundërvajtësi të zhvendosej, e jo viktimat, që në parim, ndryshon mënyrën e të punuarit kur trajtohen rastet e dhunës në familje nga Qendrat për punë sociale dhe nga Ministria e punëve të brendshme."

Mjetet kryesore të komunikimit që u përdoren nga shërbimdhënësit ishin mediat sociale, kryesisht Facebook-u. Format e tjera të komunikimit me klientët gjatë gjendjes së jashtëzakonshme përfshinin takime ballë-për-ballë, thirrje me Viber dhe telefon. Të intervistuarit garantuan se shumica e viktimave janë pajisur me informacione të mëkoshme për shërbimet. Në disa raste u aplikua qasje e përbashkët, siç ajo e Shoqatës maqedonase të juristëve të rinj, në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme dhe Qendrave për punë sociale për asistencë juridike falas. Qeveria reagoi shpejt në kërkesën e Rrjetit kundër dhunës ndaj grave dhe parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës me bazë gjininë dhe dhunës në familje. Për fat të keq, kërkimi nuk detektoi gjetje lidhur me dhunën kundër grave me aftësi të kufizuara apo të popullsisë LGBTI+.

2.4. PËRSHIRJA E GRAVE DHE BURRAVE NË REAGIMIN PËRFSHIRË DHE NË VENDIMMARRJEN PËR REAGIMIN NDAJ KOVID-19

Ashtu siç po intensifikohet Kovid-19, po bëhet e qartë se nëse dëshirojmë të sigurojmë shëndetin, mirëqenien dhe barazinë, duhet të vendosim gratë dhe vajzat në plan të parë, apo në qendrën e reagimit. Kështu, përderisa gratë janë në vijën e parë të reagimit, si punonjëse në kujdesin shëndetësor¹¹², kujdestare në shtëpi¹¹³, pastruese dhe shitëse, mes roleve tjera; ato përbëjnë shumicën e punonjësve me nënshtrimin më të lart ndaj Kovid-19, pasi të gjitha këto vende pune kanë "rrezik të lartë". Megjithatë, siç theksoi drejtori i spitalit publik në Prilep, burrat kishin një rol të rëndësishëm në vijën e parë, duke luftuar virusin, pasi që aktivitetet më thelbësore gjatë pandemisë u bënë nga burrat: siç janë roje, shoferë të automjeteve të emergjencës, pastrues¹¹⁴.

Në të njëjtën kohë, gratë në Maqedoninë e Veriut nuk morën pjesë të barabartë në vendimmarrje. Parlamenti është vendi i vetëm ku ekuilibri gjinor është arritur pothuajse për shkak të kuotës gjinore, mirëpo pasi Parlamenti u shpërbë gjatë pandemisë, kjo

112 Enti Shtetëror i Statistikave, 15355 persona janë gra nga gjithsej 21200 personave të punësuar në sektorët e shëndetësisë.

113 Siç tregon pjesa 2.1. më lart

114 Intervistë e zhvilluar në qershor, 2020

kontribuoi që gratë kryesisht të mungojnë nga vendimmarrja. Kjo ka ndikim direkt në jetët e njerëzve. Vendet me gra në lidhshmëri – në qeveritë, kabinetet, legjislativat – i janë përgjigjur Kovid-19 duke marrë në konsideratë efektet e krizës mbi gratë dhe vajzat.¹¹⁵ Megjithatë, ka më tepër përjashtime, sesa norma. Për qëllimet e analizës, u intervistuan gra në pozita të larta në procesin e vendimmarrjes në sektorë të ndryshëm, për të elaboruar rolin e grave në zhvillimin e luftimit të Kovid-19.

Lidhshmëria dhe pjesëmarrja e grave mund të sigurojë politika, plane dhe buxhete më efektive, përfshirëse dhe të drejta, për të adresuar pandeminë. Kështu, për të siguruar se çështjet e barazisë gjinore janë ngulitur plotësisht në përgjigjet e tona, na nevojiten gra në lidhshmëri që janë të ndërgjegjësuar për çështjet gjinore dhe që mund ta inkuadrojnë shpejt perspektivën gjinore në hartimin e politikave. Kërkimi tregoi se madje edhe gratë në pozita eprorë konsiderojnë se koha për zbatimin e analizës gjinore ka qenë e limituar. *"Fokusi i Ministrisë së punëve të brendshme është kthyer kryesisht në masat për luftimin e Kovid-19, me theks mbi kufizimin e lëvizjes së qytetarëve dhe vënien e orës policore, pa vështruar në veçanti perspektivën e grave"* - Sllavjanka Petrovska, Ministre plotësuese e punëve të brendshme. Përshtatja e masave të miratuara politike ndaj nevojave të grave u bë me koordinimin midis Ministrisë së punës dhe politikës sociale, mirëpo atëherë kur u shfaq kjo nevojë (gjegjësisht, pasi gratë dhe fëmijët, si viktimat më të zakonshme të dhunës në familje, u përballën me probleme në denoncimin e dhunës në shtëpitë e tyre gjatë orës policore). Ndërkaq, mungonte analiza *ex-ante* dhe konsiderata gjinore përpara miratimit të masës, edhe pse ajo bën pjesë në parimet e qeverisjes në menaxhimin e politikave dhe buxheteve në gjendje të jashtëzakonshme, dhe rekomandohet nga OBSH, sidomos në pikëpamjen e reagimit ndaj Kovid-19¹¹⁶. Andaj, përderisa pjesëmarrja e grave në përgjigjen ndaj Kovid-19 ishte e lavdërueshme, meqenëse në funksionet e Zëvendës ministrit të punëve të brendshme, Kryeministrit të çështjeve ekonomike dhe Ministrit të financave qëndronin gra; sjellja e masave politike nuk ndoqi parimet e integritetit gjinor, që kërkon futjen e perspektivave të barazisë gjinore në të gjitha fazat e krijimit të politikave. Përkundrazi, ishte reaksioniste: *"institucionet, në bashkëpunim me sektorin e shoqërisë civile, reagues me kohë, që të mund të korrigjoheshin masat që ne nuk i parashikuam si të tilla, në mënyrë që ato të vihen në pajtim me nevojat dhe interesat e qytetarëve"*. Kjo pikturon të njëjtën pasqyrë si në veprimet e mëhershme të gatishmërisë dhe rimëkëmbjes në fatkeqësi, ku nevojat dhe interesat e grave rrallëherë përfshiheshin, dhe kishin tendencë të zhvilloheshin me pak, apo me fare të dhënash të ndara sipas seksit apo gjinisë dhe me kontributin e ulët të përfaqësuesve të njësive kombëtare të barazisë gjinore, apo të organizatave

115 <https://www.undp.org/content/undp/en/home/blog/2020/when-it-comes-to-decision-making--women-must-move-from-the-margi.html>

116 OBSH (2020), Si të buxhetohet përgjigja ndaj Kovid-19? Një skanim i shpejt i mekanizmave buxhetorë në vendet e prekura rëndë, i disponueshëm në: https://www.who.int/docs/default-source/health-financing/how-to-budget-for-Kovid-19-english.pdf?sfvrsn=356a8077_1

**Në nivelin lokal,
sipas Kryetarit
të komunës së
Çairit, Visar Ganiu,
analiza gjinore
është zhvilluar
për të mënjanuar
diskriminimin**

të grave.¹¹⁷ Në nivelin lokal, sipas Kryetarit të komunës së Çairit, Visar Ganiu, analiza gjinore është zhvilluar për të mënjanuar diskriminimin¹¹⁸, por jo domosdo për të adresuar nevojat e ndryshme të grave përgjatë pandemisë.

Ndonëse sipas Ligjit për mundësi të barabarta, të gjitha organet publike dhe private janë përgjegjëse për të miratuar masa që reduktojnë pabarazinë gjinore, Ministri i punës dhe politikës sociale koordinon, monitoron dhe analizon efektet e masave të jashtëzakonshme tek gratë. Andaj, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Ministria fuqishëm varej nga mbështetja teknike dhe financiare e komunitetit ndërkombëtar. Për shembull, në bashkëpunim me UNDP, me Misionin e OSBE-së në Shkup dhe UN WOMEN, ajo ndau kuti higjienike dhe paketa ushqimesh për viktimat e dhunës në familje dhe prindërve të vetëm, nga të cilët 93% janë gra, përfshirë dhe baballarët e vetëm. Jovana Trençevska, Sekretare e përgjithshme e Ministrisë nënvizoi se nevojitet vlerësimi i vazhdueshëm i ndikimit të masave. Kjo në esencë nënkupton bërjen e vlerësimit nëse gratë kanë marrë pjesë, nëse janë konsultuar në procesin e zhvillimit të masës; nëse nevojat e grave kanë marrë përgjigjen e vet në hartimin e masës dhe nëse gratë kanë patur akses dhe përfitim nga zbatimi i masës dhe resurset e dhëna. Si përgjigje, ndikimi i masës për subvencionimin e pagës nga 14.500 denarë për gratë, që *“aktualisht po analizohet nga UN WOMEN ndërsa një ekspert do të përcaktojë se nga cilët sektorë dhe si është struktura gjinore e punonjësve në kompanitë që kanë aplikuar për financim, si dhe nëse kjo masë do të prodhojë përfitime”*. Përderisa autoritetet e nivelit qendror ishin në dijeni se analiza gjinore do të rezultojë me ruajtjen e vendeve të punës së grave, përfshirë dhe sektorët e shitjeve, tregtisë dhe tekstit, homologët e tyre në nivelin lokal me të cilët zhvilluam intervista, kishin shumë pak ndërgjegjësim për çështjet gjinore në lidhje me ndikimin e ndryshëm të masave që ata aplikojnë. *“Masat po zbatohen barazisht dhe ndikimin nuk duhet shikuar nga pikëpamja gjinore”*¹¹⁹.

Është interesante se, edhe pse në kohëra të jashtëzakonshme, të gjithë ishin në shtëpi, andaj institucionet kishin audiencë të vëmendshme, dhe aksesin në të gjitha kanalet e informimit ishte i lehtë, nga dhoma juaj e ditës apo nga shfletuesi në telefonin tuaj; përfaqësueset gra në qeveri identifikuan informimin dhe arritjen tek gratë si sfidat më të mëdha gjatë periudhës, sidomos për masat e miratuara. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale bëri përpjekje ta rriste transparencën, duke zhvilluar konferenca dhe duke shpallur rregullat onlajn (në ueb faqen zyrtare dhe në mediat sociale). *“Ne bashkëpunojmë edhe me organizatat që veprojnë në zonat rurale, ku shtrirja e informacioneve është shumë më e vështirë”*. Bashkëpunime të tilla janë vërtetuar dhe me OSHC të tjera që përfaqësojnë viktimat e dhunës, gratë rome, etj.

117 UN Women dhe UNDP, *Reduktimi i Rrezikut të Gjinive dhe Fatkeqësitë në Evropë dhe në Azinë Qendrore: Udhëzues për Fasilitatorë në Zhvillimin e Punëtorive*, 2018. Megjithatë, Kuadri Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (2015-2030), Neni 36 (a) (i) shënon se “Pjesëmarrja e grave është kritike për menaxhimin efektiv të rrezikut dhe për hartimin, pajisjen dhe implementimin e politikave, planeve dhe programeve të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë e ndjeshme gjinore; dhe masat adekuate të ndërtimit të kapaciteteve duhet të aplikohen për të fuqizuar gratë për gatishmëri, si dhe për ndërtimin e kapaciteteve të tyre për jetesë alternative në gjendje pas kalimit të fatkeqësive.”

118 Intervistë me Visar Ganiu, Kryetari i Komunës së Çairit, qershor 2020

119 Olivera Axhiovska, Drejtore e Spitalit Publik në Prilep, intervistë e zhvilluar në qershor 2020

Kryqi i Kuq ishte në vijën e parë për të luftuar virusin në 34 njësi organizative komunale, duke vepruar në drejtimin e parandalimit të sëmundjeve dhe përmirësimit të gjendjes shëndetësore dhe sociale të njerëzve¹²⁰. "Si burrat, ashtu dhe gratë morën pjesë në vendimmarrjen në nivelin lokal, të paktën është kjo përshtypja ime nga task forca dhe shërbimet që ne ofrojmë si Kryqi i Kuq"- deklaroi një përfaqësues i kësaj organizate në Prilep. Ky perceptim është rezultat i faktit se *"katër gra janë përfshirë në mënyrë aktive, duke përfshirë dhe veten time (drejtore e spitalit), drejtorja e Qendrës së Shëndetit Publik, drejtorja e NPK "Komunalec" dhe kryetarja e Degës Komunale të Kryqit të Kuq - Prilep. Në situata të caktuara, ashtu siç e kërkonte nevoja, një koleg mjek, epidemiolog nga Qendra e Shëndetit Publik dhe shefi i repartit i sëmundjeve ngjitëse në spitalin e qytetit morën pjesë në task forcën e komunës, që morën vendime se si t'i përgjigjen Kovid-19 në nivelin lokal"* deklaroi Olivera Axhioska. Edhe tre gra në Kumanovë, dy nga institucionet e shëndetit dhe njëra përfaqësuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme u involvuan në kryeqendrën e krizës, sepse ato po mbanin poste drejtuese dhe kështu morën pjesë në vendimmarrjen lokale. Ky nuk ishte rasti me komunën e Haraçinës, Çairit apo Dibrës, ku gratë nuk morën pjesë në vendimmarrje në kryeqendrat e krizës të këtyre tre komunave. Përfaqësuesit e komunës që u intervistuan e interpretuan këtë si *"mbrojtjen e tyre nga infektimi me virusin, pasi ato shikohen si shtylla e shoqërisë dhe familjes"*¹²¹. Përkundrazi, kryetarja e Komisionit të Mundësive të Barabarta në Çair dëshmon se gratë janë përjashtuar nga tabelat e vendimmarrjes. *"Disa njerëz jo vetëm që konsiderojnë se pjesëmarrja/përfshirja jonë është e panevojshme, por ata madje besojnë se gratë nuk mund t'i bëjnë ballë udhëheqjes së grupit të menaxhimit të krizave, që është e tmerrshme, se kjo na ndalon nga marrja e një roli më të madh se atë që kemi për momentin."*¹²² Strategjitë komunale të menaxhimit të krizave në nivelin lokal u harmonizuan me ato të Qeverisë në lidhje me pandeminë e Kovid-19, ku u miratuan disa masa të posaçme në përputhje me kontekstin lokal, siç janë asistimi i familjeve me anëtarë të palëvizshëm, qytetarëve që ishin në vetë-izolim, familjet socialisht të rrezikuara dhe të tjerëve. Komunitat gjithashtu shumë herë dezinfektuan rrugët, objektet fetare, shkollat, bizneset lokale¹²³. Studimi i UN Women për hartizimin e ndikimit të Kovid-19 mbi çështjet gjinore në nivelin lokal tregoi se shumica e komunave (14 nga 20 që morën pjesë në sondazh) kanë zhvilluar masa për t'iu përgjigjur virusit, që janë përgjegjëse ndaj gjinive¹²⁴. Veçse, vetëm 5 nga 20 komunitet e përfshira me

120 Aktivitetet e tyre kryesore gjatë krizës lidheshin me përmbushjen e nevojave themelore, siç është shpërndarja e produkteve ushqimore dhe higjienike grupeve qëllimore vulnerabël, siç janë njerëzit në nevojë dhe individët që ishin në vetë-izolim. Ato fasilituan dhe terapinë e onkologjisë për pacientët lokalë, të cilët për shkak të kufizimeve të lëvizjes, nuk ishin në gjendje të hynin me procedurë standarde; dhe administruan linjën direkte të ndërlidhjes për këshillime psikologjike dhe mbështetje psikosociale, ndërsa këshilla mjekësore ishin vënë në dispozicion dhe po operoheshin nga njësi komunale. Në kuptimin e kategorive të posaçme vulnerabël, fokusi i tyre primar ishte asistimi i njerëzve në disavantazh social, viktimave të dhunës në familje, prindërve të vetëm dhe personave me aftësi të kufizuara fizike, etj.

121 Intervistë me Hekuran Duka, Kryetari i Komunës së Dibrës, qershor 2020

122 Bujare Abazi, Kryetare e Komisionit të Mundësive të Barabarta, Komuna e Çairit, qershor 2020

123 Intervistë me Agron Beqiri, Komuna e Haraçinës, e zhvilluar në qershor 2020

124 UNWOMEN (2020) **Hartizimi i ndikimit të Kovid-19 mbi gjendjen socio-ekonomike të grave në nivelin lokal**

studimin u mbështetën tek koordinatorët e mundësive të barabarta për të sjellë masat e përgjigjes ndaj Kovid-19.¹²⁵ Në shtatë komunat ku u zhvillua hulumtimi për qëllimet e këtij studimi, vetëm në njërën komunë, më saktësisht, Karposhi, kishte përfshirë Koordinatorin e Mundësive të Barabarta në Task Forcën e Krizës. Gratë e tjera janë kontaktuar jashtë task forcës, posaçërisht në nivelin lokal, ku ishin drejtorë të kompanive që prodhonin dhe shpërndanin pajisje mbrojtëse mjekësore dhe dhuruan maska mbrojtëse për punonjësit e shërbimeve komunale, siç ishin kostume, xhaketa të hedhshme, kapela, këpucë, maska, etj.

Roli primar i grave në komunitet ishte ndërgjegjësimi brenda familjeve, këshillimi i tyre për të respektuar masat dhe rekomandimet e dhëna nga institucionet shëndetësore për luftimin e virusit.

Roli primar i grave në komunitet ishte ndërgjegjësimi brenda familjeve, këshillimi i tyre për të respektuar masat dhe rekomandimet e dhëna nga institucionet shëndetësore për luftimin e virusit. Komuna e Çairit, në bashkëpunim me dy mjeke femra, prodhuan video për t'i nxitur njerëzit t'i respektonin masat mbarëkombëtare. Këto video më vonë u publikuan në mediat kombëtare, veç shpërndarjes së tyre në ueb faqen zyrtare të komunës dhe në faqen zyrtare në mediat sociale të Kryetarit të Komunës.

Sido që të jetë, mbetet konkluzioni i të gjithë bashkëbiseduesve se *"gratë duhet të trajtohen me masat e posaçme, ndërsa nevojat e tyre të prioritizohen dhe të promovohen"*¹²⁶. Periudha mars-korrik demonstroi mungesën e qasjes gjinore në krijimin e politikave si në nivelin kombëtar, ashtu dhe në atë lokal, edhe përkundër asaj se gratë u përfshinë në poste të larta dhe në task forcat e menaxhimit të krizës.

Në Haraçinë, përveç Kryetares së Komunës, e cila është grua, janë katër gra në Këshillin Komunal, nga të cilat asnjëra nuk merr pjesë në punën e task forcës komunale të krizës. Në Çair, edhe pse asnjë grua nuk u inkuadrua në task forcën e prizës, disa gra morën pjesë aktive në hartimin e strategjisë së komunikimit, për t'u zgjatur tek qytetarët dhe transmetuan apelimet e njerëzve për t'u përshtatur me masat.

2.5. SHKALLA E LIKUIDITETIT TË BIZNESIT DHE SHKALLA E MBIJETESËS SË BIZNESEVE TË GRAVE

Gjatë muajit maj 2020, QHKP zhvilloi një sondazh onlajn, në të cilit u procesuan përgjigjet e 60 përfaqësuesve të kompanive maqedonase (sipërmarrës gra dhe burra). Pyetësi i sondazhit për vlerësimin e nevojave të kompanive për t'i bërë ballë më mirë situatës së shkaktuar nga Kovid-19 përmbante 34 pyetje, të strukturuar me 3 kapituj kryesorë që u ekzaminuan: A) informacionet e përgjithshme dhe demografike të të anketuarit dhe kompanisë; B) Vlerësimi i pasojave të Kovid-19; C) Nevoja për mbështetjen e domosdoshme të kompanive maqedonase. Sondazhi u zhvillua në platformën onlajn KoBoToolbox. Pjesëmarrja në sondazh ishte anonime. Më poshtë vijon analiza gjinore e rezultateve.


Kompanitë e drejtuara nga gra vlerësojnë ndikimin e krizave më pak negativisht sesa kompanitë e drejtuara nga burra. Pothuajse 90% të kompanive të anketuara besojnë se emergjenca e Kovid-19 ka ndikim negativ në bizneset dhe të ardhurat e tyre. Kompanitë e drejtuara nga gra janë prekur me më pak se 15%, krahasuar me kom-

¹²⁵ Ibid

¹²⁶ Intervistë me Hekuran Duka, Kryetari i Komunës së Dibrës, qershor 2020


panitë e drejtuara nga burra. Gjendja është aq e rëndë, saqë 33.3% të të anketuarve kanë deklaruar mbyllje të plotë si rezultat i krizës së shkaktuar nga Kovid-19. Shumica e kompanive ishin përpjekur të përshtaten me gjendjen e re; gjegjësisht, 51.7% nuk kishin ndërprerë plotësisht aktivitetin e tyre, dhe kanë futur në përdorim forma alternative të punës së biznesit, me përdorimin e mjeteve elektronike, pikërisht, porosi onlajn, dërgime me postë dhe në shtëpi, etj. Vetëm për 15% të bizneseve kriza nuk i kishte detyruar të pushonin biznesin.

Grafiku 15
Si ndikoi shfaqja e virusit COVID-19 në biznesin tuaj dhe në të ardhurat e biznesit tuaj?
Burimi: Sondazhi i QHKP me kompanitë për ndikimin e Kovid-19 dhe masat e përgjigjes, 2020




Bizneset e drejtuara nga gra më shpejt adaptohen ndaj krizës. Sondazhi i QHKP me kompanitë për ndikimin e Kovid-19 dhe masat e përgjigjes tregoi se bizneset e drejtuara nga gra, apo themelues të të cilave janë gra, apo ku gratë bëjnë pjesë të strukturës themeluese, shumë më shpejt u adaptuan ndaj kushteve të ndryshueshme ekonomike. Si rrjedhojë, 62.1% të kompanive të tilla nuk mbyllën bizneset e veta plotësisht si rezultat i krizës së shkaktuar nga virusi, por ato futën në përdorim forma të reja të punës, me përdorimin e mjeteve digjitale dhe distribuimin e mallrave tek konsumatorët, në krahasim me vetëm 41.9% të kompanive të drejtuara nga burra.

Grafiku 16
A duhej që biznesi juaj të mbyllej plotësisht në krizën e shkaktuar nga virusi?
Burimi: Sondazhi i QHKP me kompanitë për ndikimin e Kovid-19 dhe masat e përgjigjes, 2020



Bizneset e drejtuara nga gra janë më vulnerabël ndaj krizës. Pothuajse një e katërta e bizneseve (23.3% nga gjithsej të anketuarit) do të mbijetojnë edhe një muaj, nëse vazhdon gjendja e pafavorshme, ndonëse mbi një e treta e bizneseve do të mbijetojë edhe 2 apo 3 muaj. Në shumicën e kompanive të drejtuara nga gra, mbisundon mendimi se krizat e shkaktuara nga virusi mund të jenë fatale për biznesin. Përkatësisht, pothuajse 45% vlerësojnë se nëse vazhdon gjendja e virusit, bizneset e tyre nuk do të mbijetojnë për më tepër se 2 muaj, ndërsa vetëm 37.9% të tyre vlerësojnë se do të jenë në gjendje ta rezistojnë krizën në 3 deri 6 muajt e ardhshëm. Nëse vazhdon kjo gjendje, 17.2 % thonë se do të mund të mbijetojnë edhe një vit. Sa për krahasim, 29.0% të bizneseve të drejtuara nga burra vlerësojnë se mund të zgjasin edhe një vit, edhe nëse kriza vazhdon.

Grafiku 17
Sipas vlerësimit tuaj,
për sa kohë biznesi juaj
do të mbijetojë nëse
situata vazhdon?
Burimi: Sondazhi i QHKP me
kompanitë për ndikimin
e Kovid-19 dhe masat e
përgjigjes, 2020



Pothuajse gjysma e bizneseve të drejtuara nga gra (48.3%) druajnë se do të detyrohen t'i mbyllin bizneset e veta përgjithmonë. Si kundërshtim, 38.7% të këtij besimi është i pranishëm tek kompanitë e drejtuara nga burra. Strategjia e mbijetesës, për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve të tyre të biznesit, bazohet mbi reduktimin e kostove (68.3%), rritjen e likuiditetit duke huazuar nga bankat dhe institucionet e mikro-kredive (53.3), ndërsa një pjesë e konsiderueshme e kompanive mbështetet mbi kursimet dhe bilancet pozitive nga përpara (43.3%). Duke u orvatur me borxhet e tyre të cilëve u ka ardhur afati, kompanitë planifikojnë t'i shtyjnë pagesat për furnizuesit (30%). Kjo pae-vitueshëm do të ndikojë tërë ekonominë. Kjo siguri e pakësuar sigurisht se do të prekë konsumin dhe rritjen ekonomike në 6-12 muajt e ardhshëm dhe në fund, shumë biznese do të ndalen në rrezikun e mospërmbushjes së detyrimeve. Mbështetja aktuale e drejtpërdrejtë ekonomike për kompanitë u limitua kryesisht për periudhën prill-qershor 2020. Qeveria duhet të veprojë shpejt dhe të ofrojë vazhdimin e mbështetjes.

Bizneset e drejtuara nga gra kanë më pak besim se do të mund t'i tejkalojnë krizat në mënyrë të pavarur. Pothuajse 90% të kompanive të drejtuara nga gra (89.7%) thek-suan se nuk besojnë se do të mund t'i tejkalojnë krizat vetë, ndërsa vetëm 10.3% besojnë se bizneset e tyre do të mbijetojnë pa mbështetje plotësuese. Sa iu përket kompanive të drejtuara nga burra, përgjigjet në këtë pyetje tregojnë dallim më të madh, ku 83.9% kanë deklaruar se nuk besojnë se mund t'i tejkalojnë krizat, kurse 16.1% besojnë se do të jenë në gjendje t'i mbijetojnë krizat.

Në periudhën e ardhshme, kompanitë maqedonase do të përballen me tre sfidat më të rëndësishme: 1) kërkesat e pakësuara apo plotësisht të ndërprera të produkteve (për shkak të punimeve të kufizuara apo të ndërprera të proceseve të prodhimit), 2) mbledhja e pagesave dhe çështjet e likuiditetit, si dhe 3) lindja e shpenzimeve plotësuese, që nuk janë planifikuar. Veç kësaj, sipas biznesmenëve, shkurtimi i kapitalit të punës do të jetë një sfidë e konsiderueshme.

Masat ekonomike për t'iu përgjigjur ndikimit socio-ekonomik të virusit mbi qytetarët që u miratuan deri më tani po kategorizohen si: shtyrje dhe reduktime të taksave, mbështetje financiare për kompanitë dhe mbrojtje të likuiditetit, mbrojtje e standardit jetësor, likuiditet i buxhetit shtetëror, mbrojtje sociale, mbrojtje shëndetësore dhe mbrojtje e fëmijëve¹²⁷. Madhësia e mbështetjes deri në qershor 2020 është vlerësuar të jetë 550 milionë euro, apo 5-5.5% të PBB. Pjesa kryesore e mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për kompanitë dhe qytetarët ndahet përmes masave të mëposhtme:

- ▶ Subvencionimi i pagave të punonjësve në lartësi nga 14.500 denarë për punonjës për muajt prill, maj dhe qershor;
- ▶ Subvencionimi në shumë nga 50% të kontributeve sociale të punonjësve;
- ▶ Kredi pa interes apo me interes të ulët për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, përmes Bankës së Maqedonisë së Veriut për Zhvillim;
- ▶ Garanci për rrezikun e kredisë për bizneset start-up dhe për kompanitë e vogla dhe mikro;
- ▶ Mbështetja financiare për shtytjen e konkurrueshmërisë së kompanive për të pushtuar tregje të reja dhe për të modernizuar proceset;
- ▶ Mbështetja e zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve start-up përmes Fondit të Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik;
- ▶ Mbështetja financiare e bujqve;
- ▶ Me kartela pagimi "të brendshme" për qytetarët me të ardhura të ulëta, për ta rritur konsumin e brendshëm;
- ▶ Vauçerë "Shtëpia është shtëpi" për qytetarët, duke synuar turizmin e brendshëm dhe mbështetjen e sektorit të turizmit;
- ▶ Shkarkimi i taksave për detyrimet e tatimit mbi të ardhurat personale dhe të ardhurat e korporatës për muajt mars, prill dhe ma.

Në këtë kuptim, masat e Qeverisë vlerësohen si jo të mjaftueshme për të mbajtur punonjësit dhe për të mirëmbajtur likuiditetin. Shumica e të anketuarve (51.7%) thanë se do të shfrytëzojnë masën e subvencionimit të pagës minimale për t'i mbajtur punonjësit e vet, mirëpo 8% të kompanive që kanë thënë se nuk do ta shfrytëzojnë masën, do ta reduktonin numrin e punonjësve në periudhën e ardhshme. Vetëm 25% të kompanive të anketuara vlerësojnë masat si pozitive, ndërsa 31.7% të atyre që do t'i shfrytëzojnë masat, besojnë se masa nuk është mjaft e dobishme për mbajtjen e punonjësve.

¹²⁷ <https://koronavirus.gov.mk/merki/ekonomski-merki>


Analiza e zbatimit të masës për subvencionimin e pagave dëshmon një boshllëk gjinor. Gjegjësisht, nga 20 kompanitë që kanë pranuar mbështetjen më të lart nga Qeveria për të mbajtur punonjësit e tyre, vetëm 2 kompani po drejtohen nga gra.

Burimi: Infografiku i QHKP
për ndikimin e Covid-19 në
ekonominë




Për 50% të kompanive, mbështetja financiare për të cilën kanë nevojë për momentin, duhet të jetë në formën e bashkëfinancimit të pagave, shpenzimeve të qirasë, etj. Më se 18% konsiderojnë se një mbështetje financiare e njëhershme do të ishte e dobishme, dhe e njëjta përqindje si formë e mbështetjes për të cilën ata kanë nevojë është akses i lehtë në kredi më të favorshme. Vetëm 6.7% të kompanive, sa i përket mbështetjes financiare, besojnë se duhet patur mundësi për moratoriumin mbi shlyerjen e kredive tek institucionet financiare dhe të gjitha detyrimet ndaj Qeverisë. Në lidhje me nevojën për këshillim dhe mbështetje financiare, sipas të të anketuarve, kjo duhet qenë në drejtimin e mbështetjes së planifikimit të tyre të përgjithshëm afarist, futjes në biznesin elektronik, si dhe këshillimit financiar për ta tejkaluar situatën.

Grafiku 18
Për cilin lloj të mbështetjes financiare keni më së shumti nevojë tani?
Burimi: Sondazhi i QHKP me kompanitë për ndikimin e Covid-19 dhe masat e përgjigjes, 2020



Sa i përket asaj nëse masat për gjendjen e jashtëzakonshme duhet të ndërmerren nga institucionet publike relevante, për të ndihmuar kompanitë në ringjalljen e bizneseve të tyre, shumica e të anketuarve besojnë se kjo duhet të bëhet përmes: 1) pagimit të TVSH me mbledhjen (30%), kriteret e qarta dhe transparente për përzgjedhjen e shfrytëzuesve për të marrë incentiva në bazë të asistencës ndërkombëtare për Maqedoninë e Veriut (30%), si dhe lehtësimi i taksave (21.6%).

Grafiku 19
Cilat masa të sigurisë
mendoni se duhet t'i
ndërmarrin institucionet
relevante për të
ndihmuar ringjalljen e
bizneseve?
Burimi: Sondazhi i QHKP
me kompanitë për ndikimin
e Kovid-19 dhe masat e
përgjigjes, 2020



2.6. PËRFSHIRJA SOCIALE DHE DISKRIMINIMI

Kovid-19 nuk bën diskriminim, e nuk duhet të bëjë as përgjigja, nëse e ka ndërmend të arrijë sukses.¹²⁸ Ndërkaq, në kohën e pandemisë së Kovid-19, izolimi, vetmia dhe padrejtësitë sociale janë në rritje. Duke prekur të gjithë segmentet e popullsisë, përgjigja ndaj shpërthimit të virusit është posaçërisht dëmtoese për anëtarët e atyre grupeve sociale në gjendje më vulnerabël, pra personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat. Me pasjen e burimeve më të pakta financiare dhe me të jetuarit në lokacioni më të dendura me popullsi, këto kategori joproporcionalisht bartin rreziqe më të larta për shëndetin dhe ekonominë, sesa të tjerët.

Përderisa profili i viktimave ndryshon nga vendi në vend, kjo duket sikur është modeli më i zakonshëm në aktet diskriminuese që shfaqet gjatë pandemisë: më shpesh sesa jo, synimi është kryesisht "tjetri", gjegjësisht, i huaji, dikush që i takon një pakice etnike apo kulturore, etj.¹²⁹ Gjithashtu, trendët e stigmatizimit të të prekurve nga virusi dhe përjashtimi social i tyre madje edhe pasi janë shëruar po ngulin këmbë, kështu që nevojiten veprime për të rritur solidaritetin dhe për të kontribuar për ndryshimin e qëndrimeve të njerëzve ndaj atyre që janë prekur, që janë në rrezik diskriminimi në kontekstin specifik.

Të moshuarit, e në veçanti ata me sëmundje kronike, siç është hipertensioni, sëmundja kardiovaskulare dhe diabeti, jo vetëm se po luftojnë me rreziqet më të mëdha për shëndetin, por ato kanë më pak gjasa të jenë në gjendje të kujdesen për veten në izolim. Edhe pse nevojitet distancimi social për të frenuar shpërhapjen e sëmundjes, Qeveria me masën e vet për kufizimin e lëvizjes për grupmoshën mbi 65 vjeç ka kontribuar për ndjesinë e të qenit i diskriminuar, që u shfaq tek ky grup. Sido që të jetë, diskriminimi me bazë moshën nuk u manifestua në dhënien e shërbimeve, edhe u ofrua plotësisht trajtimi i të moshuarve dhe ata nuk u perceptuan sikur të kenë më pak vlerë sesa të rinjtë, por u synuan plotësisht nga shërbimet e patronazhit në nivelin

128 <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25730>

129 <https://en.unesco.org/news/Kovid-19-related-discrimination-and-stigma-global-phenomenon>

lokal, ku u ofrua mbështetja në disa komuna, gjegjësisht, në Koçan, Shën Nikollë¹³⁰ dhe Dellçevë dhe Qendër¹³¹. Personat me aftësi të kufizuara u ndihmuan nga asistentët e tyre personalë, apo nga anëtarët e familjes në rutinat e tyre ditore. Gjatë izolimit në shtëpi, asistentët personalë nuk ndoqën protokollet e posaçme, që nxiti frikë, si në mesin e pranuesve dhe asistentëve për infektim dhe transmetim të mundshëm, që rezultoi me intensitetin e reduktuar të kujdesit. Vetë-kujdesi individual i përgjithshëm dhe çrregullimi i shërbimeve dhe mbështetjes krijuan sfida për personat me aftësi të kufizuara.

Gjithë të moshuarit e intervistuar, në mënyrë unanime e për qëllimet e këtij studimi, vërtetuan se do të ndiqnin dhe do të respektonin të gjitha masat paraprake për të shmangur infektimin, duke iu bindur rekomandimeve për të mbrojtur nga virusi të moshuarit që po orvaten me sfidat financiare. Sidomos gratë e pensionuara të cilat u intervistuan, shënuan një barrë të konsiderueshme me blerjen e dezinfektuesve dhe produkteve higjienike. Kjo sqarohet me faktin se gratë tradicionalisht marrin vende pune që janë më pak të paguara dhe kështu, pensionet e tyre janë më të ulëta se ato të burrave. Gratë e moshuara gjithashtu shënuan lëkundjen e çmimeve të tregut, sidomos për maskat mbrojtëse. Gratë dhe burrat romë gjithashtu janë përballur me barrë financiare për blerjen e dezinfektuesve dhe produkteve higjienike. Të jesh më pak i arsimuar dhe të jesh i punësuar në punë intensive, mirëpo në vende pune që janë paguar shumë pak e që kanë reduktuar orarin e punës dhe kështu, kanë reduktuar pagimin e pagave, e mbi të gjitha, kërkesat e reja për mbajtjen e sigurisë nga virusi ishin posaçërisht problematike. Për gratë rome, të cilat janë ose mbeten pa punë për shkak të pandemisë, vazhduan të varen nga mbështetja financiare e të afërmeve të tyre, prindërit apo gjyshit dhe gjyshet e tyre. Më joproportionalisht të prekur ishin romët, pa akses në ujë të pijshëm, duke jetuar në lagje të varfra dhe në zona me popullsi të dendur. Për shkak të këtyre faktorëve, një numër shumë i lart i të intervistuarve nga komuniteti rom, dëshmuar se janë testuar për Kovid-19, pasi sondazhet epidemiologjike ishin të ndjeshme ndaj këtyre rrethanave.

Për shkak të periudhës tepër të shkurtër kohore, kur gratë dhe burrat e moshuar u lejuan të lëviznin, tregjet ishin të ngjeshura dhe bërja e pazarit ishte jashtëzakonisht sfiduese për personat në moshë. Disa nga të intervistuarit, sidomos ata me sëmundje kronike, paraqitën faktin se ishin të furnizuar (me ushqime dhe medikamente) nga anëtarët e familjeve të tyre, dhe në disa raste nga OSHC që janë angazhuar nga komunat për t'i dhënë asistencë grupeve vulnerabël. Sipas nevojës, ata zakonisht konsultoheshin me mjekët e tyre amë me telefon, për të lëshuar receta elektronike. Ky formular elektronik drejtpërsëdrejti dërgohej në regjistrin dixhital, e kështu personat e moshuar mund të merrnin medikamentet e tyre në cilëndo farmaci afër shtëpive të tyre. Ata konsideruan këtë masë posaçërisht efektive, sepse ajo i parandalonte nga shkuarja dhe hyrja në ambulancet / spitalet. Nga ana tjetër, romët raportuan blerjen e medikamenteve më të lira se ato të recetës së mjekut, për shkak të gjendjes së keqësuar financiare. Shërbimet

130 UNWOMEN (2020) **Hartizimi i ndikimit të Kovid-19 mbi gjendjen socio-ekonomike të grave në nivelin lokal**

131 Intervista me të moshuar, maj 2020

**Jeta e përditshme
e të moshuarve
ishite ndryshuar
konsiderueshëm,
mirëpo preku gratë
ndryshe nga burrat.**

e tjera mjekësore kryesisht ishin në dispozicionin e tyre, edhe pse disa këqyrje tek mjeku janë bërë “nga dritarja”. Aksesit në shërbimet dentiste dhe gjinekologjike ishin reduktuar. Si problem sfiduesi u përmend “mosfunksionimi i qendrës së thirrjeve për mbështetje psikologjike, edhe përkundër një fushate intensive që po shtjellohej në atë periudhë për këtë shërbim”. Disa nga të anketuarit thanë se ata vetë kishin anuluar këqyrjet e tyre tek mjeku për shkak të rrezikut nga Kovid-19.

Jeta e përditshme e të moshuarve ishte ndryshuar konsiderueshëm, mirëpo preku gratë ndryshe nga burrat. Pastrimi i shpeshtë dhe mirëmbajtja e higjienës në shtëpi ishte një barrë plotësuese për gratë e moshuara, ndërsa burrat e intervistuar kryesisht konsideronin kufizimin dhe lëvizjes dhe shoqërimin si pengesë. *“Për gratë, gjithçka është më e vështirë. Së pari, bërja e pazarit, e së dyti, mbajtja e higjienës vetjake dhe të tjerëve, sepse unë jam gjyshe, dhe i kushtoj më tepër vëmendje nipit tim më të vogël, e kjo praktikisht kërkon më tepër punë”*¹³². Të intervistuesit më të moshuar në këtë studim treguan se kontakti i reduktuar social kishte rritur vetminë e tyre dhe kishte reduktuar mirëqenien e tyre, krahasuar me kohën para pandemisë. Mungesa e mbledhjeve shoqërore me familjet dhe miqtë, së bashku me izolimi, ishte veçanërisht sfiduese për ata. *“Shoqërimi im ka vuajtur pafundësisht, dhe u limitua në biseda telefonike me familjarët, dhe në disa raste, përmes video thirrjeve Viber”*¹³³. Sipas dëshmitave të tyre, vetmia është njëri nga përfundimet kryesore që kanë prekur shëndetin e tyre mendor. Ata presin rimëkëmbjen e plotë të gjendjes, që të mund të rimarrin jetën e tyre shoqërore deri në një shkallë të caktuar. Personat me aftësi të kufizuara (me aftësi të kufizuara në shikim dhe dëgjim, si dhe personat me aftësi të kufizuara fizike), gjithashtu raportuan nivel të lart të izolimit shoqëror, krahasuar me qytetarët e tyre të intervistuar, që janë me zhvillim tipik. Ata mirëpritën vendimin për lejimin e personave me aftësi të kufizuara të dilnin për shëtitje gjatë izolimit në shtëpi, mirëpo një pjesë e tyre kishin aplikuar strategji tjera të përballimit. Për shembull, disa nga të intervistuarit, të cilët po orvaten me shikim të dëmtuar, kishin filluar të praktikonin joga, si mënyrë e mirëmbajtjes së gjendjes së tyre fizike.

Përrjashtimi social në bazë të moshës, si dhe përkatësia fetare u dalluan nga gratë e moshuara. Fakti se autoritetet shëndetësore kishin imponuar karantinë të gjatë për Festat e Pashkëve, që nuk i lejoji ata të shkonin në meshën e Pashkëve, ndërseu ndjenja diskriminimi kundrejt ndjekësve të Islamit, të cilët, sipas të intervistuarve, nuk u mbajtën në karantina të gjata gjatë Bajramit të Ramazanit, pasi mediat raportuan shkelje të shumta të orës policore. Për romët, veçanërisht diskriminues ishte fakti se mësimnxënja elektronike për fëmijët e tyre të moshës shkollore nuk ishte adaptuar me resurset dhe njohuritë që ata kishin për t'i mbështetur ata. Kritika për mësimnxënien elektronik vjen kryesisht nga prindërit romë në kryeqytet, ndërsa shprehen vlerësime pozitive nga ata në brendësinë e vendit. U vërejt edhe stigmatizimi i popullsisë romë gjatë pandemisë, në shërbimet bankare; sjellja e pakëndshme e portierëve / zyrtarëve të sigurimit, etj. Një i anketuar burrë nga Shkupi madje njohu këtë stigmatizim si rezultat i perceptimit mbizotërues se romët janë “përhapës” të virusit. Disa nga të anketuarit

132 Intervistë me një grua të moshuar, maj 2020

133 Intervistë me një burrë të moshuar, maj 2020

**Стигматизацијата
на ромското
население за време
на пандемијата
се забележува,
исто така, и за
банкарските услуги**

po ashtu ndjenë se komuniteti rom ishte neglizhuar për sa iu përket masave të luftimit të Kovid-19. *"Nuk na u dha një shans, nuk ka përgjigje nga Komuna e Çairit në lidhje me nevojën tonë financiare. Do kisha thënë se ata nuk janë përgjegjës fare, jo vetëm për romët, por për të gjithë"*¹³⁴. Rreziku nga infektimi me Kovid-19 për personat me aftësi të kufizuara është përbërë nga çështje të tjera, të cilat urdhërojnë veprim të posaçëm: nga të qenit i përjashtuar nga informacionet shëndetësore dhe integrimi në dhënie e shërbimeve shëndetësore, të jetuarit në një botë ku aksesueshmëria është shpesh e limituar dhe ku barrierat drejt mallrave dhe shërbimeve janë sfidë, dhe me më tepër gjasa të të jetuarit joproporcionalisht në ambiente institucionale. Në varësi nga llojet e aftësive të kufizuara, njerëzit me aftësi të kufizuara ishin përballur me barriera, sfida dhe probleme të ndryshme. Për ilustrim, njerëzit me dëgjim të dëmtuar kanë përjetuar sfida komunikimi, pasi maskat nuk kishin qenë përfshirëse (me dritare të tejdukshme); që kishte rezultuar me vështirësi në të kuptuarit e stafit të shitjes gjatë bërjes së pazarit. Në rastin e personave me shikim të dëmtuar, veshja e dorezave kishte qenë e vështirë, sepse kjo kishte kufizuar ndjeshmërinë e tyre të prekjës, që është vendimtare që ata të lëvizin dhe të bëjnë rutinën e tyre ditore. Në fund, personat me aftësi të kufizuar fizike, ishin përballur me problemin e vjetër të infrastrukturës së keqe rrugore dhe automjetet e parkuara në trotuare. Kjo kishte qenë edhe më e vërejtshme, krahasuar me periudhën përpara shpërthimit të Kovid-19, duke patur parasysh se lëvizja ishte limituar dhe njerëzit nuk kishin qenë në rrugë për t'i ndihmuar ata. Prandaj, shumica e këtyre personave me aftësi të kufizuar fizike ishin mbështetur tek anëtarët e familjeve të tyre, apo tek asistentët personalë. Përveç infrastrukturës së keqe, për personat me aftësi të kufizuara dhe pengesat gjatë lëvizjes me karrocën e invalidëve, për ata që po përballen me dëgjim të dëmtuar, pamundësia e nxjerrjes së parave të gatshme nga bankomatet (ATM), për shkak të mungesës së opsionit të zërit të integruar dhe sistemit, e kjo paraqiste një problem serioz. Ata nënvizuan ndërjegjësimin e përmirësuar të publikut të gjerë për gjendjen e tyre, duke dhënë shembuj siç janë dhënia e përparësisë në radhët në bankë dhe dyqan. Njerëzit rural, si gratë, ashtu dhe burrat, ndjeheshin të diskriminuar në një nivel tjetër. *"Ndjehem paksa e diskriminuar, sepse nuk gëzojm të drejtat e njëjta si njerëzit e qytetit, gjegjësisht, dezinfektimi i vazhdueshëm dhe të gjitha masat e mbrojtjes po bëheshin në qytetet, ndërsa asgjë e ngjashme nuk ndodhte në fshatrat. Gjithashtu, shitjet onlajn dhe dërgesat e produkteve funksiononin patëmeta në qytet, mirëpo në katundet, ky shërbim nuk ishte në dispozicion, për shkak të kostove më të larta, frikës, e kështu me radhë "*¹³⁵

134 Intervistë me një grua rome nga Shkupi, maj 2020

135 Intervistë me një grua rurale, maj 2020

Kreu

3

BOSHLLËQET GJINORE TË SHKAKTUARA NGA PËRGJIGJA NDAJ KOVID-19

Pandemia kishte potencialin për të transformuar marrëdhëniet gjinore dhe jetën familjare përgjithmonë.



3.1. LIDHJET GJINORE BRENDA FAMILJES PAS KOVID-19

Pandemia kishte potencialin për të transformuar marrëdhëniet gjinore dhe jetën familjare përgjithmonë. Me shpërhapjen e shpejt të pandemisë së Koronavirusit, shumë pabarazi gjinore tanimë u intensifikuan pasi normat ekzistuese diskriminuese dhe të dëmshme po vazhdojnë, madje dhe po keqësohen në ballin e ndryshimit, siç është rritja e punës së papaguar kujdestare për gratë në shtëpi, dhuna ndaj grave, boshllëku gjinor për pagim, duke ditur se gratë vuajnë më së shumti nga pezullimi i punëve, varësia ekonomike me format e reja të punës, ku gratë gjithnjë e më pak marrin pjesë në STEM, shkalla e punësimit të grave është në rrezik. Ndonëse fëmijët janë në shtëpi, punësimi i ndihmësës për punët e shtëpisë për të mënjeluar grindje të mëtejshme nuk është një opsion të cilin çdo familje mund t'ia lejojë vetës. Ato që punojnë nga shtëpia me orar të plotë, punojnë aq gjatë, saqë nuk iu mbetet kohë për t'i mbështetur fëmijët e tyre si edukatore, sidomos pasi koncepti i mësimnxënies në distancë parashikon një rol më të madh për prindërit si organizatorë të shkollimit, që nënkupton marrjen e barrës plotësuese të sqarimit të përmbajtjeve edukative dhe kontrollimit të rezultateve arsimore¹³⁶. Disa prindër jo vetëm se nuk u del koha, por ato kanë dhe mungesë të njohurive dhe shkathësive se si ta bëjnë këtë. Një faktor plotësues që do të formojë marrëdhëniet familjare në periudhën e Kovid-19, është aksesimi në internet dhe pasja e kompjuterëve të mjaftueshëm për të gjithë anëtarët e familjes, sepse edhe puna edhe shkolla kryhen onlajn. Veç kësaj, izolimi në shtëpi, sidomos nëse është i imponuar për grupmosha të caktuara (të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, etj.) ndërson ndjesinë e diskriminimit. Në mënyra të pasigurta, që nga izolimi në shtëpi dhe karantina, jeta çoi drejt ndërveprimit të afërt dhe të vazhdueshëm me anëtarët e familjes. Ky ndërveprim ose përforcon lidhjen midis anëtarëve të familjes, ose krijon barrë plotësuese emocionale midis tyre. Të gjitha këto shkaktojnë "sasi të mëdha të frustrimit" brenda familjes.



Filluam t'i binim në qafë njëri tjetrit, ne nuk jemi
mësuar të kalojmë aq shumë kohë së bashku,
brenda shtëpisë.

Gjendja ishte stresuese për të gjithë, por në veçanti për popullsinë urbane që e kishte patjetër të qëndronte në shtëpi, në apartamentet e tyre të vogla, për dallim nga popullsia rurale, që ishin më të lirë, sepse kufizimi i lëvizjes nuk iu përgjigjej atyre, duke i lejuar të punonin në fushat. *"Ishte stresuese për ne kur pamë në TV se si po shtohet numri i të vdekurve, i të infektuarve, dhe u përpoqëm të tejkalonim këtë duke kaluar kohën tonë në oborr, në fshat, në fushat"*.¹³⁷ Sipas dëshmimeve të të intervistuarve, mesazhi "qëndroni në shtëpi" i bëri të gjithë të kalojnë kohë së bashku më tepër sesa pritnin, apo madje sesa dëshironin. *"Shprehitë tona kanë ndryshuar. Kafë më vonë në*

136 Intervistë me një burrë rural, maj 2020

137 Intervistë me një nënë me aftësi të kufizuara, maj 2020

*mëngjes, bërja e pazarit me një ritëm të përsheptuar, dhe përkushtimi i shtuar ndaj fëmijëve tanë dhe mësimxënies së tyre*¹³⁸. Shumica e të intervistuarve u ndikuan pozitivisht, ata përqaftuan këtë kohë si mundësi për të kaluar së bashku një kohë kualitative familjare dhe u lidhën konsiderueshëm më tepër sesa më herët. *"Fillova ta vlerësoja kohën e kaluar me prindërit e mi, sidomos me vëllain tim më të vogël, për ta kuptuar se ç'po bën ai – ai po regjistron video për YouTube"*¹³⁹.

Megjithatë, distancimi shoqëror ishte sfidues për të gjithë ata, sepse ai rezultoi me izolimin nga familjarët dhe miqtë për një periudhë të gjatë kohore. *"Ishte shumë depresive dhe e vështirë për ta duruar, sidomos gjatë karantinës përgjatë fundjavave. Po kalonim kohë në internet, shikuam televizorin... U bëmë më të durueshëm"*¹⁴⁰. Lindën çështje siç janë depresioni dhe ftohja. Mirëpo, shërbimet në këtë kuptim u ofruan në sasi të limituar. Ministria e Shëndetit lëshoi rekomandime për shëndetin mendor, mirëpo nuk u zhvillua, e as nuk u zbatua asnjë masë specifike për të adresuar këto nevoja, as përmes shëndetësisë primare apo dytësore, e as përmes psikologët e shkollave për fëmijët në moshë shkollore. *"Dy muaj kaluan që kur kemi parë familjarët nga familja më e gjerë, na mungonin dhe e kishim të vështirë me këtë gjendje, sepse jemi shumë të lidhur mes vete. Prindërit e mi jetojnë në qytet, vëllai dhe kunata ime gjithashtu, ndërkaq, asnjëri nga ne nuk ishte në mundësi të vinte dhe të më shihte për dy muaj"*¹⁴¹.



Në rastin tonë, ishte e kundërta. Kaluam kohën kryesisht të ndarë, për shkak të orës policore. Fëmijët dhe burri im po kujdeseshin për dhentë në Probishtip, e unë isha përgjegjëse për prodhimin shtëpiak të qumështit dhe djathit në Gostivar.

Nga ana tjetër, izolimi në shtëpi kishte ndikim negativ mbi burrat dhe gratë rurale dhe kryesisht mbi personat me aftësi të kufizuara. Popullsitë rurale raportuan tendosje të rritur në shtëpitë e tyre dhe madje kishin përjetuar depresion, parimisht për shkak të ngecjes në prodhimtarinë e tyre, ndërsa personat me aftësi të kufizuara duhej të ndaheshin me anëtarët e familjes, për t'u mbrojtur gjatë pandemisë. *"Burri im fle në një dhomë tjetër, sepse ai është në rrezik më të lart të infektohet. Bëjmë shëtitje të vetëm, atëherë kurë është e mundur. Familja është gjëja më e rëndësishme. Ne mund t'i mbështetemi vetëm vetes dhe kapaciteteve tona vetjake. Duhet të jemi të kujdesshëm, sepse virusi jo vetëm që na prek ne, por ai prek dhe rrethin tonë"*¹⁴².

138 Intervistë me një grua të re rome, maj 2020

139 Intervistë me një grua me aftësi të kufizuar, maj 2020

140 Intervistë me një grua rurale, maj 2020

141 Intervistë me një grua, e martuar me një burrë me aftësi të kufizuar, maj 2020

142 Intervistë me Atina Murgasanska, LSDM, Kryetare e Këshillit Komunal në Kumanovë, qershor 2020

3.2. GJINIA DHE ARDHMËRIA E PUNËS PAS KOVID-19

“Një pjesë e punonjësve u caktua të punonin nga shtëpia, e disa rrotullonin për ditë.”¹⁴³
Gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara në disa raste u liruan nga puna, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore dhe fizike, dhe iu dha mundësia për të punuar nga shtëpia. Pandemia Kovid-19 dramatikisht ndryshoi mënyrën e jetesës dhe punës së njerëzve. Puna me gjysmë orari, puna me ndërrime, puna me telefon, puna në internet dhe nga shtëpia janë format që iu imponuan menjëherë punonjësve me fillimin e krizave. Shumë zyra, kompani dhe institucione filluan ta transformonin organizimin e tyre. Në këtë mënyrë u adresua kërkesa e vjetër e organizatave të grave shumëvjeçare për t’i mundësuar punonjësit që më mirë t’i kombinojnë vendet e tyre të punës me përgjegjësitë e kujdesit, duke mundësuar punën me telefon dhe punën nga shtëpia. Sigurisht se kjo nuk është e mundur për të gjitha vendet e punës, mirëpo të paktën disa nga punët në cilëndo kompani mund të bëheshin nga shtëpia.

Në të shumtën e institucioneve të sektorit publik, për fat të keq, puna nga shtëpia u interpretua si çlirim nga përgjegjësitë e punës, pasi nuk kishte procedura për ta menaxhuar procesin e punës nga shtëpia, kontrollin dhe llogaridhënien e punonjësve. Në sektorin privat, ku puna nga shtëpia ndodhi për herë të parë, punonjësit u përballën me sfida në organizimin e situatës së tyre shtëpiake, për të krijuar vendin e duhur dhe kohën për ta kryer punën me efektshmëri. Mbështetja e këtyre punonjësve se si të mësojnë të riorganizohen, nuk u ofrua. Kjo shkallë e rritur e frustrimit dhe pakënaqësisë me cilësinë e jetesës, në veçanti në mesin e grave. *“Në normalitetin e ri unë punoj nga herët në mëngjes e deri vonë natën, me ndalesa për të gatuar, pastruar, për të ushqyer familje, për të dezinfektuar, pastaj pranoj edhe disa e-posta pas orës 9 dhe puna ime vazhdon derisa të rraskapitem nga lodhja. Puna onlajn më shkaktoi kokëdhembje, të përziera dhe ndjesinë e të qenit të shterur. Më nuk ka një vijë të qartë se kur ndalon puna ime dhe kur fillon jeta ime familjare. Duhet të rishikohet balancimi i punës dhe jetës”¹⁴⁴*. Përderisa ky “normalitet i ri” i punës ndikon të gjithë ne, punonjësit me përgjegjësi të kujdesit janë prekur joproporcionalisht, *e në veçanti gratë, pasi ato përfaqësojnë shumicën e gjerë të individëve që akoma marrin mbi vete barrën kryesore kur bie fjala për përgjegjësitë* ndaj fëmijëve, prindërve apo familjarëve të moshuar. Prandaj, Sektori i Çështjeve Gjinore dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë OSBE-së ndau disa rekomandime për punëdhënësit.¹⁴⁵

Këto mënyra të reja të punës ndryshojnë marrëdhëniet standarde midis punonjësit dhe punëdhënësit në forma jokonvencionale të punës, që nuk varet nga prezenca fizike e punonjësit në vendin e punës së tij/saj.¹⁴⁶ Format jostandarde të punës nuk janë rregulluar, që rrit pasigurinë para së gjithash, tek punonjësit, për shkak të mung-

¹⁴³ Intervistë me një nënë e dy punonjësve në sektorin privat, maj 2020

¹⁴⁴ OSBE (2020) Puna në Distancë: Këshilla të Ndjeshme Gjinore për Menaxherë, e disponueshme onlajn: <https://jobs.osce.org/resources/document/infographics-remote-working-gender-sensitive-tips-managers?fbclid=IwAR11EHwpLTpDvyC9LMkctJ-QQL1wfZwp0--8ytMqb9sjs0h1n229YZusw>

¹⁴⁵ Eurofound (2015), Format e reja të punësimit, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg, faqja 4

¹⁴⁶ Organizata Ndërkombëtare e Punës, Puna në të ardhmen, iniciativat qindvjeçare të ONP, 3, Seria e shënimeve informative, fq. 4

esës së kushteve adekuate apo të rregulluara të punës, si dhe për shkak të të drejtave të ndrydhura për mbrojtje sociale dhe shëndetësore.¹⁴⁷ Kontrata tradicionale e punësimit dhe Ligji i Punës që rregullon atë, nuk parashikon punë me telefon. Sipas firmës konsultuese *Global Workplace Analytics* dy vjet nga tani, do të bëhet e mundur që deri 30 përqind të punonjësve të punojnë nga shtëpia për disa ditë të javës. Sipas Ligjit të Punës, kompania duhet të përcaktojë orarin e punës dhe të aplikojë regjistrimin elektronik të punonjësve. Rrethanat e reja kërkojnë ndryshimin e legjisllacionit, me të cilin do të parashikohet futja në përdorim të një sistemi elektronik të evidentimit të punonjësve që do të punojnë nga shtëpia, mbajtja e evidencës për orët e punës dhe lehtësimi i kompanisë për të përgatitur një renditje për punë nga shtëpia. Edhe nevojat për shëndetin mendor dhe fizik të punonjësve ndryshuan, pasi ata vuajnë nga dërrmimi më shpejt se cilado kategori e punonjësit. Ndërkaq, punëdhënësit duhet të ofrojnë mundësi plotësuese të rekreacionit dhe argëtimit, që janë siguruar nga Kovid-19, në mënyrë që punonjësit të përmirësojnë mirëqenien e tyre, të menaxhojnë stresin dhe të balancojnë punën dhe jetën. Virusi do ta reduktojë numrin e vendeve të punës për të cilat punonjësit janë të punësuar në bazë të kontratave për orar të plotë pune, dhe trendët për rënien e punës me gjysmë orari pune që janë shënuar në 2017 dhe 2016, pritet të ndryshojë në vitin.¹⁴⁸ Duke marrë në konsideratë se gratë ishin më të shumta në grupin e punonjësve të cilëve u janë pezulluar vendet e punës, ato më tepër do të preken me format e reja të punës që do të lindin. Ata do të kërkojnë punë në platforma onlajn, e kështu Qeveria do të duhet të zhvillojë politika për të nxitur shkathhtësi dixhitale, programe ri-trajnimi për vende të reja pune dixhitale, të cilat do të lindin, dhe do të duhet të ri-mendojnë mbrojtjen sociale dhe të drejtat e punëtorit për të siguruar adresimin me internet të nevojave të tyre të veçanta që dalin nga roli gjinor të punonjësit, kujdestarit, mësuesit, bukëfituesit, pastruesit. *“Do të rritet puna onlajn, por jo e tëra do të jetë me cilësi të mirë dhe me mbrojtje të mjaftueshme, sidomos jo në kohëra shoku,”* tha Anna Thomas, drejtore e Institutit për të Ardhmen e Punës. Qeveria gjermane tanimë po harton kuadër të ri ligjor për marrëdhëniet e punës, duke iu adaptuar normalitetit të ri që lindi për shkak të virusit¹⁴⁹.

Kriza e Koronavirusit ka ndarë punonjësit në dy klasa: ata që mund të punojnë nga shtëpia, dhe ata që janë të detyruar për t'u rrezikuar me infektim


Kriza e Koronavirusit ka ndarë punonjësit në dy klasa: ata që mund të punojnë nga shtëpia, dhe ata që janë të detyruar për t'u rrezikuar me infektim. Ndërkaq, mundësia e punës nga shtëpia u shpërnda jo njëjloj, ku punonjësit me paga më të larta kanë gjasa më të mëdha për të përfituar, ndërsa punonjësit me paga më të ulëta duhej të paraqiteshin në punë. Shumë grupe vulnerabël përjetuan të ardhura të reduktuara, mosrespektim të masave të mbrojtjes në vendet e tyre të punës, si dhe zgjatja e orëve të punës. *“Nuk ka distancë të mjaftueshme mes punonjësve, dhe ata nuk mbajnë maska mbrojtëse. Për momentin, ata punojnë me orar të plotë, madje dhe në ndërrimin*

147 Për format e reja të punës në Maqedoninë e Veriut, referohuni në QHKP (2018) Përshtatja e marrëdhënieve industriale ndaj formave të reja të punës, të disponueshme onlajn: <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/EN-Prilagoduwanje-na-industriskite-odnosi-kon-novite-oblici-na-vrabortuwanje-5-FINAL-OK.pdf>

148 <https://www.spiegel.de/politik/deutschland/heil-plant-bis-herbst-gesetz-fuer-recht-auf-homeoffice-a-06af277e-75f4-4a59-8963-0070d6c507bb>

149 Intervistë me një zyrtar të lart në Institutin e Shëndetit Publik, maj 2020

e natës". Gratë dhe burrat në pararojën e luftës kundër Covid-19 janë përballur me presion pa precedent, sidomos në sektorin e shëndetësisë. Një pjesë e konsiderueshme e këtij lloji të punonjësve nuk mund të punonin në distancë. Ata raportuan përjetimin e nënshtrimit maksimal ndaj virusit, pasi puna e tyre kërkon kontakt me njerëz të tjerë. Ata punuan jashtë orarit të punës, bënë ndërrime 24 orë dhe raportuan se jeta e tyre private ishte pakësuar. Sasia e punës në pararoje me të cilën u ballafaquan në bazë ditore ishte dërmuese. "Unë, në esencë, nuk kam jetë private. Më së voni deri në ora 08:00 të mëngjesit, arrij në vendin e punës, ku punoj me diagnozën e Covid-19 deri natën vonë. Dita ime e punës është më e gjatë se dymbëdhjetë orë. Orari im i punës zakonisht përfundon në ora 11-12 të natës, edhe pse 2-3 ditë mbaruam punën më herët, rreth orës 8 të natës."¹⁵⁰ Pa inspektim të zmadhuar dhe të përshtatshëm, gjendja e jashtëzakonshme duket si periudhë ideale për eksploatim në punë.



Nuk kishte nevojë për punë tërë ditën, dhe u ndamë në ekipe, për të qenë më efikas. Ndërrime 24 orë, dy ditë radhazi pushim, dhe dy javë me thirrje. Ekzaminonim pacientët çdo ditë. – Pulmolog

Shkoj në punë rreth orës 6:45 të mëngjesit, dhe orari im i punës mbaron rreth orës 4 pasdite. Jam gjithashtu në dispozicion për informacione plotësuese pas orarit të punës. – Farmacist

Së pari, punonim me gjysmë orari, pastaj punonim deri në ora 3 pasdite, një orë përpara orës policore. Nuk punoja në ndërrime nate, ndërsa disa farmaci nga e tërë Maqedonia e Veriut punonin me ndërrime të tilla. – Farmacist

Ora policore ishte një vend plotësues pune, përskaj orarit tonë normal të punës. Ndalnim dhe legjitimonim çdo të tretin drejtues të automjetit, tani legjitimojmë çdo të pestin, për ta reduktuar kontaktin fizik – Zyrtar i Policisë.

Orari i punës është riorganizuar plotësisht. Ne jemi kujdestarë për dy javë (24 orë, pastaj dy ditë të lirë), një javë jemi të lirë, dhe një javë jam me thirrje. – Kardiolog

Të papunësuarit nuk ishin në gjendje të gjenin punë gjatë krizës, që la shumë familje me një anëtar për të gjeneruar të ardhurat. "Vetëm babai im punon për momentin. Ai punon në industrinë e saldimit, dhe paga e tij u zvogëlua për shkak të regjimit të punës me gjysmë orari"¹⁵¹. Në disa sektorë, vëllimi i punës është rritur, por jo dhe orari i punës. "Orari i punës për punonjësit nuk u rrit, por ekipi i menaxhimit punonte jashtë orarit. Konversioni i prodhimit ishte përzgjedhja jonë, sepse donim të kontribuonim për tejkalimin e çështjes së mungesës së maskave mbrojtëse".¹⁵²

¹⁵⁰ Intervistë me një vajzë rome, maj 2020

¹⁵¹ Intervistë me një pronar të fabrikës së tekstit, maj 2020

¹⁵² Intervistë me një burrë të ri rom, maj 2020

Dhembshuria ndaj barrës së pushimeve të normalitetit të ri në ekuilibrin e jetës me përgjegjësitë e punës, besimi se punonjësit e tyre janë të aftë dhe të gatshëm për të kryer një punë të mirë nga shtëpia pa praninë kontrolluese të shefave të tyre dhe rregullat e reja të punës që inkuadrojnë marrëdhëniet e reja industriale, në të cilat proletariati digjital do të pranojë mbështetje sociale dhe shëndetësore sipas nevojave dhe interesave të tyre, janë disa nga çështjet në listën e gjërave për t'i bërë Qeveria e Maqedonisë së Veriut në periudhën e emergjencës post-Kovid.

3.3. GJINIA DHE SHOQËRIA PAS KOVID-19

Jeta shoqërore u çrregullua për shkak të “izolimit në shtëpi” dhe ndryshoi me protokollet e distancimit fizik dhe mbajtjes së maskave mbrojtëse. Sektorët e argëtimit dhe pritjes u mbyllën, duke prekur kështu pafundësisht jetën shoqërore. Teknologjia dhe mediat sociale u shndërruan në automjetin kryesor të shoqërimit, meqenëse vizita e miqve dhe familjarëve, takimet dhe tubimet nuk rekomandoheshin. Shpërthimi i Kovid-19 preku të gjithë segmentet e popullsisë, sidomos personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin rom dhe nënat e vetme, të cilët mbështeten tek miqtë dhe familja për mbështetje, pasi shkollat dhe kopshtet e fëmijëve nuk punojnë. Në hulumtimin e zbatuar, ata raportuan ndryshime të pamasë në jetët e tyre shoqërore, dhe tubimet shoqërore me familjet dhe familjarët për të cilat vuajnë, dhe izolimi ishte posaçërisht sfidues për ata. *“Jeta shoqërore vuajti më së shumti, sepse nuk mund të dilnim nga shtëpia. Kam të dashur, dhe kjo ndikoi në lidhjen tonë, sepse nuk jetojmë afër njëri tjetrit.”*¹⁵³ Mirëpo, përsëri, kjo gjendje shtoi shoqërimin onlajn. *“Gjithçka ka ndryshuar, sidomos komunikimi me familjarët dhe miqtë. Komunikonim me Skype. Gjithashtu, krijuam kontakte miqësore me njerëz me të cilët nuk ishim dëgjuar që moti, që është një ndjenjë e bukur. Disa nga ata jetojnë jashtë vendit. Përdorja thirrje me Viber video për ta parë motrën time, e cila jeton në Kanada.”*¹⁵⁴ Të intervistuarit raportuan se shoqërohen me anëtarët e familjes së tyre dhe me miqtë në mënyrë virtuale gjatë pandemisë së Koronavirusit, përmes aplikacioneve siç janë Skype, Viber, Messenger. Teknologjitë dixhitale ofrojnë përfitime të stërmëdha potenciale për gjithsecilin, sidomos për të moshuarit, të cilët ishin më së paku të përfshirë me mjete të këtilla. Ndërkaq, të moshuarit raportuan shoqërimin “përmes telefonit”, dhe jo shpesh përdornin mjete onlajn të komunikimit, siç është Viberi. Arsyeja për përballimin e pengesave të këtilla mund të jetë mungesa e shkathtësive dhe njohurive tek ata. *“Përpara dilnim dhe shihnim njëri tjetrin, e tani kontaktojmë me telefon. Nuk kemi kontakt fizik me askënd, vetëm kur vizitohemi nga bijat tona.”*¹⁵⁵

*“Një rrotullim 360 gradë i jetës. Nga distanca sociale, deri në të mos qenit në gjendje t'i shohësh të dashurit, madje edhe kur jeton bashkë me ata”*¹⁵⁶. Kjo gjë sugjeron se janë shfaqur ndryshime radikale në aktivitetet shoqërore, që çoi drejt asaj që njerëzit ta ndryshonin sjelljen e vet. *“Më mungojnë vizitat dhe pirja e kafes me miqtë e mi, nuk*

153 Intervistë me një grua me aftësi të kufizuara, maj 2020

154 Intervistë me një grua të moshuar, maj 2020

155 Intervistë me një grua me aftësi të kufizuara, maj 2020

156 Intervistë me një grua të moshuar, maj 2020

*dua të ndjehem i vetmuar.*¹⁵⁷ Kështu, masat e ndërmarra për ta luftuar virusin nuk kanë prekur të gjithë në mënyrë të barabartë.

Pasi izolimet në shtëpi dhe rekomandimet për të mos kaluar kohën brenda shtëpisë, por të dilët jashtë shtëpisë, ndikoi tek njerëzit se si po kalojnë kohën e tyre. Shfrytëzimi i parqeve u bë përzgjedhja e banorëve të qytetit, ndërsa u bënë atraktive destinacionet joresidenciale në vend. Në këtë drejtim, shkalla e zhvillimit të komunës dhe disponueshmëria e zonave të gjelbra në afërsi të vendbanimeve të njerëzve u bënë me rëndësi, pasi jo të gjitha sipërfaqet e gjelbra urbane janë të përhapura njëllë nëpër qytetet. Lagjet më të varfra, me dendësi më të madhe dhe me mungesë të sipërfaqeve të gjelbra, të cilat kërkojnë planifikim dhe disenj aktiv, si dhe liderë që do ta bëjnë këtë gjë prioritet. Disa vende (siç janë Shkupi dhe Ohri) konsiderojnë zgjerime të mëdha të infrastrukturës së ecjes me këmbë dhe të biçikletave, duke i dhënë hapësirë tregtisë në nivelin rrugor, mbajnë distanca të sigurta midis njerëzve, dhe krijojnë rrugë më të sigurta dhe më të pastra. Në këtë kuptim, komunat duhet marrë parasysh perspektivën gjinore në aranzhimin e ambienteve publike, që t'i bëjnë ato të sigurta, lehtë të aksesueshme për gratë (dhe nëngrupet e ndryshme, gjegjësisht, gratë me aftësi të kufizuara), si dhe të qenit të dobishme për ata, duke iu përgjigjur nevojave dhe interesave të tyre.

Ndërkaq, masat për ndalimin e shpërhapjes së virusit duhet të mënjanojnë nxitjen e pabarazisë sociale, edhe pse provat sugjerojnë se po afrohen trendët e këtilla. Fleksibiliteti më i madh i të punuarit nga shtëpia për vendet e punës me paga të larta krijoi një boshllëk social për punonjësit me paga të ulëta, të cilët kanë punësim më pak të sigurt dhe nuk mund t'i kryejnë detyrat e punës nga shtëpia, duke nënshtruar veten ndaj rrezikut më të madh nga infektimi, me detyrim, e jo me përzgjedhje. Kjo nënvizon pabarazitë shoqërore, pabarazitë në të ardhura dhe në shëndetësi, për të cilat duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të përqendrohemi në adresimin e tyre gjatë rimëkëmbjes nga Kovid-19 dhe procesit të normalizimit.

Të dhënat ekonomike nga dy tremujorët e parë janë të pamëshirshme për Maqedoninë e Veriut. Vendi ka ngadalësimin më të madh ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Raporti Tremujor Ekonomik i fundit i BE-së për vendet kandidate dhe kandidatet potenciale¹⁵⁸ dëshmon se tkurrja ekonomike ishte 0.2% (krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak) në tremujorin e parë, ulur nga 3.4% të tremujorit të parë të 2019. Raporti shënon se treguesit me frekuenca të larta sugjerojnë se pritet një rënie edhe më e ashpër në tremujorin e dytë. Domethënë, indeksi i prodhimit të industriale ka rënë në 30% në prill dhe maj mesatarisht, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kryesisht për shkak të ngadalësimit të sektorit të prodhimit. Prodhimtaria më e ulët ndikon për fuqinë më të ulët blerëse, dhe si pasojë, shitjet më të ulëta të produkteve, që në fund shtyp ekonominë në një recesion të plotë. Si rrjedhim, gjatë muajve prill dhe maj 2020, tregtia me pakicë u tkurr mesatarisht në 16%, krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2019. Prodhimi i mallrave kapitale ka rënë në 26.4% në

¹⁵⁷ https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/economy-finance/tp042_en.pdf

¹⁵⁸ James Meadway <https://tribunemag.co.uk/2020/03/the-anti-wartime-economy>

pesë muajt e parë të 2020, që shtrun bazën për tkurrje në aktivitetin e investimeve. Efektet ekonomike mbi financat publike lanë gropë me rënie nga 8.3% në të ardhurat në 5 muajt e parë të vitit, krahasuar me 2019 dhe rritje të shpenzimeve të përgjithshme për 7.9%.

Nevojitet një strategji e re pasi shumica e njerëzve humbën vendet e veta të punës, dhe siç tregojnë dëshmitë, gratë janë më vulnerabël se burrat. Ekonomistët përfaqësuan një ekonomi "kundër-luftës"¹⁵⁹ e cila bazohet në reduktimin e prodhimit në mënyrë që nuk do të thotë humbje të jetesës, dhe tkurrjen e kapitalizmit të vepruesve, ku vlerësohen vepruesit në shoqëri, për të kontribuar në suksesin shoqëror. Ndërkaq, bizneset duhet të sjellin shkathtësi dhe prona të reja, për të ndihmuar investimin në një shoqëri më të mirë, me vargje më të shkurtra të furnizimit dhe me më pak vartësi nga jashtë. Për të zvogëluar boshllëqet gjinore në ekonomi, biznes do të duhet të fuqizojnë shkathtësitë dixhitale të grave dhe t'i trajnojnë ato për format e reja të punës.

Kjo lidhet me disponueshmërinë e shërbimeve që janë zëvendësuar që kur ka nisur pandemia, me punën e papaguar të grave për përkujdesje. Aktiviteti ekonomik i grave është i lidhur me aksesueshmërinë në shëndetësi dhe kujdesin social dhe ndaj fëmijëve. Puna në distancë rrit rrezikun për izolim, si dhe vartësinë nga alkooli, pirja e tepërt e duhanit, dhe dhembja e shpinës për shkak të qëndrimit të keq ergonomik të trupit. Risimi i shërbimeve për të adresuar këto realitete të reja duhet qëndruar lart në agjendë, meqë ato lidhen me shëndetësinë e përgjithshme të shoqërisë, por paevitueshëm janë lidhur drejtpërdrejt me barazinë gjinore, meqenëse gratë marrin mbi supet e veta barrën e të gjithë përfundimeve sociale, shëndetësore dhe ekonomike në shtëpi. Analiza më lart tregon se shteti duhet të rihartojë neton sociale për normalitetin e ri në ekonominë, familjen dhe shoqërinë gjatë Kovid-19. Ndërkaq, punëdhënësit po ashtu duhet të pranojnë se e kanë patjetër të mbrojnë punonjësit e vet, për të mbijetuar dhe për t'u harlisur. Kjo duhet qenë një ndryshim afatgjatë i qëndrimit në debatin historik publik kundrejt debatit privat.¹⁶⁰

Për njerëzit e rinj në arsim, pandemia ka të ngjarë të shkaktojë pabarazi të reja

Për njerëzit e rinj në arsim, pandemia ka të ngjarë të shkaktojë pabarazi të reja. Për momentin, 82.1% të qytetarëve me fëmijë në moshën shkollare kanë mjete adekuate për shkollim onlajn, ndonëse 10% kanë thënë se nuk kanë fare mjete për këtë lloj të mësimnxënies¹⁶¹. Në mungesë të mjeteve dhe përmbajtjeve dixhitale dhe pa mbështetjen përkatëse (psikologjike dhe kontekstuale), viti shkollor për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit përfundoi me ndjesinë se kjo zgjidhje ishte një dështim¹⁶². Shumë nxënës në komunitetet më të varfra mund të lihen pa shkollim pra, vajzat, ku do të mbizotërojnë stereotipat gjinorë për t'ua dhënë atyre një pjesë të punës së papaguar në shtëpi, që nuk është rasti edhe me djemtë. Pasojat e këtyre pabarazive arsimore, sidomos për vajzat dhe gratë e reja, do t'i disavantazojë ato në tregjet e punës, dhe plotësueshëm do të keqësojë pabarazinë.

159 <https://www.zurich.com/en/knowledge/topics/global-risks/societal-risks-in-post-Kovid-19-era>

160 <https://bit.ly/3fP42H9>

161 <https://bit.ly/2ZPPnpP>

162 Intervistë me një grua me aftësi të kufizuar, maj 2020

Shpresat për vaksinën kundër Kovid-19 janë më të larta tek grupmosha mbi 65 vjeç, pasi ata më së shumti janë shqetësuar nga normaliteti i ri, ku shumë pak të moshuarve janë të gatshëm për t'u përshtatur dhe për të gjetur mënyra të reja të ruajtjes së jetës shoqërore

TV dhe Interneti kanë qenë burimet e tyre kryesore të informacioneve lidhur me masat e mbrojtjes. Shumica e të intervistuarve po mbështeteshin tek burimet, siç është Organizata botërore e shëndetësisë dhe kanalet e huaja të lajmeve në internet. Ndërkaq, jo të gjitha informacionet janë përshtatur sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara. *"Në lidhje me njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale, për mendimin tim, ata janë kategoria më e prekur, sepse ata mund mos ta kuptojnë informacionin, mund mos ta dinë se çfarë do të thotë ky kufizim i lëvizjes, ata mund të mos dinë se çfarë nënkupton ora policore, andaj, kam përshtypjen se jo të gjitha kategoritë janë përfshirë. Disa njerëz me aftësi të kufizuara nuk kanë akses në informacionet në mënyrën e duhur".*¹⁶³ Shpresat për vaksinën kundër Kovid-19 janë më të larta tek grupmosha mbi 65 vjeç, pasi ata më së shumti janë shqetësuar nga normaliteti i ri, ku shumë pak të moshuarve janë të gatshëm për t'u përshtatur dhe për të gjetur mënyra të reja të ruajtjes së jetës shoqërore. Normaliteti i ri solli një përfundim pozitiv, sipas të të anketuarve, të cilët detektojnë se për shkak të masave të kufizimit të lëvizjes, ne sot gëzojmë "ndotje më të ulët". Leximi satelitor i cilësisë së ajrit të Agjencisë evropiane të hapësirës, Sentinel 5P, konfirmon këtë perceptim, duke regjistruar reduktimin e ndotjes, krahasuar me vitet paraprake, për qytetet anembanë botës.¹⁶⁴

Si pasojë, mund të thuhet se virusi Kovid-19 dhe pandemia që shkaktoi ai, mund të paraqesin një faktor të rëndësishëm për një ndryshim shoqëror. Detyra kyçe për të gjithë ne është kërkesa që format shfaqëse shoqërore të burojnë nga etika, e cila vlerëson kujdesin, jetën, demokracinë dhe barazinë gjinore.

3.4. GJINIA DHE VENDIMARRJA PËR RIMËKËMBJEN PAS KOVID-19

Hulumtimi zbuloi një shkallë involvimi të perspektivës gjinore në punët e *task forcës* komunale të krizës dhe menaxhimit të emergjencave, që u radhit nga e moderuar në joekzistuese. Në nivelin qendror, rrjeti i vëzhgimit të buxhetit gjinor konstatoi se nuk është zhvilluar një analizë gjinore gjatë hartimit të masave të përgjigjes dhe nëse futet në përdorim, sensibilizimi gjinor do të jetë rezultat i reagimeve të qytetarëve dhe të shoqërisë civile. Qasja gjinore, në shumë pak raste, ka përfshirë këshillimin me gra lokale dhe shoqata të grave, përpara miratimit të masave dhe zhvillimit të masave specifike për gjininë, apo të një analize gjinore.

Kështu, studimi demonstroi se nevojitet jo vetëm pjesëmarrja e grave në masat e hartimit dhe zbatimit të masave nga *task forca*, por edhe ndërgjegjësimi dhe njohuritë e implikimeve të barazisë gjinore, si dhe kapaciteti për analizën gjinore, e cila do të determinojë ndikimin e politikave dhe buxheteve mbi pabarazinë gjinore. Një ndërgjegjësim i këtillë mungonte, dhe mungesa e analizës gjinore iu përshkrua mungesës së kohës gjatë përgjigjes së shpejt ndaj krizës. Periudha verore ka qenë

¹⁶³ https://www.esa.int/Applications/Observing_the_Earth/Copernicus/Sentinel-5P/Coronavirus_lockdown_leading_to_drop_in_pollution_across_Europe

¹⁶⁴ "Gllasen tekstilec", Kërkesë drejtuar Qeverisë për të mbrojtur punonjësit e tekstilit, e disponueshme onlajn: <https://cutt.ly/TsLWb6o>

më e relaksuar, andaj duhet të përdoret për vlerësimet e ndikimit të tre pakove të para të masave dhe për mbledhjen e provave, të cilat do ta informojnë politikëbërjen pas zgjedhjeve, e sidomos në periudhën pas Kovid-19. Në nivelin lokal në përgjithësi, kishte mungesë të ndërgjegjësimit se si politikat e mbrojtjes nga virusi mund t'i prekin ndryshe burrat dhe gratë dhe nivelet shumë të ulëta të angazhimit të mekanizmit gjinor në përfshirjen e perspektivës gjinore në reagimin komunal. Për më tepër, një çështje që lindi ishte dhe mungesa e aksesit në informacione dhe transparencë në emrin e autoriteteve komunale në lidhje me përbërjen dhe punën e grupeve të krizës, pavarësisht nga gjinia e tyre, por me bazë bindja e tyre politike. Përgjigja ndaj virusit është mbi përkatësinë politike, etnike dhe fetare dhe patjetër të përfshijë të gjithë, në mënyrë që përgjigja të formohet përkatësisht, dhe të ketë përfitime efektive për të gjithë. Në këtë kuptim, nisja e këtij procesi me pjesëmarrjen e grave (përmes anëtarëve në *task forcën*, këshillimeve me grupe të grave, përfshirjen e një koordinatori të mundësive të barabarta) në proces dhe analiza e aspekteve gjinore dhe të diversitetit të ndikimit të masës, do ta kishte përmirësuar efektshmërinë e politikave dhe masave, si dhe do t'i kishte reduktuar boshllëqet gjinore. Gjithashtu, mungon fokusi për gratë e marginalizuara dhe gratë vulnerabël, siç janë nënat e vetme, gratë me aftësi të kufizuara, gratë që kanë mbijetuar dhunën dhe pakicat etnike, si dhe gratë rurale. Një fokus i tillë do të kishte përcaktuar që masat që po shqiptohen, të mos arrijnë vetëm rezultate të barazisë gjinore, por të fuqizojnë drejtësinë gjinore, si dhe të identifikojnë fushat ku nëngrupet e disavantazuara të grave duhet të mbështeten më tepër se grupet tjera.

Duke marrë në konsideratë se dispozitat e Kushtetutës dhe të ligjeve për miratimin e dekreteve me fuqi ligji, është më së shumti me rëndësi që këto masa të miratohen në një procedurë transparente, dhe në një proces të fuqishëm, i cili pushon mbi politika që kanë si bazë provat, dhe veprimi i këtyre përfshin vlerësimin e ndikimit mbi grupet e grave dhe grupet vulnerabël, si dhe një përbërje normative, e cila nuk do të heqë zotimet e ruajtura në konventat ndërkombëtare. Numri i vendimeve dhe ndryshimet e tyre të shpejta gjithashtu krijuan sfida për bizneset dhe qytetarët, duke e vënë në pyetje sigurinë juridike.


Përfundimisht, zbatimi i masave që përgjigjen ndaj virusit ka një rëndësi edhe më të madhe tani, sesa në periudhën para virusit, meqenëse mënyra e zbatimit apo moszbatimit mund ta vejë shëndetin e grave dhe burrave në rrezik dhe të krijojë boshllëqe gjinore. Ilustrimi më i mirë i kësaj është: (i) shpërhapja e virusit në kompanitë e tekstilit në Shtip dhe Shën Nikollë, si rezultat i mosrespektimit të protokolleve të mbrojtjes¹⁶⁵; dhe (ii) masat për rimëkëmbje ekonomike nuk po shtrihen tek përfuturit e fundit (punonjësit), meqë pagat janë më të ulëta sesa pagat që u paguan në kompanitë e mbështetura nga Qeveria¹⁶⁶. Zbatimi do të krijojë pabarazi plotësuëse, andaj synimi i politikës nuk mjafton, mirëpo Qeveria duhet të shtrëngojë inspektoratet

165 SSM, Let's stop the financial misuse of the support to the employees during the crises, <http://www.ssm.org.mk/mk/da-ja-sprechime-zloupotrebata-na-finansiskata-pomosh-za-rabotnicite-pogodeni-od-zdravstveno>

166 QHKP (2020) Gjinia dhe Kovid-19, e disponueshme onlajn: <https://cutt.ly/RslhHbx>

dhe kapacitetet e monitorimit dhe vlerësimit, tani më shumë se kurrë. Në këtë kuptim, të domosdoshëm janë zbatimi i qëndrueshëm, koordinimi ndër-institucional dhe drejtësia e shpejtë përmes kontrollit gjyqësor të legalitetit të zbatimit të masave të përgjigjes ndaj virusit.

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm, i përdorur shumë në reagimin ndaj Kovid-19, mirëpo rishikimi i buxhetit i kryer në prill 2020, nuk ka ndjekur parimet e pjesëmarrjes, këshillimit, analizës së ndikimit gjinor dhe nuk u shoqërua me një raport mbi gjendjen ekonomike dhe buxhetore dhe mbi justifikimet e modifikimeve; një prezantim të detajuar të modifikimeve; një analizë sipas programit të ndryshimeve; dhe një kuadër të performancës. Kjo kufizoi vlerësimin e ndikimit gjinor të masave të miratuara në këtë raport, dhe po krijon hapësirë për keqinformim, shpërndarje të lajmeve të rreme në lidhje me masat dhe rolin e Qeverisë në trajtimin e virusit, dhe përfundimisht, do të ketë një ndikim në besimin tek Qeveria dhe institucionet. Si përmbyllje, një transparencë dhe justifikim i tillë i vendimeve të marra është thelbësore në një kohë kur Parlamenti shpërbëhet dhe me të drejtën e Qeverisë për të sjellë vendime me fuqi ligji, në mënyrë që të lejojë mbikëqyrjen e këtyre vendimeve dhe shqyrtimin nga organet e pavarura (përfshirë dhe sektorin e organizatave të shoqërisë civile)¹⁶⁷.



167 KB, António Guterres "Rimëkëmbja nga kriza e Kovid-19 patjetër të çojë drejt një ekonomie ndryshe", mars 2020

Kreu

4

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR MASAT E PERIUDHËS PAS KOVID-19

Periudhat e rimëkëmbjes pas krizave mund të ofrojnë një mundësi për 't'i bërë gjërat ndryshe' dhe për të ndërtuar sisteme dhe shoqëri më të drejta



Periodat e rimëkëmbjes pas krizave mund të ofrojnë një mundësi për 't'i bërë gjërat ndryshe' dhe për të ndërtuar sisteme dhe shoqëri më të drejta.¹⁶⁸ Sigurimi i dhënies përparësi barazisë gjinore dhe parandalimi i rrëshqitjeve do të kërkojë të kuptohen boshllëqet gjinore të cilët ka krijuar përgjigja ndaj krizës, si dhe normat e padrejta gjinore që mbizotëronin në shoqërinë maqedonase përpara virusit. Ndërkaq, një studim i këtillë që monitoron ndikimin mbi grupet e ndryshme, si dhe vlerësimet e ndikimit ndërsektorial mbi çështjet gjinore dhe sociale që identifikojnë fuqitë dhe dobësitë, paraqesin mjetet kyçe për politikëbërje.

Studimi tanimë ka konstatuar se përgjigja ndaj pandemisë ka patur efektin joproporcional negativ mbi gratë në të gjithë sektorët dhe grupmoshat. Ka të ngjarë që gratë më shumë se burrat punojnë në sektorët që janë mbyllur gjatë pandemisë. Nënata kanë për pothuajse 70 përqind më shumë prirje se baballarët, që kanë marrë rolin e kujdestarit kryesor pasi janë mbyllur shkollat dhe kopshtet e fëmijëve. Bizneset e grave janë më vulnerabël, meqenëse ato kanë më pak kursime qo do t'i përdornin si strategji mbijetese, kur mungojnë masat financiare për të rritur likuiditetin, për të shlyer detyrimet ndaj kreditorëve dhe për t'iu përshtatur ekonomisë së re të qëndrimit në shtëpi. Kjo shkakton pabarazi në familje dhe ekonomi, dhe mund të kontribuojë për rritjen e pabarazisë në shoqëri.

Nëse nuk adresohet si duhet përmes politikave, edhe kriza e shkaktuar nga pandemia Kovid-19 mund ta rrisë pabarazinë, përjashtimin dhe diskriminimin. Gratë dhe grupet siç janë romët, nënat e vetme, personat me aftësi të kufizuara, gratë rurale, janë më të rrezikuara.

REKOMANDIMET EKONOMIKE

1. Qeveria duhet ndihmuar vepruesit ekonomikë të vazhdojnë punën me kushte të reja, mirëpo duhet aplikuar kriteret gjinore. 76.6% të të anketuarve vlerësojnë se nuk do të mbijetojnë në 1 deri 6 muajt e ardhshëm nëse kjo gjendje do të vazhdojë të ndikojë bizneset e tyre, ndërsa bizneset e grave janë më të rrezikuara. Kjo dëshmon se:

- Duhet të rihapet ekonomia, madje edhe nëse virusi nuk është larguar në plotësi, Qeveria duhet të prijë rrugën duke futur dhe imponuar rregulla për kushtet e sigurta të punës me realitetin e ri, për gratë dhe burrat afaristë, por edhe për të gjithë punonjësit, duke ditur se gratë kryejnë detyra pune që më së shumti janë ekspozuar ndaj virusit.
- Duhet të fuqizohen kapacitetet e inspektorateve të punës, e legjislacioni duhet të zgjerohet për mënyrat e reja të punës sipas ekonomisë së qëndrimit në shtëpi, duke siguruar kështu se do të mbrohen të drejtat si të punëdhënësit, ashtu dhe të punonjësit. Provat nga sektori i tekstilit, ku gratë kryesisht punojnë, dëshmojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të shpejta të inspektorateve të punës për të ndihmuar reduktimin e shpërhapjes së virusit dhe për të mbrojtur shëndetin e rrobaqepëseve.

¹⁶⁸ http://www.katastar.gov.mk/wp-content/uploads/rodova_ednakvost/izvestai/Tabela_so_broj_i_procent_na_zapisani_prava_po_pol_i_po_katastarsko_oddelenie_2019.pdf.

- Këshillat në fushat siç është planifikimi i përgjithshëm, vendosja e operacioneve onlajn dhe planifikimi financiar janë të mirëseardhura. Ndihma e Qeverisë në këtë kuptim mund të jetë në drejtimin e qendrës së njohurive dhe qendrës së informacionit, me këshilla dhe udhëzime për bizneset që po planifikojnë të transformohen dhe/ose që po përballen me vështirësi. Skemat e mentorimit midis grave afariste duhet të merren parasysh për këtë qëllim, për të lehtësuar shkëmbimin e eksperiencave dhe për të ofruar mbështetje të ndërsjellë.

2. Plani i shumë kompanive për të shtyrë shlyerjen e detyrimeve (30% të të anketuarve), sugjeron se kriza e likuiditetit është në proces. Bizneset e drejtuara nga gra kanë më së paku kursime dhe ato luftojnë më së shumti, e kështu kanë nevojë për vëmendje të posaçme. Kompanitë do të hezitojnë të tregtojnë me kredi dhe do të fillojnë të kërkojnë pagesat paraprakisht, që do të prekë likuiditetin, do të mbysin tregtinë dhe mund të bëjnë thirrje për kaskadat parazgjedhore.

- Për të ruajtur likuiditetin, nevojitet një skemë e garantimit të kredisë qeveritare të paracaktuar. Gratë zotërojnë vetëm 27,27 % të pronës së regjistruar¹⁶⁹ dhe do të jenë më pak të kualifikuara për kredi. Prandaj, fondi specifik i garancisë për gratë sipërmarrëse do të jetë një domosdoshmëri.
- Sigurimi i kredisë tregtare mbron kompanitë nga rreziku i mospagimit nga klientët e tyre. Për krahasim, vendet e pasura evropiane, si Franca dhe Britania, kanë ofruar garanci kredie deri në 15% të PBB-së, e cila do të korrespondonte me afër 2 miliardë euro në Maqedoninë e Veriut. Paketa e tretë e fundit e Qeverisë për lehtësim ekonomik parashikon garanci kredie, por vetëm për kompanitë start-up, mikro dhe të vogla, dhe ka limituar atë në 10 milionë euro, që mund të dëshmojnë si të pamjaftueshme. Duhet të aplikohen kriteret specifike gjinore për garancitë.
- Për ndryshimin e sistemit të pagimit të TVSH duke parashikuar pagimin gjatë mbledhjes, në vend të pagimit me të lëshuarit e faturës, që konsiderueshëm do të ndikonte likuiditetin, 30% të të anketuarve deklaruan se Qeveria duhet të vendosë pagimin e TVSH me mbledhjen si një masë e re e emergjencës.

3. Strategjia e mbijetesës bazohet mbi menaxhimin e kohës dhe burimeve vetjake, reduktimin e kostove, dhe vartësinë e tepërt nga kursimet vetjake dhe të kompanisë. Bizneset e grave janë më të prekshme për këtë, pasi ato kanë më së paku kursime dhe prandaj duhet të synohen në mënyrë specifike me masa financiare që do të rrisin likuiditetin e tyre, për të përmbushur pagimin e kreditorëve dhe për t'iu përshtatur ekonomisë së re të qëndrimit në shtëpi.

- Aplikimi i kriterëve gjinore në masat e dhëna të mbështetjes financiare dhe mbështetjes jofinanciare do ta bëjë të mundur mbijetesën e bizneseve të grave dhe të vazhdojnë investimet në fuqizimin ekonomik të grave në vitet e kaluara.
- Zhvillimi i masave që synojnë posaçërisht ndërmarrjet mikro dhe të vogla, si dhe ato që punojnë ekskluzivisht në tregun maqedonas gjithashtu do të jenë në

¹⁶⁹ http://www.katastar.gov.mk/wp-content/uploads/rodova_ednakvost/izvestai/Tabela_so_broj_i_procent_na_zapisani_prava_po_pol_i_po_katastarsko_oddelenie_2019.pdf

dobinë e bizneseve të drejtuara nga gratë, meqenëse sondazhi i QHKP tregon se 78% të grave sipërmarrëse veprojnë në tregun e brendshëm, përkundër burrave sipërmarrës që punojnë edhe në tregjet e huaja.

- Për bizneset e drejtuara nga gra, është po ashtu e rëndësishme të krijohen masa mbështetjeje jofinanciare, siç janë grupet e mbështetjes, ku gratë do të takohen dhe do të shkëmbejnë eksperiencë, duke inkurajuar njëra tjetrën dhe duke bashkëpunuar në ndërtimin e rezistencës ndaj krizave.

TREGU I PUNËS

1. Zhvillimi i masave për mbështetjen e punonjësve në sektorin joformal dhe dixhital.

- **Punonjësit joformal u lanë pothuajse tërësisht jashtë masave**, duke marrë në konsideratë se shumica janë gra që ofrojnë asistencë në shtëpi (kujdestare fëmijësh, pastruese, ndihmëse për punë të ndryshme, infermiere) si dhe punë në fushë, etj. Në këtë nëngrup ka shumë gra romë, nëna të vetme dhe grupe të tjera vulnerabël. Ato duhet sa më shpejt të hyjnë në sistemin e mbrojtjes. Duhet shfrytëzuar krizat për të regjistruar dhe formalizuar punën e tyre të padukshme.
- **Me zgjerimin e ekonomisë së punës së pavarur në kuadrin e krizave dhe pa rregullimin e ambientit dixhital, do të rritet edhe joformaliteti në këtë sektor.** Duke marrë në konsideratë se gratë më pak marrin pjesë në këtë sektor, mungesa e rrjetit të sigurisë do të vazhdojë të jetë arsyeja për pjesëmarrjen e ulët të grave në ekonominë e punës së pavarur, dhe kështu do të kontribuojë për boshllëkun edhe më të madh të pagave midis grave dhe burrave. Nevojiten masa specifike për t'iu përgjigjur nevojave të punonjësve joformalë dhe për të ulur joformalitetin në të ardhmen. Kjo është me rëndësi si për ekonominë, ashtu dhe për punëtorët. Konkurrenca e kompanive po ashtu vihet në rrezik nëse tregu dixhital lihet jashtë rregullave. Gratë dhe burrat e punësuar në platforma dhe që punojnë nga shtëpia në internet, nga ana tjetër, kanë nevojë për rrjete të sigurta.
- **Përmirësimi i kuadrit ligjor për të përfshirë format e reja të punës, do ta lehtësonte përshtatjen me normalitetin e ri të ekonomisë.** Duhet të miratohen pako të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore për këtë grup të veçantë, i cili tani mungon, dhe i cili nuk është rregulluar me Ligjin e punës. Përderisa Qeveria ka mbështetur masat për trajnimin e të rinjve në shkathtësitë dixhitale, mungon kuadri juridik për punën dhe shitjet në internet.
- **Ndërtimi i shkathtësive dixhitale dhe mbështetja e parakualifikimeve të grave në profesionet e reja dixhitale.** Gratë janë me më pak pjesëmarrje në STEM dhe kështu, nuk do të aksesojnë vendet e reja të punës dixhitale me shtrirjen e njëjtë si burrat. Do të nevojitet një mbështetje shtesë, meqë veprimtaria ekonomike gjatë dhe pas periudhës së Kovid-19 do të jetë dixhitale.

2. Mbështetja e punonjësve të vijës së parë dhe zhvillimi i përfitimeve më të mira dhe mbrojtja e punës së punonjësve me pagë të ulët.

- Korrigjimi i sistemit të pagave për të pasqyruar aktivitetet dhe përgjegjësitë që njerëzit marrin në punën e tyre, numrin e orëve që ata kryejnë punën nga shtëpia, si dhe rrezikun që ata marrin për t'u infektuar gjatë kryerjes së detyrës së punës. Shumica e këtyre punonjësve janë gra me pagë të ulët.
- Sigurimi i monitorimit dhe aplikimit të masave të mbrojtjes nga virusi në biznesin që punëson punonjës me pagë të ulët. Për këtë qëllim janë prioritet inspektimet e zbatuara dhe partneriteti me punëdhënësit.

3. Në zhvillimin e masave të punësimit, duhet të dyfishohen kompetencat e njerëzve me nevojat e grupeve vulnerabël.

- Masat e ardhshme aktive të punësimit patjetër të mbështesin kapitalizmin e vepruesve, që bazohet mbi solidaritetin dhe etikën si vlera kryesore. Familjet dhe njerëzit që jetojnë në të njëjtën lagje, duhet të mbështeten tek shërbimet që ofrohen nga fqinjët e tyre. Kjo do të kontribuojë edhe për suksesin e shoqërisë dhe vargjet më të shkurtra të furnizimit i cili në mënyrë të pamohueshme do të ketë ndikim në zvogëlimin e shpenzimeve për jetese dhe varfërisë.

KOHEZIONI SOCIAL

1. Mbështetja e solidaritetit komunitar.

- Inkurajimi i punësimit dhe përfshirja sociale, me mbështetjen e dhënies komunitare të asistencës kompjuterike; mbështetja e shkollave me mësues vullnetarë për kopshtet e fëmijëve dhe shkollat fillore; mësimet gjuhësore; mbështetja psikologjike, etj. Dhënia e shërbimit duhet të shtrihet në zonat rurale, meqenëse gratë dhe burrat në këto zona ndjehen të diskriminuar.

2. Adresimi i paragjytimeve.

- Paragjykimet kundër grave dhe burrave të infektuar me Kovid-19 patjetër të zberthehen. Më të prekurit janë grupet vulnerabël dhe pakicat etnike, sidomos romët, siç demonstrohet me këtë studim. Kjo do ta përmirësojë aksesin e grupeve të pafavorizuara në shërbimet elementare. Për këtë qëllim, kufizimi i lëvizjes së të moshuarve nuk duhet të rishikohet, sepse u dëshmuua si diskriminues, përkaj qëllimit të mirë të politikës, ai prodhoi ndjenja të diskriminimit.

3. Reformimi dhe ndryshimi i kuadrit ligjor për të ardhur në përputhje me KDKPAK.

- Ndërkaq, masat e Qeverisë për Kovid-19 duhet të harmonizohen me standardet e përcaktuara me KDKPAK të KB-ve dhe ato duhet të përfshijnë qasjen ndërsektoriale, duke përfshirë dhe përshtatjen e arsyeshme. Koncepti i modelit universal, i lidhur me parimin e të qenit të qasshëm dhe akomodimit të arsyeshëm, duhet të udhëheqë të gjitha politikat dhe masat.

4. Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit, për t'iu përshtatur nevojave të grave dhe burrave me aftësi të kufizuara.

- Shteti siguroi informacione në gjuhën e shenjave gjatë konferencave për shtyp në lidhje me Kovid-19, jo nga fillimi, por në vazhdimësi deri në fund të gjendjes së jashtëzakonshme. Megjithatë, ajo duhet të sigurojë se të gjitha informacionet lidhur me gjendjen e jashtëzakonshme si dhe informacionet e përgjishme mbi virusin janë vënë në dispozicion në formate të arritshme për personat me dëmtime të ndryshme, përfshirë personat e shurdhër, përmes gjuhës së shenjave, dhe në gjuhë të ndryshme që fliten në territorin e saj, duke përfshirë komunikimin braj, komunikimin augmentativ dhe alternativ, dhe të gjitha mjetet, mënyrat dhe formatet e arritshme të komunikimit, sipas përzgjedhjes së personave me aftësi të kufizuara në ndërveprimet zyrtare, konform Nenit 21(b) të KDPAK. I tërë stafi civil dhe qeveritar në *task forcat* e emergjencës dhe për të gjithë vepruesit potencial të përfshirë në rastet emergjente dhe ata që prekin virusin, patjetër të kalojnë trajnimin e kërkuar në ndërgjegjësimin për aftësitë e kufizuara.

5. Monitorimi dhe raportimi për Kovid-19 me të dhëna të ndara për seksin dhe aftësinë e kufizuar.

- Përveç të dhënave dhe informacioneve ekzistuese, duke marrë parasysh numrin e të prekurve me Kovid-19, të dhënat e ndara për seksin ndaluan të shpërndahen në fundin e qershorit, ndërsa nuk ka asnjë dëshmi në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Si pasojë, ekziston një nevojë urgjente që Qeveria të fillojë mbledhjen e të dhënave mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara, të ndarë sipas moshës, llojit të aftësisë së kufizuar, etnisë, gjinisë, etj. Gjykatat, Prokuroria publike dhe institucionet që zbatojnë masat (Ministritë (e ekonomisë, shëndetësisë, për punë dhe politikë sociale, shoqërisë informatike dhe administratës), Agjencitë (e sportit dhe rinisë, turizmit, punësimit) dhe Banka zhvillimore e Maqedonisë së Veriut), me të cilat Qeveria iu përgjigj Kovid-19, nuk po mbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, që në mënyrë plotësuese kufizojnë analizën e vlerësimit të ndikimit nga perspektiva gjinore. Ministria për punë dhe politikë sociale duhet t'u dërgojë rekomandime specifike këtyre palëve të interesit, për t'i përputhur sistemet e tyre të të dhënave me kërkesat e Ligjit për mundësi të barabarta.

6. Shteti, komunat dhe palët relevante të interesit, duhet të sigurojnë pjesëmarrje aktive dhe koordinim me personat me aftësi të kufizuara dhe me organizatat që përfaqësojnë ata, përfshirë gratë, burrat, djemtë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet.

- Duhet të hartohen udhëzime për aftësinë e kufizuar në gjendje të jashtëzakonshme për palët e ndryshme të interesit, përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme (shëndetësi, arsim, siguri shoqërore). Duhet të bëhen hulumtime më gjithëpërfshirëse në lidhje me praktikat diskriminuese gjatë gjendjes së jashtëzakonshme gjatë Kovid-19, duke marrë parasysh personat me aftësi të kufizuara, në pajtim me parimet e KDPAK.

7. Përmirësimi i modelit, që duhet të krijohet, i konceptit të mësimin në distancë, për të ulur boshllëqet gjinore dhe pabarazitë.

- Kriza ka paralizuar sistemin e arsimit, duke e lënë atë pa një vizion të qartë se si të bëhet menaxhimi përmes krizës. Kjo lë një rrezik për fëmijët, pa mjete për shkollim në shtëpi, sidomos ato të grupeve vulnerabël, siç është rasti me vajzat rome, për të humbur aksesin në arsim dhe për të humbur mundësitë e ardhshme. Kërkohej një strategji urgjente me fokus të veçantë në grupet vulnerabël.

8. Përmirësimi i komunikimit me qytetarët drejt edukimit publik për masat e domosdoshme të mbrojtjes nga shpërhapja e virusit.

- Një pjesë e madhe e publikut akoma nuk beson masat e miratuara, apo madje dhe ekzistencën e vetë sëmundjes, dhe refuzon të vesh maska. Një komponent shumë i rëndësishëm në luftën kundër virusit është aplikimi i fushatave të duhura edukative, të cilat do ta informojnë publikun për faktet përkundër miteve, në lidhje me virusin. Nevojitet dhe një qasje që ka si bazë gjininë në ndërgjegjësimin.

REKOMANDIME PËR DHUNËN DHE SIGURINË PUBLIKE

1. Përmirësimi i efektit të ndërgjegjësimin dhe informimin të viktimave për të raportuar dhunën.

- Megjithatë reagimi i policisë ndaj dhunës kundër grave është i lavdërueshëm, nevojitet reagimi i shtuar dhe i vazhdueshëm, si dhe efekti i përmirësuar në sigurimin e informimin të hershëm dhe ndërgjegjësimin, dhe inkurajimi i viktimave për të raportuar dhunën ka nevojë për bashkëpunim më të sistematizuar ndërsektorial, që do të ndikonte rezultatet në adresimin e, si të mosbesimit të pranishëm, ashtu dhe të hezitimit për të raportuar dhunën. Në komunat ku nuk janë aplikuar, duhet të zgjerohen dhe kopjohen mënyrat efektive për të informuar dhe inkurajuar publikun e gjerë, e konkretisht viktimat, që të raportojnë dhunën përmes aksesit të shpejtë në informacionin, siç janë përmbajtjet në internet, fletushkat, apo stendat e afishimit që kanë të bëjnë me procedurat e denoncimit.

2. Ndryshimi i mënyrave se si denoncohen rastet e dhunës ndaj grave.

- Për t'u përshtatur, duhet të merren parasysh reforma e moduleve dhe mënyra e denoncimit të rastit të dhunës gjatë pandemisë, sidomos duke patur parasysh se karantina vendos kufizime në mundësitë për të hyrë në internet apo për të marrë telefonin përderisa të gjithë anëtarët e familjes, përfshirë dhe kryerësin, janë pak a shumë nën të njëjtin kulm. Për këtë qëllim, duhet ndryshuar mënyrat e denoncimit të dhunës dhe duhet aplikuar denoncime me prokurë/autorizim.

3. Të punuarit kundër anësisë dhe paragjytimeve në raportim.

- Pandemia Kovid-19 gjeneroi mësimet dhe praktikat më të mira nga rastet e raportuara të dhunës ndaj grave dhe mënyrën se si reagojnë institucionet dhe

shoqëria civile. Palët e interesit, e para së gjithash, Ministria për punë dhe politikë sociale, duhet t'i shfrytëzojnë ato për të rrënuar paragjykimet dhe për të adresuar anësitë në raportim.

4. Ndërtimi i një rrjeti të fuqishëm të vendstrehimeve dhe shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje.

- Vendosja e shpejtë e vendstrehimeve për viktimat e dhunës në familje, dhe shërbimet e tjera (mbështetja psiko-sociale, mbështetja juridike, fuqizimi ekonomik, etj.) për gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, duhet të mbështetet në çdo rajon. Trendet e rritura në rastet e dhunës ndaj grave për shkak të izolimit në shtëpi sjellin edhe një përafrim të madh të Kodit penal me Konventën e Stambollit si prioritet.

5. Ndryshimi i procedurës për adresimin e dhunës në familje, me zhvendosjen e kryerësit nga shtëpia e viktimës, e jo e kundërta.

VENDIMMARRJA

1. Nisja e hartimit të një kuadri të ri ligjor apo të reformimit të atij ekzistues, që do t'i përgjigjet gjendjes së jashtëzakonshme.

- Pandemia Covid-19 nxori në shesh boshllëqet në Kushtetutë për sa i përket formatit dhe përmbajtjes, dhe së fundmi, vlefshmërinë e Dekreteve qeveritare me fuqi ligji, përtej gjendjes së jashtëzakonshme. Këto çështje duhet të përkufizohen, si dhe procedurat dhe fushëveprimi i Dekreteve. Reforma duhet të përfshijë Ligjin mbi Qeverinë, Ligjin e organizimit dhe funksionimit të organeve të administratës shtetërore, Ligjin për menaxhim të krizave, Ligjin e mbrojtjes dhe shpëtimit, Ligjin për punëve të brendshme, Ligjin e policisë, Ligjin e Parlamentit.

2. Duhet të përmirësohet procesi i hartimit të politikave, veçanërisht në rrethanat aktuale.

- Në vend se të sjellë në fuqi akte normative me një faqe, të cilat prekin mijëra qytetarë dhe që vlejné miliona eurosh, me artikuj të paqartë dhe të lënë të hapur për interpretime të ndryshme, çdo masë e hartuar nga Qeveria dhe/ose Parlamenti duhet qenë transparente, bazuar në analizën gjinore dhe duke përfshirë justifikimin, vlerësimin e kostove dhe përfitimeve, dhe efektet e pritura. Meqenëse perspektiva gjinore siguron politika më të synuara, më të drejta dhe efektive, mendojmë se Qeveria duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje aspektit gjinor kur krijon politika dhe miraton masa. Me integrimin e aspektit gjinor si pjesë përbërëse, mund të vlerësohet ndikimi i masës mbi të gjitha nëngrupet e tjera të grave (gratë me aftësi të kufizuara, gratë e moshuara, nënat e vetme, gratë e pakicave etnike, gratë rurale, etj.)

3. Më shumë gra duhet të përfshihen në vendimmarrje në çdo nivel, për të siguruar adresimin e shqetësimeve për barazinë gjinore.

- Gratë duhet të bëhen anëtare në *task forcat* e emergjencave, të konsultohen kur po hartohen masat, përmes angazhimit të grupeve / organizatave të grave,

dhe duke përfshirë koordinatorin e mundësive të barabarta në hartimin e politikave. Qeveria dhe komunat duhet të krijojnë një bashkëpunim më të mirë me sektorin e shoqërisë civile, i cili mund të përcjellë zërin e grupeve vulnerabël, por gjithashtu sjellë me vete përvojë dhe ekspertizë shumëvjeçare për aspektet socio-ekonomike të luftës kundër-virus.

4. Përforcimi i inspektorateve dhe kapacitetit e monitorimit dhe vlerësimit, për të zvogëluar boshllëqet gjinore që krijohen me zbatimin e masave të politikave me synim gjinor pozitiv, apo edhe transformues.

- Zbatimi i masave që i përgjigjen virusit kanë rëndësi edhe më të madhe tani, sesa në periudhën para virusit, meqë mënyra e zbatimit apo moszbatimit mund të vërë në rrezik shëndetin e grave dhe burrave dhe të krijojë boshllëqe gjinore. Përforcimi i inspektorateve dhe kapaciteteve të monitorimit dhe vlerësimit, tani më shumë se kurrë.

5. Mundësimi dhe kryerja e vlerësimit të ndikimit gjinor fiskal të burimeve buxhetore.

- Miratimi i rishikimeve të buxhetit, i shoqëruar me raportin mbi gjendjen ekonomike dhe buxhetore dhe justifikimi i modifikimeve; një prezantim i hollësishëm i modifikimeve; një analizë sipas programit të ndryshimeve; dhe një kuadër i performancës. Me qëllim që të mos krijohen zbrazëtira të reja gjinore është e rëndësishme që në mënyrë të vazhdueshme të vëzhgohet dhe vlerësohet ndikimi fiskal gjinor mbi të ardhurat publike i cili ka prekur Covid 19. Këta masa dhe finansimet publike të cilat krijojnë pabarazi gjinore duhet që të rishikohen dhe të ndryshohen masat e reja si dhe buxhetet të cilët do të përmirësonin barazinë gjinore në vend.



SHTOJCA



SHTOJCA 1

LISTA E DEKRETEVE QEVERITARE QË KUFIZOJNË TË DREJTAT OSE LIRITË

E DREJTA E TUBIMIT

Numri i Dekretit

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 71/20

Vendimi Nr. 44-2147/1 i 6 prillit 2020;

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 92/2020 e 6 prillit 2020”

Vendimi Nr. 44-2147/8 i 13 prillit 2020;

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 100/2020 e 13 prillit 2020”

Vendimi Nr. 44-2147/9 e 22 prillit 2020;

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 107/2020 e 22 prillit 2020”

Vendimi Nr. 44-2394/1 i 20 marsit 2020,

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 71/2020 e 20 marsit 2020”

LIRIA E LËVIZJES

Numri i Dekretit

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 71/20

Vendimi Nr. 44-2147 i 12 marsit 2020

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 62/20

Vendimi Nr. 44-2416/3 i 24 marsit 2020,

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 72/20, 74/20, 76/20 dhe 78/20

Vendimi Nr. 44-2416/4 i 25 marsit 2020

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 78/20

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 89/20 e 3 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2416/6 i 6 prillit 2020 (në fuqi që nga 8 prilli 2020),

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 92/20 e 6 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2416/1 i 13 prillit 2020

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 100/20 e 13 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2416/8 i 18 prillit 2020

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 105/20 e 21 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2416/1 i 28 prillit 2020

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 111/20 e 28 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2416/11 i 8 majit 2020

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 119/20 e 8 majit 2020

Vendimi Nr. 44-2416/12 i 14 majit 2020

„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 125/20 e 15 majit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 130/20 e 19 majit 2020

Vendimi Nr. 44-2416/14 i 22 majit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 134/20 e 22 majit 2020

Vendimi Nr. 44-2406/1 i 20 marsit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 71/2020 e marsit 2020

Vendimi Nr. 44-2415/1 i 21 marsit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 72, e 21 marsit 2020

Vendimi Nr. 44-2449/1 i 23 marsit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 76/20 e 24 marsit 2020

Vendimi Nr. 44-3093/1 i 13 prillit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 100/20 e 13 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2828/1 i 2 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2818/1 i 3 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-3324/1 i 22 prillit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 107/20 i 22 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-3703/1 i 5 majit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 118/20 e 7 majit 2020

Vendimi Nr. 44- 3322/1 i 22 prillit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 107/20 i 22 prillit 2020

E DREJTA E SHËNDETIT PUBLIK

Numri i Dekretit

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 72/20, 76/20 e marsit 2020

Vendimi Nr. 44-2917/1 i 7 prillit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 94/20 e 7 prillit 2020

Vendimi Nr. 44-2449/2 i 9 prillit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 97/20 e 9 prillit 2020

E DREJTA E ARSIMIT

Numri i Dekretit

Vendimi Nr. 44-2445/1 i 23 marsit 2020

“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, Nr. 76/20 e 24 marsit

Vendimi Nr. 44-2446/1 i 23 marsit 2020

Vendimi Nr. 44-2447/1 i 23 marsit 2020

SHTOJCA 2 LISTA E EKIBEVE TË INTERVISTUARA TË REAGIMIT NË NIVELIN LOKAL

EMRI DHE MBIEMRI	KOMUNA
Agron Beqiri	Komuna e Haraçinës
Bujare Abazi, Këshilltare	Komuna e Çairit
Taner Haxhimustafa, Këshilltar	Komuna e Çairit
Vesna Dameska, Këshilltare	Komuna e Çairit
Visar Ganiu, Kryetar Komune	Komuna e Çairit
Maja Filipçeva: Personi i kontaktit dhe Anëtare e Qendrës për menaxhim të krizave, Këshilltare në sektorin e zhvillimit dhe zëvendës koordinatore për mundësitë e barabarta të grave dhe burrave	Komuna e Karposhit
Marija Koçoska, Sekretare e Organizatës komunale të Kryqit të Kuq në komunën e Karposhit	
Stefan Bogoev, Kryetar komune	Komuna e Karposhit
Adelina Ademi, Këshilltare	Komuna e Kumanovës
Atina Murgasanska, Këshilltare	Komuna e Kumanovës
Fati Ebibi, Qendra e mbrojtjes dhe shpëtimit	Komuna e Kumanovës
Sasho Stoshevski, Këshilltar	Komuna e Kumanovës
Erxhan Demir, Lider Dege të VMRO-DPMNE-së	Komuna e Shuto Orizares
Fatima Osmanovska, Kryetare e këshillit komunal	Komuna e Shuto Orizares
Ferat Asan, Lider dege të LSDM-së	Komuna e Shuto Orizares
Tanja Kërstiç, Vullnetare dhe anëtare e Qendrës për menaxhim të krizave	Komuna e Shuto Orizares
Ilija Jovanovski, Kryetar komune (deklarata e firmosur anonimisht)	Komuna e Prilepit
Olivera Axhioska, Spitali lokal i Përlepit	Komuna e Prilepit
Katerina Koçoska, Njësia lokale e Kryqit të Kuq (deklarata e firmosur anonimisht)	Komuna e Prilepit
Hekuran Duka, Kryetar Komune	Komuna e Dibrës
Femija Ajrovski, Qendra lokale e menaxhimit të krizave	Komuna e Dibrës
Isni Telqiu, Njësia lokale e Kryqit të Kuq	Komuna e Dibrës

SHTOJCA 3

TABELA E MASAVE TË ANALIZUARA NGA PERSPEKTIVA GJINORE

FUSHA

Mbrojtja shëndetësore, të drejtat seksuale dhe riprodhuese dhe kujdesi

- 1) prokurimi emergjent i 200 makinave respiratorë
- 2) 20% të rritjes së pagave të stafit mjekësor të përfshirë në luftimin e Kovid-19 për dy muaj

Rimëkëmbja ekonomike dhe jetesa

Shtyrja dhe reduktimi i tatimeve

- 1) pezullimi i pagimit paraprak të tatimit mbi fitimin për muajt mars, prill dhe maj;
- 2) pezullimi i pagimit paraprak të tatimit mbi të ardhurat personale për muajt mars, prill dhe maj, për tatimpaguesit nga puna e pavarur në veprimtari të caktuara;
- 3) pezullimi i taksave doganore të pajisjes mjekësore;
- 4) sigurimi i borxheve doganore për ta mbështetur eksportin me garanci shtetërore në vlerë totale nga 3 milionë euro

Mbështetja financiare e kompanive dhe mbrojtja e likuiditetit

- 1) subvencionimi i 50% të kostove të kontributeve për muajt prill, maj dhe qershor (maksimum deri 50% të pagës mesatare për muajin janar 2020);
- 2) subvencionimi me 14.500 denarë për punonjës për muajt prill dhe maj, për të gjitha kompanitë;
- 3) dhënia e huave në shumë nga 13.7 milionë denarë pa interes nga Banka zhvillimore e Maqedonisë së Veriut për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, nga sektorët më të prekur;
- 4) dhënia e 50 milionë eurove me shkallë të ulët interesi nga rreth 1.5% përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut dhe Bankës evropiane të investimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përmes bankave komerciale;
- 5) agjencitë e udhëtimeve detyrohen të lëshojnë vauçerë për aranzhimet e anuluar, në kohëzgjatje deri më 31.12.2021;
- 6) hua pa interes për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, përmes Bankës zhvillimore të Maqedonisë së Veriut, me vlerë nga 31 milionë euro, duke përfshirë 30% të mjeteve të pakthyeshme financiare që drejtohen apo janë themeluar nga gra apo që punësojnë të rinj, janë të orientuara drejt eksportit, apo fusin inovacion dhe dixhitalizim në punën e vet;
- 7) marrja përsipër e një rreziku kreditor për kompanitë start-up dhe kompanitë e vogla dhe mikro, përmes bankave komerciale, në shumë nga 10 milionë euro të kapitalit nismëtar për akses më të lehtë në burimet financiare;
- 8) mbështetja financiare në shumë nga 25 milionë euro për fuqizimin e konkurrueshmërisë së kompanive, për të pushtuar tregje të reja dhe për të modernizuar proceset;
- 9) platforma dixhitale për tregje të reja për kompanitë e tekstilit, me mbështetje financiare nga 1 milionë euro;

10) mbështetja e zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të brendshme start-up përmes FIZHT, në shumë nga 1,6 milionë euro;

11) bashkëfinancimi i evenimenteve dhe konferencave me 50% mbështetje financiare nga shteti, deri në maksimumin e 30.000 denarëve.

Mbrojtja e standardeve të jetës

1) ngrirja e çmimeve të produkteve bazë;

2) krijimi i mundësisë për bankat, kompanitë financiare dhe kompanitë huadhënëse të ristrukturojnë huatë;

3) reduktimi i shkallës së interesit, ndalimi i ekzekutimit dhe falimentimit;

4) mbështetja financiare për atletët me shumë nga 14.500 denarësh gjatë muajit prill dhe maj;

5) Përfitimi me para të gatshme për të gjithë personat që kanë humbur punën e tyre nga 11 marsi deri më 30 prill 2020.

Likuiditeti i buxhetit shtetëror

1) kryetarët dhe anëtarët e bordeve të drejtorëve dhe bordeve mbikëqyrëse nuk do të marrin kompensim;

2) hapja e fondit të solidaritetit për Covid-19 për të marrë donacione;

3) huamarrja nga kreditorë të huaj, planifikohen 580 milionë euro, ka dimensionin gjinor.

IncKurajimi i konsumit dhe ringjallja e ekonomisë

1) kartela e pagimit me shumë nga 9.000 denarësh për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase për të papunët, qytetarët me të ardhura të ulëta dhe përfituesit e asistencës minimum të garantuar;

2) vauçerë për turizmin e brendshëm me shumë nga 6.000 denarësh dhe kartela e brendshme e pagimit me shumë nga 3.000 denarësh për qytetarët me neto pagë më të ulët se 15.000 denarë;

3) kartela e pagimit për të rinj, me shumë nga 3.000 denarësh për produkte dhe shërbime të brendshme;

4) vauçer me shumë nga 30.000 denarësh për bashkëfinancimin e trajnimeve dhe kurseve për shkathtësitë e TI dhe ato dixhitale për të rinj;

5) mbështetja financiare e të rinjve deri më 6.000 denarë për të mbuluar shpenzimet e shkollimit në Universit apo akomodimi në konvikte;

6) Fundjava pa TVSH - për të gjithë qytetarët në sektorë të caktuar të shitjeve.

Mbështetja e bujqësisë

1) mbështetja financiare e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kryejnë prodhimtari primare, përpunime dhe eksport të produkteve primare dhe të përpunuara bujqësore;

2) kartela e pagimit për subvencionimi me 50% të naftës së gjelbër për 50.000 bujq, me vlerë nga 4.6 milionë euro

3) Stimulimi i përpunuesve të rrushit për prodhimin e produkteve të reja, siç është distilati alkoolik për prodhimin e dezinfektuesve me vlerë nga 3,5 milionë euro për tre vjet;

4) Partneritetet publiko-private në sektorët e vitikulturës dhe duhanit;

5) Aplikimi i qiradhënies afatgjate të kullotave dhe rritja e tokave bujqësore për konkurrueshmëri më të madhe të bujqësisë së Maqedonisë së Veriut;

6) futja e një Programi për Financimin e mikro kompanive bujqësore, me shumë nga 3 milionë euro;

7) masat për modernizimin e bujqësisë përmes një huaje të Bankës botërore nga 50 milionë euro.

Mbrojtja sociale dhe tregu i punës

1) lehtësimi i hyrjes së shpejtë në sistemin e punonjësve joformal dhe të tjerëve, për të marrë ndihmën e garantuar minimale, bazuar në shumën totale të të gjitha të ardhurave të anëtarëve të amvisërisë, llogaritur nga muaji i fundit, në vend se nga tre muajt paraprakë;

2) asistenca për personat me aftësi të kufizuara dhe të rriturit në 27 komuna, që më lehtë t'i bëjnë ballë krizës, duke përfshirë 200 të papunë si shërbimdhënës;

3) kompensimi monetar me shumë nga 50% të pagës mesatare mujore neto të punonjësit për 24 muajt e fundit. Një person i papunë, i cili ka qenë i punësuar më herët për të paktën 9 muaj radhazi, apo 12 muaj me ndërprerje në 18 muajt e fundit, para përfundimit të punësimit, gëzon të drejtën e kompensimit monetar;

4) Pushimi i lindjes është shtyrë deri në skadimin e masave të përkohshme të mbrojtjes nga shpërhapja dhe parandalimi i Covid-19.

Masat e synuara për grupet vulnerabël; solidariteti social dhe kohezioni social

1) shtyrja e pagimit të qirasë për shfrytëzuesit e banimit social; futja e një asistence parash prej 1.000 denarësh për shpenzimet e energjisë së familjeve për muajt prill dhe maj 2020, dhe

2) Aksesimi i lehtësuar në të drejtën e shtesës së fëmijëve dhe afatet e zgjatura për parashtrimin e kërkesave për të drejtën e asistencës financiare të njehershme për një të porsalindur, për realizimin dhe zgjatjen e së drejtës së shtesave prindërore për fëmijën e katërt.



Follow OSCE



Misioni i OSBE-së në Shkup
Bulevardi 8 shtatori Nr. 16
e-mail: info-MK@osce.org
website: <http://www.osce.org/mission-to-skopje>